



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 84/2021 regjistër (JR)
Datë 29.12.2021

Nr. 50 i vendimit
Datë 22.10.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.10.2024, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 84/2021, datë 29.12.2021, që i përket:

ANKUES:

Subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit nr. 465, datë 28.10.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 61, 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 465, datë 28.10.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, iu nënshtroa procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, prej të cilave rezultoi si më poshtë.

2.1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ii. ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin, duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;

b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në Deklaratën për Kontrollin e Figurës;

c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi.

2.3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 465, datë 28.10.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 465, datë 28.10.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë kriter, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit: (a) ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet që duhet vlerësuar si i papërshtatshëm, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund t’i rikuperojë ato, duke u gjendur në kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 21.12.2021, ka paraqitur ankimin ndaj vendimit nr. 465, datë 28.10.2021, të Komisionit, duke kërkuar që Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike;*
 - *administrimin e provave bashkëlidhur ankimit;*
 - *konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja;*
 - *ndryshimin e vendimit nr. 465, datë 28.10.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*
6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor, si dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, si për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ashtu dhe për vlerësimin e aftësive profesionale.
7. Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit që të merren në shqyrtim e të vlerësohen aktet e paraqitura prej tij bashkëlidhur ankimit, si më poshtë.
 - 7.1. Vendimi nr. {***}, datë 05.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga prokuror Ermir Lelçi në mungesë, me objekt: Pushimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2015, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, kallëzues: Gj. Sh. dhe të kallëzuar: M. Th., K. P., M. T., Gj. M., R. K., P. V., P. P., P. Rr., S. V., mbrojtur dhe përfaqësuar nga av. A. F., anëtar i Dhomës së Avokatisë Shkodër, zgjedhur nga vetë të kallëzuarit, si dhe persona të interesuar: S. B. dhe N. N..
 - 7.2. Vendimi nr. {***}, datë 15.11.2021, i Gjykatës së Apelit Shkodër, me kërkuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt: Pushimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2018, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i kallëzuar: D. Sh. H. dhe kallëzues: M. K., N. K., P. K..
 - 7.3. Shkresë nr. {***} prot., datë 17.12.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka bashkëlidhur: “Raportin vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për vitin 2018”; “Raportin vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për vitin 2019”; “Raportin vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për vitin 2020”; si dhe të dhënat lidhur me procedimet penale të regjistruara nga prokuror Ermir Lelçi gjatë vitit 2021.

8. Subjekti i rivlerësimit, para zhvillimit të seancës gjyqësore, dorëzoi në Kolegj një material të titulluar “Parashtrime”, të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.10.2024, bashkëlidhur të cilit dorëzoi edhe disa akte shkresore¹.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e

¹ Bashkëlidhur parashtrimeve të depozituara para zhvillimit të seancës gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur:

i. Vendim nr. {***}, datë 05.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga prokuror Ermir Lelçi në mungesë, me objekt: Pushimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2015, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, kallëzues: Gj. Sh. dhe të kallëzuar: M. Th., K. P., M. T., Gj. M., R. Kurtaj, P. V., P. P., P. Rr., S. V., mbrojtur dhe përfaqësuar nga av. A. F., anëtar i Dhomës së Avokatisë Shkodër, zgjedhur nga vetë të kallëzuarit, si dhe persona të interesuar: S. B. dhe N. N..

ii. Vendim nr. {***}, datë 01.11.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga prokurorja, znj. Sh. M., në mungesë, me objekt: Pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/21 i Kodit Penal, kallëzues/viktimë: E. M. dhe B. M., të mbrojtur nga av. I. K., si dhe persona të interesuar: B. M., në mungesë, mbrojtur nga av. B. K..

përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.

11.1 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se çështja e tij duhet gjykuar në seancë gjyqësore publike dhe gjithashtu ka kërkuar administrimin në cilësinë e provës të akteve të depozituara bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve të paraqitura para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi.

11.2 Në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur argumente që të provojë mungesën e fajit apo arsyet objektive për mosparaqitjen e akteve bashkëlidhur ankimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se aktet e dorëzuara bashkëlidhur ankimit, nuk përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision.

11.3 Sa u përket akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e paraqitura pesë ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas të cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe, për këto arsye, i përjashtoi nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes.

11.4 Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të arritura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, siç do të analizohet edhe në vijim, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor për të siguruar korrektimin e tyre, siç subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim. Në këto rrethana, trupi gjykues çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, prandaj gjykimi u zhvillua në dhomë këshillimi, konform përcaktimeve të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, që referon te zbatimi i nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet procedurale të ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregull ligjor

- 12.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *gjatë procesit administrativ, Komisioni i ka vendosur atij një barrë prove të paarsyeshme, joproporcionale, joobjektive dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative.*

12.1. Në argumentimin e këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se gjetja kryesore e njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ, nga e cila rrjedh konkluzioni i vetëm mbi të cilin Komisioni ka bazuar masën disiplinore të shkarkimit, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat neto të përfituara nga babai i tij nga bujqësia dhe blegtoria, në fakt nuk është gjetje, sipas parashikimeve ligjore të procesit të rivlerësimit, pasi:

i. Nuk ka ekzistuar asnjë dokumentacion apo mënyrë ligjore përpara vitit 2012, për të dokumentuar të ardhurat e një familjeje bujqësore.

ii. Nga provat e paraqitura është e qartë që nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, babai i subjektit të rivlerësimit, përveç produkteve të përdorura për konsum ushqimor, ka realizuar dhe të ardhura nga shitja e produkteve të prodhuara.

iii. Në rezultatet e hetimit, Komisioni nuk ka shpjeguar se cili është dokumentacioni që duhet të kishte ruajtur babai i subjektit të rivlerësimit, apo provat që duhet të kishte paraqitur për të provuar ekzistencën e të ardhurave nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral.

iv. Përdorimi i metodave alternative për përllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nëpërmjet të dhënave statistikore apo të dhënave të tjera të administruara nga institucionet shtetërore është fakt i pamohueshëm dhe i përdorur gjerësisht gjatë procesit të rivlerësimit, siç janë për shembull, kostot e ndërtesave nëpërmjet të dhënave nga EKB-ja, shpenzimet jetike nëpërmjet të dhënave statistikore, të ardhurat *neto* nga biznesi i vogël në bazë të metodave alternative etj.

v. Në kushtet kur legjislacioni i kohës nuk ka pasur një mënyrë për dokumentimin e të ardhurave nga familja bujqësore, e vetmja mënyrë për subjektin e rivlerësimit, që të provonte të kundërtën e kësaj barre prove të paarsyeshme, ishte të merrte një dokument nga autoritetet lokale të zonës, të cilët kanë përllogaritur të ardhurat bazuar në metodologji alternative, bazuar në disa të dhëna, si: sipërfaqja e tokës bujqësore në përdorim, sasia e krerëve të bagëtive etj.

vi. Arsyetimi i Komisionit se *përllogaritjet nuk janë bazuar në evidencat e institucionit të mbajtura në kohë reale*, është i palogjikshëm, pasi institucionet nuk kanë qenë të detyruara të mbanin të dhëna për secilën familje bujqësore, madje as vetë fermerët nuk kanë qenë të detyruar të mbajnë këto të dhëna dhe në fakt nuk kanë pasur asnjë mundësi për t'i dokumentuar, pasi nuk lëshonin fatura për produktet që ata tregtonin. E vetmja mundësi e subjektit të rivlerësimit për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga aktiviteti bujqësor i babait të tij, janë metodat alternative, ashtu siç ai ka vepruar, duke iu drejtuar organeve shtetërore, si dhe një audituesi ligjor të pavarur. Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim, pse përllogaritjet e kryera nga audituesi ligjor nuk kanë vlerë provuese.

vii. Komisioni nuk ka kryer të paktën një analizë financiare për të përllogaritur të ardhurat e përfituara nga babai i tij, sipas metodologjisë që beson vetë.

viii. Sipas logjikës së Komisionit, duke mos marrë në konsideratë të ardhurat e familjes së babait të ankuesit nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, çdo familje që jeton në fshat, duhet të jetonte me borxhe kumulative, pasi ata sipas Komisionit konsiderohen me zero të ardhura. Kjo logjikë e vendos babain e subjektit të rivlerësimit në një pozicion diskriminues, në raport me të gjithë personat e tjerë që përfitojnë të ardhura nga një aktivitet tjetër tregtar, i ndryshëm nga ai bujqësor dhe blegtoral.

ix. Subjekti i rivlerësimit e ka pasur të vështirë të përgatisë një mbrojtje të mirë në lidhje me faktet që shkojnë shumë vite larg në të kaluarën e largët, e sidomos në kushtet kur Komisioni nuk i bën me dije se cila është metodologjia që duhet të përdoret apo dokumentet që duhet të paraqiten për të provuar të ardhurat e babait të tij nga bujqësia e blegtoria.

12.2. Trupi gjykues, fillimisht, konstatoi se pretendimet e mësipërme janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit edhe në shkaqet që lidhen me konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat do të analizohen në mënyrë më të plotë e të detajuar në vijim të këtij vendimi.

12.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se prapësimet e subjektit të rivlerësimit i drejtohen barrës së provës së kaluar nga Komisioni me rezultatet e hetimit administrativ. Nga verifikimi i shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ, por edhe nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore publike, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë pretendim, nga ato të ngritura në ankim, lidhur me pamundësinë për të bërë një mbrojtje të mirë, pasi faktet që i kërkohej të provonte i përkisnin një të kaluarë të largët, apo të kishte pretenduar e kërkuar nga Komisioni metodologjinë apo dokumentet që duhet të paraqiste për të provuar të ardhurat e babait të tij nga bujqësia e blegtoria. Nga dispozitat e ligjit nr. 84/2016, me fokus nenin 52, pika 2 dhe praktikën e ndjekur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, momenti procedural, kur subjekti i rivlerësimit njihet me tërësinë e provave të mbledhura e gjetjet e pritshme, për t'i kundërshtuar më pas, në funksion të barrës për të provuar të kundërtën, është njoftimi i rezultateve të hetimit administrativ. Në këtë kuptim, edhe momenti procedural, kur subjekti i rivlerësimit do të duhet të paraqiste kundërshtimet lidhur me këto rezultate të hetimit, ishte pikërisht momenti i paraqitjes së shpjegimeve mbi to. Në kuadër të parashikimeve ligjore mbi procesin e rivlerësimit, Komisioni ka detyrimin të njohë subjektin e rivlerësimit me gjetjet e konstatuara si rezultat i të dhënave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, ndërsa barra e provës i takon subjektit të rivlerësimit, duke qenë në diskrecionin dhe zgjedhjen e pavarur të këtij të fundit, identifikimi i mënyrës dhe mjeteve për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi administrativ. Në këtë kuptim, nuk është detyrim i Komisionit të orientojë subjektin e rivlerësimit se cili do të ishte dokumentacioni që do të provonte të ardhurat e pretenduara se ishin realizuara nga babai i tij, nga aktiviteti bujqësor e blegtoral.

12.4. Nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ, rezulton se nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime lidhur me të ardhurat e babait të tij nga vetëpunësimi në bujqësi dhe blegtori. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit, për të vërtetuar të ardhurat nga bujqësia, ka paraqitur në Komision një sërë aktesh të lëshuara nga strukturat pranë Bashkisë Shkodër, Njësia Administrative Dajç, si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shkodër, ndërsa në kuadër të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur aktin e auditimit ligjor të audituesit të zgjedhur prej tij. Komisioni në faqet 18-19 të vendimit, ka pasqyruar e analizuar raportin e audituesit ligjor dhe ka arsyetuar edhe pse të dhënat e këtij raporti auditimi nuk mund të shërbejnë për të provuar të ardhurat e pretenduara në ushtrimin e aktivitetit të fermerit nga babai i tij. Lidhur me vlerën provuese të këtyre akteve, në vendimin e Komisionit, pasi është bërë një analizë e secilës prej tyre, në përfundim është konkluduar se: [...] Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitet në blegtori, por

subjekti nuk ka provuar të ardhurat neto të realizuara nga ky aktivitet. Aktivlerësimi i përpiluar nga inspektori në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe akti i audituesit ligjor i paraqitur nga subjekti në përfundim të rezultateve të hetimit, nuk janë mbështetur në asnjë burim të njohur prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, por pasqyrojnë të ardhurat hipotetike të babait të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e blegtorisë.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ky qëndrim i Komisionit, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, evidenton në mënyrë të qartë se nuk ka munguar analizimi i provave të paraqitura për të ardhurat e babait të tij nga aktiviteti bujqësor e blegtoral. Informacionin dhe të dhënat që këto akte ofrojnë, Komisioni i ka vlerësuar jo të mjaftueshme për të provuar të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si të realizuara ndër vite nga aktiviteti i babait të tij si fermer. Trupi gjykues vlerësoi se edhe në këtë rast, Komisioni ka vepruar brenda fushës së pushtetit të tij diskrecionar për vlerësimin e provave, i cili është një proces që mbështetet në faktet e provat e disponueshme, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme të komisionerëve, sipas parashikimeve të neneve 45 dhe 51 të ligjit nr. 84/2016.

12.5. Referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, konstatohet se Komisioni² ka vlerësuar se të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral mbeten vetëm në kuadër të një deklarimi të pambështetur në asnjë burim prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, vlerësim i cili thekson mungesën e provueshmërisë së të ardhurave në vetvete. Në analizë të të dhënave që janë mundur të përftohen nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar krijimin e të ardhurave të babait të tij nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, Komisioni ka konkluduar se këto të ardhura nuk u provuan. Konkluzioni i arritur nga Komisioni në këtë rast, si rezultat i një analize ligjore në drejtim të mosplotësimit të kushtit të vendosur nga neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar bindshëm të ardhurat e personit tjetër të lidhur, babait të tij, e bën të pamundur logjikisht kryerjen e një analize financiare mbi mundësinë e krijimit të kursimeve prej këtij të fundit. Ky qëndrim i Komisionit nuk synon mohimin e të ardhurave të mundshme të realizuara nga z. N. L. nga aktiviteti bujqësor e blegtoral e aq më pak të familjeve bujqësore, siç përpiqet të përgjithësojë subjekti i rivlerësimit, por lidhet me provueshmërinë e këtyre të ardhurave me dokumentacion, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kushtet kur z. N. L. gjendet në cilësinë e personit tjetër të lidhur të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi. Sa më sipër, trupi gjykues çmoi se nuk gjendet asnjë rrethanë faktike konkrete që do të cilësohej edhe teorikisht si bazë për të treguar indicie diskriminimi të ndonjë forme të babait të subjektit të rivlerësimit në raport me të gjithë personat e tjerë që përfitojnë të ardhura nga një aktivitet tjetër tregtar, i ndryshëm nga ai bujqësor dhe blegtoral.

12.6. Për pasojë, trupi gjykues e gjen shkakun e ankimit të paargumentuar dhe të pambështetur në prova dhe në ligj.

² Paragrafi 1.89 i vendimit të Komisionit.

13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *procesi i rivlerësimit i kryer ndaj tij ka qenë i padrejtë dhe në shkellje të parimit të sigurisë juridike, për shkak të mungesës së plotë të afateve të parashkrimit, duke u shkarkuar nga detyra për shkak të rrethanave dhe fakteve që datojnë nga e kaluara e largët, pasi, ndër të tjera, atij iu kërkua të provonte të ardhurat e prindërve të tij që prej vitit 1993.*

13.1. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstatoi se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjet: *i. Personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 2.110.000 lekë për të kryer shlyerjen e parakohshme të kredisë, e cila ka shërbyer si burim për pjesën takuese të subjektit në apartamentin në Shkodër. ii. Personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 4.100.000 lekë për të kryer pagesën e kësteve të apartamentit.*

Ka qenë vetë subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorëve dhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka pretenduar se pagesat e apartamentit janë përballuar nga kursimet e babait nga të ardhurat nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, duke filluar nga viti 1993 e deri në vitin 2009. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur një dokumentacion ligjor e financiar për të provuar të ardhurat e përfituara nga babai i tij nga aktiviteti i ushtruar, më së paku, për vitin 2009, vit në të cilin ka deklaruar pranë ILDKPKI-së në deklaratën periodike të pasurisë, si dhe në deklaratën e rivlerësimit, se kredia e marrë prej tij në Tirana Bank, në shumën 2.100.000 lekë, është shlyer plotësisht nga babai i tij dhe subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të deklaronte burimin e krijimit të pagesës së kryer, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9043/2003 dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.

13.2. Kolegji, në jurisprudencën e tij, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur qëndrimin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht kohës kur ka ndodhur ky fakt, nëse lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Për rrjedhojë, kryerja e kontrollit të pasurive, pavarësisht kohës së krijimit të tyre, është zbatim i kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit, qëllimit të këtij procesi për rikthimin e besimit të publikut te drejtësia dhe nuk mund të pretendohet apo interpretohet si fokusim në mundësi ekonomike të një kohe të largët. Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, ka mbajtur qëndrimin se “[...] vlerësimi i pasurisë manifeston specifika të caktuara, ndryshe nga hetimet e zakonshme disiplinore, të cilat do të kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Kjo është edhe më e vërtetë në kontekstin shqiptar, ku verifikimi paraprak i deklaratave të pasurisë nuk kishte qenë veçanërisht efektiv [...]”. Së fundmi, mund të jetë, gjithashtu, një çështje interpretimi se kur saktësisht një shkellje e veçantë disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë kontekst, domethënë,

nëse në kohën kur është blerë fillimisht pasuria ose në një pikë të mëvonshme, në kohën kur pasuria është deklaruar në një deklaratë periodike. Në të njëjtën kohë, një fleksibilitet i tillë nuk mund të jetë i pakufizuar dhe implikimet për sigurinë juridike dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6/1 të Konventës duhet të konsiderohen rast pas rasti”.

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, duhet të pasqyrohet qartë se cila shkelje e parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, dyshohet të jetë kryer nga subjekti*. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, pavarësisht se mund të nxjerrë konkluzione të ndryshme për çdo pasuri, në përmbledhje të konstatimeve, duhet të përcaktojë qartësisht bazën ligjore të shkeljes së pretenduar se është kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Nga analizimi i relacionit të rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se në të janë pasqyruar të gjitha provat e administruara, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, si dhe janë pasqyruar qartë konstatimet, për të cilat, në bazë të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës. Dispozitat e kuadrit ligjor të rivlerësimit nuk parashikojnë detyrimin që Komisioni, në këtë akt procedural, të shprehet lidhur me prezumimin e masës disiplinore, për më tepër, subjektet e rivlerësimit, me formimin e tyre profesional, kanë aftësitë për të vlerësuar peshën e konstatimit në raport me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, për aplikim të masës disiplinore të parashikuar nga po i njëjti ligj, kjo edhe në referim të parashikimeve të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

15. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni nuk ka arritur në përfundimin se pasuria e tij është më e madhe se dyfishi i asaj të ligjshme, apo se pasaktësitë në deklaram kanë pasur qëllim fshehjen e pasurive dhe, në këto kushte, ai nuk kishte detyrimin për barrë prove në kuptim të nenit D, pika 4 dhe pika 5 e Aneksit të Kushtetutës*. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se ky argument i paraqitur edhe nga subjekte të tjera rivlerësimi, ka gjetur trajtim gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit. Në analizë të argumenteve të ngritura nga subjekte të tjera rivlerësimi, Kolegji ka theksuar se pika 1 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethana faktike dhe ligjore – kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të – të cilat janë autonome nga rrethanat e tjera që normohen nga ky nen, në të cilat organet e rivlerësimit, pa ushtruar diskrecion, zbatojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Nga ana tjetër, deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë, sipas ligjit, konstatohet nën dritën e përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Kjo dispozitë parashikon detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Në përmbushje të këtij detyrimi kushtetues, pika 2, neni 52 i ligjit nr. 84/2016 parashikon detyrimin e subjektit të rivlerësimit që, në përgjigje të barrës së provës, të paraqesë prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e përfundimeve të arritura nga Komisioni.
16. Në konkluzion të arsytimit të mësipërm, lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në të cilin adreson pretendime lidhur me shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë

shqyrtimit të çështjes së tij në Komision, trupi gjykues i gjen ato të paargumentuara dhe të pabazuara ligjërisht.

C. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

○ **Për pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 138 m², në Shkodër**

17. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar:

Apartament me sip. 138 m², në bashkëpronësi me babanë N. L., me vlerë 6.200.000 lekë dhe me pjesë takuese 2/3 ose 67% për N. L. dhe 1/3 ose 33% për Ermir Lelçi.

Për blerjen e këtij apartamenti janë paguar shumat e ndryshme nga babai N. L., të kursyera nga vetëpunësimi në bujqësi dhe blegtori që nga viti 1991 e në vijim, një pjesë e tyre kanë qenë të depozituara në bankë dhe një pjesë ka qenë në shtëpinë e tij.

Për të blerë apartamentin në bashkëpronësi, është marrë një kredi te Tirana Bank, dega Shkodër, në shumën 2.100.000 lekë, me kontratën [...], datë 21.06.2007. Shuma e kredisë është shlyer më datë 29.01.2009, kjo e konfirmuar nga mandatarkëtimi i shumës prej 2.100.000 lekësh nga babai N. L., mandat i lëshuar nga Tirana Bank, dega Shkodër.

17.1. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*Apartament me sipërfaqe 138 m², në bashkëpronësi me babain N. L., me adresë: lagjja “{***}”, rruga “{***}”. Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2007. Vlera: 6.200.000 lekë. Pjesa takuese: 2/3 N. L. ose 67 % dhe 1/3 Ermir Lelçi ose 33%.*

*Kontratë kredie bankare afatgjatë nga Banka e Tiranës për blerje shtëpie, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, në shumën 2.100.000 lekë + 9,75%, për 20 vjet, kësti mujor 20.115,68 lekë. Janë shlyer 6 muaj në shumën 120.600 lekë.*

18. Nga analiza e akteve të administruara nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi, si vijon.

(i) Ndërmjet shtetasve A. Ç. dhe Ermir Lelçi është lidhur kontrata e kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2006, në të cilën përcaktohet, ndër të tjera, se: “[...] Pala A. Ç. është pronare [...] e një sip. trualli 300 m², nga i cili 109 m² janë ndërtesë. Pala A. Ç., në pallatin që do të ndërtohet në këtë pronë, do t’i shesë palës Ermir Lelçi një apartament banimi 3+1, të ndodhur në katin e tretë (kati i dytë i banimit) [...]. Palët kanë rënë dakord që vlera totale e apartamentit do të jetë 6.200.000 lekë. Sot, pala Ermir Lelçi likuidoi shumën 1.000.000 lekë të reja që është kësti i parë. Kësti i dytë do të paguhet në datën 07.06.2006, me vlerë 1.400.000 lekë dhe kësti i tretë prej 3.800.000 lekësh do të paguhet me dorëzimin e çelësave dhe me dhënien e tapisë”.

(ii) Më datë 07.05.2007, ndërmjet z. A. Ç., në cilësinë e shitësit, dhe z. N. L. dhe z. Ermir Lelçi, në cilësinë e blerësve, është lidhur kontrata e shitblerjes me rezervë pasuri e paluajtshme “apartament banimi”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.05.2007. Në këtë kontratë parashikohet se në marrëveshje mes palëve kontraktuese, çmimi i shitjes së pasurisë së paluajtshme është 6.200.000 lekë, shumë e cila do të likuidohet nga pala blerëse nëpërmjet kredisë së marrë

nga Tirana Bank. Pas likuidimit të shumës, pala shitëse humbet të drejtën e pronësisë, duke lejuar kalimin e pronësisë në favor të z. N. L. me 2/3 pjesë dhe z. Ermir Leçi me 1/3 pjesë.

(iii) Më datë 06.06.2007, mes palëve të sipërcituara është lidhur kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2007. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pronësia e pasurisë apartament banimi me sip. 138 m² në Shkodër, i kalon në 2/3 pjesë z. N. L. dhe në 1/3 z. Ermir Leçi. Çmimi i shitjes së pasurisë, në vlerën 6.200.000 lekë, është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

(iv) Më datë 13.06.2007, pasuria apartament banimi me sip. 138 m² është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër, në emër të z. N. L. dhe z. Ermir Leçi.

(v) Më datë 21.06.2007, palët kredimarrëse Ermir dhe N. L. kanë lidhur kontratën e kredisë bankare afatgjatë për shtëpi me nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.06.2007, me Tirana Bank, në të cilën përcaktohet se: “Banka jep te kredimarrësi kredinë në shumën 2.100.000 lekë, që do të përdoret për blerje banese; dhe kredi në shumën 120.000 lekë që do të përdoret si garanci për limitin e një karte krediti *Visa Card*, në emër të kartëmbajtësit Ermir Leçi”. Kohëzgjatja e kredisë është 20 vjet dhe si kolateral është vendosur apartamenti me sipërfaqe 138 m², me nr. pasurie {***}, ZK {***}. Në datën 16.01.2009, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Tirana Bank, është transferuar shuma 2.110.000 lekë nga babai i tij, z. N. L., me përshkrimin: “Për shlyerje kredie” dhe, në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit Ermir Leçi ka kryer pagesën e plotë për shlyerjen e kësaj kredie bankare.

18.1. Pagesat për blerjen e kësaj pasurie³ janë kryer si vijojnë:

(i) transfertë bankare nga llogaria e z. N. L. në llogarinë e z. A. Ç. në Tirana Bank, në datën 07.02.2006, në shumën 1.000.000 lekë, me përshkrimin: “TRN to ACC A. Ç. nga N. L., kësti I për blerje Ermir Leçi”;

(ii) transfertë bankare nga llogaria e z. N. L. në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në Tirana Bank, në datën 08.06.2006, në shumën 1.390.000 lekë, me përshkrimin: “Kësti II blerje apartamenti Ermir Leçi”;

(iii) transfertë bankare nga llogaria e z. Ermir Leçi në llogarinë e z. A. Ç., në Tirana Bank, në datën 27.06.2007, në shumën 2.100.000 lekë, me përshkrimin: “Blerje apartamenti”, transfertë e kryer pas disbursimit të kredisë bankare të marrë nga z. Ermir Leçi në të njëjtën bankë;

(iv) pagesa në *cash* të kryera nga z. N. L., në arkën e shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 10.000 lekë më datë 14.06.2006 dhe në shumën 1.700.000 lekë në datën 03.07.2007, vërtetuar nga mandatpagesat përkatëse të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK.

19. Në përfundim të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë “apartament banimi” me sipërfaqe 138 m², në Shkodër (në vijim “pasuria apartament”), Komisioni, në vendim⁴, ka arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit:

³ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Tirana Bank, me shkresat nr. {***} prot., datë 16.01.2020 dhe nr. {***} prot., datë 15.06.2021, si dhe me vërtetimin, datë 15.10.2021, drejtuar Komisionit nga shoqëria “{***}” ShPK.

⁴ Paragrafët 1.15 dhe 1.16 të vendimit të Komisionit.

i. Ka kryer deklarim jo të saktë dhe në përputhje me ligjin për të drejtat reale mbi këtë apartament, si dhe detyrimet që rridhnin nga kjo kontratë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, e vlerësuar kjo në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kësaj pasurie.

ii. Është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pronësinë mbi këtë apartament në masën 33% dhe përdorimin e pjesës takuese prej 77% në pronësi të babait të tij, duke ngritur dyshime të arsyeshme për paraqitjen e rrethanave jo të vërteta, rrethana të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë me këtë pasuri dhe, për pasojë, edhe të burimit të krijimit të saj në shumën 4.100.000 lekë, që përbëhet nga kështet e paguara nga babai i subjektit, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

iii. Ka mungesë të burimeve të mjaftueshme dhe të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në shumën 2.110.000 lekë, nga personi tjetër i lidhur/dhuruesi/babai i tij, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

20. Në kundërshtim të konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *ato janë në kundërshtim me provat e administruara, me kuadrin ligjor të rivlerësimit, si dhe me jurisprudencën e krijuar nga Kolegji dhe vetë Komisioni, pasi ai ka deklaruar saktësisht këtë pasuri, pjesën takuese, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj.*
21. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendime për secilin nga konkluzionet e arritura nga Komisioni, të cilat analizohen nga trupi gjykues në vijim.

21.1 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit se ai ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, është një konkluzion i padrejtë dhe i arritur në shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi në rezultatet e hetimit administrativ i është njoftuar si “gjetje” dhe i kalohet si barrë prove “mosdeklarimi i detyrimit”, ndërkohë që në vendim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se “nuk deklaruar krahas detyrimit edhe të drejtat reale në këtë apartament”.*

21.2 Subjekti i rivlerësimit në ankim, ashtu sikurse edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka argumentuar se kapari për blerjen e pasurisë “apartament” është paguar nga babai i tij dhe, referuar parashikimeve ligjore të neneve 601 dhe 602 të Kodit Civil, subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij nuk kishin detyrime ndaj shoqërisë ndërtuese apo ndaj z. A. Ç., në vitin 2006. Detyrimi do të lindte në momentin e dorëzimit të apartamentit për pagesën e mbetur pa paguar nga çmimi dhe, nëse pasuria nuk dorëzohej, babait të tij i lindte e drejta të përfitonte dyfishin e pagesës së kryer. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, edhe nëse do të pranohej pasaktësia në deklaratën e interesave të vitit 2006, kjo pasaktësi është ndrequr një vit më pas në vitin 2007, kur ka deklaruar në ILDKPKI të gjithë dokumentacionin për përfitimin e kësaj pasurie në bashkëpronësi me babain e tij, pasi apartamenti është dorëzuar nga shoqëria e ndërtimit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, ai nuk duhet të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore për një pasaktësi në deklaratat periodike të pasurisë.

21.3 Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të mësipërme, trupi gjykues vëren se:

21.1.1. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës lidhur me: *Deklarimi i subjektit në deklaratën e interesave të vitit 2006 nuk është i saktë dhe në përputhje me shkronjën “dh” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, pasi nuk ka deklaruar detyrimet financiare ndaj shtetasit A. Ç.* – dhe subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me këtë gjetje. Në vendim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim jo të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën e interesave të vitit 2006, jo vetëm për detyrimet që rridhnin nga kontrata e kaparit për blerjen e pasurisë “apartament”, por edhe për të drejtat reale mbi këtë pasuri.

21.1.2. Në kontratën e kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2006, e cila në tërësinë e saj përmban elementet tipike të një kontrate porositëse/sipërmarrjeje, subjekti i rivlerësimit, i cilësuar herë si “pala porositëse” dhe herë si “pala blerëse”, ka marrë përsipër, i vetëm, detyrimin për pagimin e kësteve përkatëse për blerjen e pasurisë “apartament”, me vullnetin e tij të lirë e të pavesuar, në prani të noterit publik, në vlerën totale të shitblerjes prej 6.200.000 lekësh. Pagesa e kaparit në shumën prej 1.000.000 lekësh, si këst i parë për blerjen e pasurisë apartament, është paguar për llogari të subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, më datë 07.02.2006, referuar përshtatimit të transfertës bankare nga llogaria e z. N. L. në llogarinë e z. A. Ç., në Tirana Bank. Subjekti i rivlerësimit ka marrë përsipër detyrimin për pagesën e këstit të dytë në shumën 1.400.000 lekë dhe më pas pagimin e këstit të tretë në shumën 3.800.000 lekë, në momentin e dorëzimit të pasurisë dhe regjistrimit të saj në regjistrin përkatës. Sipas përmbajtjes së kontratës në fjalë, nëse porositësi/subjekti i rivlerësimit nuk shlyente këstet në afatet e parashikuara në këtë kontratë, sipërmarrësi kishte të drejtë të përfitonte një kamatë prej 5% në muaj, për vlerën e papaguar.

21.1.3. Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), në nenet 4⁵ dhe 21⁶ parashikon se subjektet që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave privatë, duhet të deklarojnë detyrimet financiare që kanë ndaj personave juridikë dhe fizikë. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se lidhja e kontratës së kaparit prej subjektit të rivlerësimit më datë 07.02.2006 dhe kryerja e pagesës po në këtë datë, e këstit të parë me vlerë

⁵ Në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, parashikohet:

“Subjektet deklarues duhet të deklarojnë detyrimet financiare të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”.

⁶ Në nenin 21 të ligjit nr. 9049/2003, parashikohet:

“Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur. Deklaruesit, përpara deklarimit, duhet t'i jepen të gjitha këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës dhe t'i bëhen të njohura rrjedhimet që mbart deklarimi i rremë”.

1.000.000 lekë, është një situatë që pasqyron qartë lindjen e detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit ndaj sipërmarrësit, z. A. Ç.. Në këtë kuptim, pagesa e kështit të parë dhe marrja përsipër e pagimit të diferencës së çmimit, përfaqëson një detyrim financiar të lindur për subjektin e rivlerësimit në kohën e lidhjes së kontratës së kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2006. Të tilla rrethana vlerësohen se ishin të detyrueshme për t'u deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006, dhe mosdeklarimi i tyre prej subjektit të rivlerësimit përfaqëson një shkelje të detyrimeve që vijnë nga legjislacioni i kohës.

21.1.4. Pavarësisht kësaj analize, e cila shkon në një linjë me arsyetimin e Komisionit në vendim, për sa i përket pasaktësisë në deklarimin e vitit 2006 lidhur me pagesën e kryer dhe detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj palës sipërmarrëse për blerjen e pasurisë “apartament”, ngritja e kësaj pasaktësie në deklarimet periodike në nivelin e shkeljes disiplinore për subjektin e rivlerësimit, vlerësohet nga trupi gjykues si një konkluzion jo i drejtë i Komisionit.

Situata e mosdeklarimit të kontratës së kaparit dhe e detyrimeve që rridhnin prej saj, në deklaratën e interesave të vitit 2006, edhe pse në mospërmblidhje të detyrimit që subjekti i rivlerësimit mbartte si zyrtar deklarues për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 9043/2003, vlerësohet nga trupi gjykues si një situatë e cila nuk ka vënë në vështirësi procesin e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e vitit 2007, ka deklaruar blerjen e pasurisë “apartament” dhe pjesën takuese të tij në këtë pasuri dhe kontratën e kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2006, ai e ka paraqitur pranë ILDKPKI-së si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit.

Në vlerësim të trupit gjykues, deklarimi i pasaktë në deklaratën e interesave të vitit 2006 nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që do të prodhonte shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

21.1.5. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit me natyrë procedurale, lidhur me konkluzionin e Komisionit në vendim se ka kryer deklarim të pasaktë për të drejtat reale në pasurinë “apartament”, pa e cilësuar këtë si gjetje në rezultatet e hetimit administrativ e, për pasojë, pa i kaluar barrën e provës, trupi gjykues konsideroi jorelevant këtë pretendim, për sa kohë që konkludoi në mënyrë të ndryshme nga Komisioni lidhur me çështjet e adresuara në shkakun e ankimit.

21.1.6. Për këto arsye, trupi gjykues shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit e gjen të drejtë dhe të bazuar në jurisprudencën e Kolegjit.

- 22.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *është i padrejtë dhe tërësisht abuziv konkluzioni i Komisionit se babai i tij nuk ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e pasurisë “apartament” në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit, si dhe për dhënien e shumës 2.100.000 lekë për shlyerjen e kredisë bankare nga subjekti i rivlerësimit.*

22.1. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, në vendim⁷, ka arritur në konkluzionin se babai i subjektit të rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues burimet financiare të ligjshme për blerjen e pjesës takuese prej 2/3 të pasurisë “apartament”, si dhe për shlyerjen e kredisë bankare në shumën 2.100.000 lekë, e cila ka shërbyer për financimin e pjesës takuese prej 1/3 të subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar se: *Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitet në blegtori, por subjekti nuk ka provuar të ardhurat neto të realizuara nga ky aktivitet. Aktivlerësimi i përpiluar nga inspektori në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe akti i audituesit ligjor, i paraqitur nga subjekti në përfundim të rezultateve të hetimit, nuk janë mbështetur në asnjë burim të njohur prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, por pasqyrojnë të ardhurat hipotetike të babait të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e blegtorisë.*

22.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin dhe konkluzionin e arritur nga Komisioni në vendim, duke ngritur pretendime të cilat janë analizuar nga trupi gjykues si më poshtë.

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pretendimit të tij se Komisioni, në mënyrë të palogjikshme dhe të pavërtetë, arsyeton se dy aktivlerësimet e paraqitura prej tij nuk janë të mbështetura në asnjë burim të njohur prove, pasi të dyja këto akte janë mbështetur në dokumente shkresore të vërtetuara nga institucionet shtetërore, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, duke argumentuar si vijon.

(a) Dokumente që të vërtetojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhurat nga toka bujqësore dhe nga aktiviteti blegtoral, nuk ka, jo vetëm për babain e subjektit të rivlerësimit, por për asnjë fermer në Shqipëri përpara vitit 2012, pasi vetëm pas këtij viti pajisja me NIPT e fermerëve është bërë me qëllimin e vetëm për të përfutur nga formula e rimbursimit të TVSh-së. Komisioni duhet të kishte në konsideratë parashikimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi në rastin konkret nuk ka një rrugë për të gjetur dokumentin që provon shitjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Në këto kushte, Komisioni duhet të vlerësonte të dhënat alternative, ashtu si ka vepruar audituesi ligjor i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, në raportin e auditimit të hartuar me kërkesën e tij.

(b) Sipas subjektit të rivlerësimit, për të ardhurat nga mbarështimi i bagëtive, audituesi ligjor: (i) është mbështetur te të dhënat zyrtare që burojnë nga shkresa e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. {***} prot., datë 23.09.2021, me anë të së cilës institucioni i kthen përgjigje Komisionit dhe e informon për rendimentin e prodhimit të qumështit prej vitit 1996 deri në vitin 2009, çmimin mesatar të shitjes së qumështit me pakicë dhe çmimin mesatar të shitjes së mishit të viçit; (ii) duke qenë se për periudhën 1993-1995 nuk ka të dhëna, ka marrë në konsideratë të dhënat e vitit 1996, si viti më i afërt; (iii) ka vlerësuar si dokument zyrtar dokumentin e lëshuar nga inspektori pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Shkodër, i cili ka vlerësuar vlerën e përfutur nga shitja e mishit, bazuar në numrin e gjedhëve që ka pasur familja bujqësore dhe blegtorale e z. N. L.; (iv) ka vlerësuar të dhënat personale të bagëtive të pasqyruara në dokumente zyrtare autentike me vlerë të plotë provuese, si data e lindjeve të tyre.

⁷ Paragrafët 1.77 - 1.90 të vendimit të Komisionit.

Në lidhje me të ardhurat nga bujqësia, audituesi ligjor ka marrë në vlerësim të dhënat zyrtare të INSTAT-it, ku të dhënat në lidhje me të ardhurat dhe konsumin e familjeve bujqësore fillojnë për vitin 2007. Në mënyrë që të arrijë të të dhënat e viteve 1993-2006, audituesi ligjor ka kryer llogaritjet sipas procesit të *deflatimit*, duke qenë se të gjitha të dhënat që lidhen me çmimet, të ardhurat, konsumin, indeksohen çdo vit me vlerat e inflacionit.

Audituesi ligjor ka përlllogaritur kostot e fermës blegtorale dhe fitimin bruto mbi bazën e manualit ku referon Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ drejtuar subjektit të rivlerësimit, duke pasur në konsideratë se disa zëra të strukturës së kostos që përfshijnë lëndën ushqyese për blegtorinë janë prodhuar në tokën që z. N. L. ka në përdorim, për pasojë fitimi ka qenë më i lartë.

(c) Në mbështetje të përfundimit të arritur edhe nga audituesi ligjor i zgjedhur prej tij, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se babai i tij ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e pasurisë “apartament” në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit, si dhe për dhënien e shumës 2.100.000 lekë për shlyerjen e kredisë bankare nga subjekti i rivlerësimit.

22.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, për të provuar se babai i tij ka ushtruar aktivitet bujqësor e blegtoral në fshatin {***}, Njësia Administrative Dajç, Shkodër, nga i cili ka realizuar të ardhura, për periudhën 1993-2009, ka paraqitur, ndër të tjera, aktet:

i. akt shitblerjeje pasurie të luajtshme, automjet traktor tip “Fokuson” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.06.1999, sipas të cilit z. N. L. ka blerë automjetin në shumën 500.000 lekë;

ii. vërtetim i kryesisë së fshatit {***}, datë 25.06.2018 dhe vërtetim nr. {***} prot., datë 25.06.2018, sipas të cilëve familja e z. N. L. ka në përdorim rreth 40,2 dynymë tokë bujqësore, të cilën e shfrytëzon që nga viti 1993 e në vazhdim;

iii. vërtetim nr. {***} prot., datë 19.12.2019, lëshuar nga Njësia Administrative Dajç, sipas të cilit familja e z. N. L. ka likuiduar taksat vendore dhe nuk ka detyrime të tjera financiare ndaj Njesisë Administrative;

iv. vërtetim nr. {***} prot., datë 14.10.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, sipas të cilit z. N. L. figuron i siguruar si i vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993 dhe ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 1993-2008, në shumat përkatëse të pasqyruara për secilin vit;

v. vërtetim nr. {***} prot., datë 29.06.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, sipas të cilit znj. L. L. figuron e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993 dhe ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 1993-2006, në shumat përkatëse të pasqyruara për secilin vit;

vi. lëvizje të llogarisë bankare të z. N. L. në Tirana Bank;

vii. dokumentet e identifikimit individual të kafshës “Pasaport”, lëshuar nga Inspektorati Veterinar, me datë lëshimi 21.06.2004, për regjistrimin e 8 krerëve lopë;

viii. të dhëna të printuara në datën 16.10.2019, nga sistemi RUDA (Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar), për fermën e z. N. L., vulosur nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve. Në to është përcaktuar kodi i kafshëve, të llojit “të

leshta”, në sasi 50 të tilla, të regjistruara me datë hyrje në sistem, datën 01.01.2007, të llojit “gjedhë”, në sasi 8 të tilla, të regjistruara me datë hyrje në sistem nga shkurti 2009-2018;

ix. vërtetim nr. {***} prot., datë 27.01.2021, lëshuar nga Njësia Administrative Dajç, sipas të cilit, në bazë të të dhënave që zyra e bujqësisë pranë ish-komunës Dajç ka disponuar në kohën e emergjencave civile 2011, familja e z. N. L. ka pasur një minifermë me 6 krerë lopë, 40 krerë dele dhe 10 derra;

x. shkresë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, nr. {***} prot., datë 21.10.2019, drejtuar z. N. L., në të cilën sqarohet se regjistrimi me NIPT i fermerëve pranë drejtorive rajonale tatimore ka filluar me udhëzimin nr. 19, datë 03.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”;

xi. shkresë nr. {***} prot., datë 23.06.2021, e INSTAT-it, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në të cilën i ka përcjellë të dhënat mbi shpenzimet mesatare mujore për konsum në qarkun Shkodër, për vitin 2007, 2009, si dhe për secilin vit të periudhës 2014-2019, duke e informuar, ndër të tjera, se treguesit e shpenzimeve për konsum në përllogaritjen e tyre kanë të përfshirë edhe produktet e prodhuara nga familja dhe të konsumuara prej tyre, të cilat janë pjesë përbërëse e konsumit mesatar mujor.

22.4. Trupi gjykues vëren se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, analizuar si më sipër, provon se babai i subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitet bujqësor e blegtoral, fakt ky i pranuar si i provuar edhe nga Komisioni në vendim⁸, por nuk provon sasinë e të ardhurave të përfituara prej tij. Mungesa e dokumentacionit ligjor provues lidhur me sasinë e të ardhurave të përfituara dhe kohën e përfitimit të tyre, është potencuar edhe nga subjekti i rivlerësimit në ankim, i cili ka pretenduar se është në kushtet e pamundësisë objektive për dokumentimin e të ardhurave të babait të tij nga aktiviteti blegtoral, bazuar në parashikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se gjendet në pamundësi që të disponojë dokumentacionin që provon të ardhurat e siguruara nga babai i tij, nuk është një pretendim i drejtë, për sa kohë që vetë përmbajtja e nenit 32, pika 2⁹, kërkon zbatimin e kësaj dispozite për të tjera rrethana, si zhdukja e dokumentacionit, pamundësia për ta gjetur dokumentin, që në thelb tregojnë se duhet të ketë mjaftueshëm të dhëna që dokumenti ka ekzistuar, por që nuk gjendet për shkaqe që nuk varen nga subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, dokumentacioni nuk ka ekzistuar asnjëherë, rrethanë kjo që e bën të paaplikueshëm nenin e sipërcituar. Për pasojë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, për të ardhurat e pretenduara si të siguruara nga babai i tij nga aktiviteti blegtoral, për periudhën 1993 - 2009, nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia/barra e provës që ka në funksion të këtij procesi, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

⁸ Paragrafi 1.79 i vendimit të Komisionit.

⁹ Neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

22.5. Trupi gjykues, nga analizimi i pretendimeve të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me njohjen e të ardhurave të realizuara nga aktiviteti bujqësor e blegtoral nga babai i tij me metoda alternative, në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues, është ndalur në verifikimin e detajuar të të dhënave të rezultuara nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, në funksion të kontrollit të konkluzioneve të Komisionit në këtë drejtim, sipas të cilit këto të ardhura nuk janë provuar dhe, për pasojë, as janë njohur si të tilla në analizën financiare.

22.6. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se aktvlerësimi i hartuar më datë 26.07.2021, nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qarku Shkodër, z. M. M., i paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, shërben si një metodë alternative për vërtetimin e të ardhurave të babait të tij të realizuara nga aktiviteti blegtoral. Trupi gjykues vëren se në këtë akt pasqyrohen llogaritja e të ardhurave të përfituara nga z. N. L., nga shitja e viçave, e qengjave dhe llogaritja e sasisë së qumështit të prodhuar nga lopët e të ardhurat e përfituara nga tregtimi i tij, për periudhën 1993-2009.

Sipas llogaritjeve të bëra nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qarku Shkodër (në vijim “specialisti rajonal”), duke iu referuar 8 krerëve lopë të evidentuara, z. N. L. ka shitur 62 viça, në vlerë totale prej 2.927.400 lekësh dhe qumështin e përfutuar nga lopët, në vlerë totale prej 9.046.500 lekësh.

Sa u përket të ardhurave nga të imtat, inspektori ka vlerësuar se sasia prej 25 delesh duhet të jenë të mbarështuar që nga viti 2000, *kjo duke iu referuar edhe traditës që ndiqet në fshat për mbarështimin e dhenve, për pasojë kanë lindur mesatarisht çdo vit 25 qengja, pasi ka dele që lindin edhe nga dy qengja.* Deri në vitin 2007, specialisti rajonal ka llogaritur të jenë shitur 150 qengja, me vlerë totale 1.125.000 lekë.

Referuar këtyre të dhënave, të ardhurat, në total, të përfituara nga z. N. L., nga gjedhët (shitje qumësht dhe mish) dhe të imtat (shitje qengja) janë përllogaritur nga specialisti rajonal në vlerën prej 13.098.900 lekësh.

22.7. Nga informacioni i mësipërm, i përfutur prej aktvlerësimit të hartuar më datë 26.07.2021 nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qarku Shkodër, z. M. M., trupi gjykues konstaton se:

(i) në këtë aktvlerësim, janë pasqyruar vetëm të ardhurat e përllogaritura nga specialisti rajonal dhe jo shpenzimet, të cilat logjikisht duhet të kenë shoqëruar rritjen dhe mbarështimin e gjedhëve dhe dhenve;

(ii) specialisti rajonal nuk referon në asnjë lloj dokumenti ligjor, si aktinspektim, statistika rajonale etj., që të evidentojë numrin e saktë të viçave të lindur nga secili prej gjedhëve, pasi në kartelën individuale të kafshëve, e cila shoqëron pasaportat e identifikimit të tyre, është përcaktuar vetëm data e lindjes së gjedhit dhe jo numri i viçave të lindur, edhe pse në të ka një rubrikë të posaçme e cila duhej të ishte plotësuar me të dhëna për riprodhimin e tyre.

(iii) referimi i specialistit të tradita e mbarështimit të dhenve në fshat për të përcaktuar numrin e qengjave të lindur, pa asnjë referencë në dokumentacion ligjor ose veterinar, nuk duket bindës në këtë drejtim;

(iv) e njëjta mungesë reference evidentohet edhe për sa u përket të dhënave të përdorura nga specialisti për laktacionin e lopëve, çmimin e shitjes së viçave dhe çmimin e shitjes së qumështit, si dhe çmimin e shitjes së qengjave. Sasia prej 4.500 litrash qumësht, e përlllogaritur nga specialisti rajonal, si e prodhuar në një vit nga një lopë në fermën e z. N. L., rezulton të jetë shumë më e lartë se ajo e evidentuar në statistikat zyrtare të publikuara nga INSTAT-i¹⁰, sipas të cilave, për periudhën 1998-2003, sasia mesatare e qumështit të prodhuar nga një lopë, në një vit, varion nga 2.280 litra deri në 2.863 litra.

Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se sasia e të ardhurave të përfituara nga z. N. L., të përlllogaritura nga specialisti rajonal në aktvlerësimin e hartuar më datë 26.07.2021, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit¹¹, është e pabazuar në të dhëna që derivojnë nga dokumentacione inspektimi, nga studime të mirëfillta rajonale apo burime zyrtare, që të bindin trupin gjykues mbi vërtetësinë e të dhënave të përdorura në to, si dhe mbi rezultatin e pretenduar.

22.8. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, të drejtuar me pyetësin nr. 3, lidhur me mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga z. N. L. nga ushtrimi i aktivitetit blegtoral (duke specifikuar ku janë shitur gjedhët e dhentë, mishi dhe qumështi, nëse blerësit kanë qenë individë apo biznese, nëse ka pasur persona të tjerë të punësuar etj.), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *blerësit e viçave, të qengjave dhe të qumështit kanë qenë individë të ndryshëm dhe sistemi RUDA, në rubrikat e tij, nuk ka parashikuar personin blerës të kafshës, pasi ky aktivitet zhvillohej nga fermerët pa iu nënshtruar detyrimit për t'u regjistruar me NIPT dhe se këta përjashtoheshin nga taksimi i këtij aktiviteti.*

22.9. Në rezultatet e hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon:

i. *Personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 2.110.000 lekë për të kryer shlyerjen e parakohshme të kredisë, e cila ka shërbyer si burim për pjesën takuese të subjektit në apartamentin në Shkodër.*

ii. *Personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 4.100.000 lekë për të kryer pagesën e kësteve të apartamentit.*

Në relatimin e fakteve që e kanë orientuar drejt gjetjes së sipërcituar, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit se ka kërkuar informacion¹² nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me datën e regjistrimit të z. N. L. si fermer në regjistrin kombëtar të identifikimit të

¹⁰ http://databaza.instat.gov.al/pxëeb/sq/DST/START__BL/BL06/table/tableVieëLayout2/?rxid=c4bce1b-7e5a-4f07-8817-84e4015727c7

¹¹ Në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësit nr. 2, konkretisht në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga Komisioni për të paraqitur dokumentacion lidhur me vlerën, kohën dhe mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga z. N. L., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Bazuar në një pjesë të dokumentacionit, i është kërkuar një zootekniku të hartonte një akt vlerësimi nga viti 1993-2009, dhe ky akt është kryer më datë 26.07.2021”.

¹² Informacion i kërkuar nga Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 08.09.2021.

kafshëve dhe të regjistrimit të fermës blegtorale, statusin jetësor të gjedhëve sipas të dhënave të sistemit RUDA të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe për prodhimin e mundshëm ndër vite të kafshëve të sipërpërmendura në rajonin ku ushtrohet ky aktivitet, konkretisht: (1) rendimentin vjetor të qumështit të prodhuar për çdo vit kalendarik; (2) konsumin vjetor të qumështit për viç dhe atë për nevoja personale familjare; (3) çmimin mesatar të shitjes së qumështit për çdo vit kalendarik; (4) numrin e viçave të lindur nga secila prej lopëve të fermës; (5) çmimin mesatar të shitjes së mishit të viçit për çdo vit kalendarik; (6) kostot e mundshme fikse dhe variabël (ushqime të njoma, shpenzime veterinare, për pajisje blegtorale etj.).

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën nr. {***} prot. datë 23.09.2021, ka informuar Komisionin se ferma me pronar z. N. L., me kod ferme {***}, është regjistruar në sistemin RUDA më datë 18.10.2011. Regjistrimi individual i kafshëve dhe funksionimi i sistemit të informacionit blegtoral RUDA, ka filluar në vitin 2011 dhe, si rrjedhojë, të dhënat për matrikujt e kafshëve të llojit gjedh dhe numrin e deleve, për periudhën 2001-2009, nuk mund të verifikohen nga ana e tyre.

Bashkëlidhur shkresës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përcjellë në Komision, në formë tabelare, të dhënat lidhur me:

(i) rendimentin vjetor të qumështit të prodhuar në nivel qarku për qarkun Shkodër, për krerë lopë, për periudhën 1996-2009, i cili varion nga 2.170 litra deri në 2.863 litra¹³;

(ii) çmimin mesatar të shitjes me pakicë të qumështit në nivel republike, për periudhën 1994-2009, i cili ka pësuar rritje nga viti në vit, nga 30.6 lekë për litër në vitin 1994 deri në 61 lekë për litër në vitin 2009¹⁴;

(iii) çmimin mesatar të shitjes me pakicë të mishit të viçit në nivel republike, për periudhën 1994-2009, i cili ka pësuar rritje nga viti në vit, nga 228.5 lekë/kg në vitin 1994 deri në 720 lekë/kg në vitin 2009¹⁵.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka shpjeguar se informacioni i mësipërm është bazuar në të dhënat e sektorit të Statistikave dhe Analizave Ekonomike pranë këtij institucioni.

¹³ Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, rendimenti vjetor i qumështit të prodhuar në nivel qarku për qarkun Shkodër, për krerë lopë: për vitin 1996 - rendimenti 2.540 litra; për vitin 1997 - rendimenti 2.280 litra; për vitin 1998 - rendimenti 2.280 litra; për vitin 2000 - rendimenti 2.451 litra; për vitin 2001 - rendimenti 2.658 litra; për vitin 2002 - rendimenti 2.817 litra; për vitin 2003 - rendimenti 2.863 litra; për vitin 2004 - rendimenti 2.307 litra; për vitin 2005 - rendimenti 2.245 litra; për vitin 2006 - rendimenti 2.448 litra; për vitin 2007 - rendimenti 2.170 litra; për vitin 2008 - rendimenti 2.304 litra; për vitin 2009 - rendimenti 2.334 litra.

¹⁴ Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, çmimi mesatar i shitjes me pakicë të qumështit në nivel republike: për vitin 1994 - çmimi 30,6 lekë/litër; për vitin 1995 - çmimi 31,1 lekë/litër; për vitin 1996 - çmimi 32,2 lekë/litër; për vitin 1997 - çmimi 39,6 lekë/litër; për vitin 1998 - çmimi 49 lekë/litër; për vitin 2000 - çmimi 52 lekë/litër; për vitin 2001 - çmimi 52 lekë/litër; për vitin 2002 - çmimi 53 lekë/litër; për vitin 2003 - çmimi 53 lekë/litër; për vitin 2004 - çmimi 54 lekë/litër; për vitin 2005 - çmimi 54 lekë/litër; për vitin 2006 - çmimi 55 lekë/litër; për vitin 2007 - çmimi 56 lekë/litër; për vitin 2008 - çmimi 61 lekë/litër; për vitin 2009 - çmimi 61 lekë/litër.

¹⁵ Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, çmimi mesatar i shitjes me pakicë të mishit të viçit në nivel republike: për vitin 1994 - çmimi 228,5 lekë/kg; për vitin 1995 - çmimi 251,7 lekë/kg; për vitin 1996 - çmimi 297,7 lekë/kg; për vitin 1997 - çmimi 384,3 lekë/kg; për vitin 1998 - çmimi 583 lekë/kg; për vitin 2000 - çmimi 561 lekë/kg; për vitin 2001 - çmimi 563 lekë/kg; për vitin 2002 - çmimi 616 lekë/kg; për vitin 2003 - çmimi 629 lekë/kg; për vitin 2004 - çmimi 624 lekë/kg; për vitin 2005 - çmimi 626 lekë/kg; për vitin 2006 - çmimi 630 lekë/kg; për vitin 2007 - çmimi 635 lekë/kg; për vitin 2008 - çmimi 653 lekë/kg; për vitin 2009 - çmimi 720 lekë/kg.

22.10. Në shpjegimet e paraqitura në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, relacionin shpjegues nr. {***} prot., datë 21.10.2021, të nënshkruar nga specialisti i AMTP-së dhe Bujqësisë dhe nga administratori i Njesisë Administrative Dajç.

Nga përmbajtja e aktit të sipërcituar, trupi gjykues vëren se relacioni shpjegues është përgatitur mbi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për një përllogaritje të fitimit të realizuar nga babai i tij, z. N. L., nga sipërfaqja e tokës prej 40 dynymësh që ai ka në përdorim, për periudhën 1993-2003.

Në këtë relacion, specialisti AMTP-së dhe Bujqësisë (në vijim “specialisti i bujqësisë”) ka analizuar kostot për kulturat kryesore të destinuara për mbarështimin e blegtorisë, konkretisht për misrin dhe jonxhën, *të cilat janë dhe kulturat e kultivuara vazhdimisht nga fermeri N. L.* Për kultivimin e kulturës së misrit, specialisti i bujqësisë ka përllogaritur koston prej 58.000 lekësh për hektar, e cila përfshin: plugim, diskim, mbjellje, kultivim, spërkatje, korrje dhe transport. Sipas specialistit të bujqësisë, kjo kosto i përket një fermeri i cili nuk ka mjetet e tij bujqësore. Nëse fermeri disponon mjetet e tij, shpenzimet për një hektar kufizohen vetëm në sasinë e karburantit të përdorur për të gjitha proceset e përmendura më sipër, rreth 200 litra karburant, me vlerë 32.000 lekë për hektar dhe, në këtë rast, vlera e kursimit do të ishte 26.000 lekë për hektar. Për kulturën e jonxhës, specialisti i bujqësisë ka përllogaritur se për fermerin që nuk ka mjetet e tij, kostoja e kultivimit është 40.250 lekë për hektar, ndërsa z. N. L., duke qenë se i ka të gjitha mjetet e veta, ai shpenzon vetëm 90 litra karburant, me vlerë 14.400 lekë për hektar, duke kursyer 25.850 lekë për hektar.

22.11. Nga informacioni i mësipërm, i përfutur prej relacionit shpjegues të hartuar më datë 21.0.2021 nga specialisti i AMTP-së dhe Bujqësisë pranë Njesisë Administrative Dajç, si analizuar më sipër, trupi gjykues konstaton se: (i) megjithëse specialistit të bujqësisë i është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, përllogaritja e fitimit të realizuar nga fermeri N. L. për efekt të shfrytëzimit të tokës bujqësore prej 40 dynymësh në përdorim të tij, në relacionin shpjegues janë përllogaritur shpenzimet/kostot e kultivimit të kulturave bujqësore nga fermeri, të nevojshme për aktivitetin blegtoral; (ii) shpenzimet e përllogaritura nga specialisti i bujqësisë, referojnë një vlerë të përgjithshme shpenzimesh, pa u qartësuar dhe evidentuar nëse vlerat e përllogaritura janë vlera mesatare që i përkasin të gjithë periudhës 1993-2009, apo janë përllogaritje e shpenzimeve/kostove vjetore të kësaj periudhe; (iii) në përllogaritjen e shpenzimeve nuk është dhënë ndonjë referencë për sa u përket shifrave të pasqyruara si kosto për secilin prej veprimeve operative të nevojshme për kultivimin e kulturave, se në cilat të dhëna burimore janë mbështetur përllogaritjet që të konfirmojnë kostot përkatëse, pasi bëhet fjalë për një periudhë të shkuar të largët, por edhe për një fashë kohore prej 14 vitesh objekt analize.

Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se relacioni shpjegues i hartuar nga specialisti i AMTP-së dhe Bujqësisë pranë Njesisë Administrative Dajç, më datë 21.10.2021, duket se nuk provon shpenzimet/kostot operative reale të kryera nga fermeri N. L. për shfrytëzimin e tokës bujqësore në përdorim, për pasojë përfundimet e nxjerra në të nuk arrijnë të bindin trupin gjykues për vërtetësinë e tyre.

22.12. Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision, por edhe në parashtrimin e pretendimeve të tij në ankimin e paraqitur për shqyrtim në Kolegj, subjekti i

rivlerësimit i referohet edhe aktit “Raport me procedura të rëna dakord, për z. Ermir Lelçi”, i përgatitur nga auditues ligjore M. L., hartuar më datë 21.10.2021 (në vijim “raporti i auditimit”), si një metodë alternative për përlllogaritjen e të ardhurave të babait të tij, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për to.

22.13. Trupi gjykues, nga analizimi i raportit të auditimit, konstaton se detyrat e auditueses ligjore, të shtruara në formë pyetjesh nga subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, kanë qenë:

(i) *përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve që rrjedhin nga cilësia e të qenit fermer, në fushën e blegtorisë për shtetasin N. L. dhe të ardhura dhe shpenzime të tjera të krijuara nga ky shtetas për periudhën 1993-2009;*

(ii) *përlllogaritja e mjaftueshmërisë së fondeve të z. N. L. për blerjen e një apartamenti me pagesa të kryera: në vitin 2006 në shumën 2.400.000 lekë, në vitin 2007 në shumën 1.700.000 lekë dhe në vitin 2009 në shumën 2.100.000 lekë.*

Sipas përmbajtjes së raportit të auditimit, në përlllogaritjen e të ardhurave në shumën 13.187.900 lekë, të realizuara nga z. N. L., në cilësinë e të qenit fermer në fushën e blegtorisë, për periudhën 1993-2009, audituesja ligjore është bazuar në të dhënat e aktvlerësimit të hartuar më datë 26.07.2021, nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qarku Shkodër, z. M. M., duke vlerësuar se sasia prej mesatarisht 4.500 litra qumësht për lopë, e përlllogaritur nga specialisti rajonal, është një sasi reale për racën e lopëve që ka në zotërim z. Lelçi.

Në arritjen e këtij përfundimi, audituesja është mbështetur në një raport të vitit 1999, të publikuar nga EUROSTAT, me titull “Changes in annual milk yield”, në të cilin janë pasqyruar në formë tabelare të dhënat mesatare për rendimentin vjetor të prodhimit të qumështit për lopë, në shtetet evropiane, në vitet 1975, 1980, 1985, 1990 dhe për secilin vit të periudhës 1993-1997. Audituesja ligjore ka theksuar se, referuar këtij raporti, në asnjë shtet evropian, madje *as në shtetin fqinj Greqi, rendimenti i lopëve nuk është më i vogël se 3.000 litra qumësht në vit.*

Referuar të njëjtit raport¹⁶, trupi gjykues vëren se autori i tij¹⁷, në interpretimin e të dhënave të pasqyruara, ka analizuar: *Rendimenti vjetor i qumështit për lopë është rritur ndjeshëm gjatë 20 viteve të fundit. Ka arsye të ndryshme për këtë tendencë drejt një efikasiteti më të madh, të cilat përfshijnë metodat e përmirësuar të ushqyerjes dhe mbarështimin e racave të gjedhëve me rendiment të lartë. Në periudhën 1975 deri në vitin 1997, rendimenti mesatar vjetor i qumështit për lopë në Bashkimin Evropian u rrit me pothuajse 1.900 kg, ose afërsisht 50%. Pothuajse gjysma e kësaj rritjeje ishte në periudhën deri në futjen e sistemit të kuotave të qumështit në vitin 1984, një tregues i qartë i rëndësisë së zhvillimeve biologjike dhe teknike, kur bëhet fjalë për prodhimin eficient të qumështit. Megjithatë, futja e sistemit të kuotave të qumështit në vitin 1984, ka mbështetur trendin për rritjen e rendimentit vjetor të qumështit.*

Përmbajtjen e këtij raporti, i cili u referohet të dhënave dhe faktorëve që kanë ndikuar në rritjen e prodhimit të qumështit në nivel evropian, trupi gjykues gjen me vend ta krahasojë me Raportin e

¹⁶ <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3433488/5271301/CA-NN-99-002-EN.PDF.pdf/a457433c-26fa-4e4a-a1fb-d10ab02d45b7?t=1414687421000>

¹⁷ Albert Jerabec, “Changes in annual milk yield”, *Statistic in focus, Agriculture and fisheries, Theme 5-2/1999, faqja 1.*

Studimit të Sektorit të Qumështit, 2021¹⁸, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, GIZ, AGT International dhe DSA, në kuadër të përgatitjes së programit IPARD III për periudhën 2021-2027, në të cilin nënvizohet se: *Rendimenti mesatar i qumështit për lopë/vit në Shqipëri është afërsisht 3.000 litra; rendimenti i qumështit është rritur me 10% në dekadën e fundit (nga 2.620 litra për lopë/vit në vitin 2010), por rendimentet janë ende shumë nën mesataren e BE-së (7.346 kg për lopë/vit - EUROSTAT, 2019). Si një kategorizim i përgjithshëm, sistemet e prodhimit të qumështit në Shqipëri mund të kategorizohen gjerësisht në sistem të përzier kulturash-blegtorie dhe sistem agro-pastoral. [...] Zhvillimi i prodhimit primar të qumështit është penguar për vite me radhë nga disa faktorë, kryesorët janë: i) fragmentimi i lartë i prodhimit dhe shkalla e vogël e bujqësisë; ii) praktikat e dobëta të menaxhimit të fermave, veçanërisht ushqyerja; iii) qasja e kufizuar në inpute me cilësi të lartë; iv) plakja e pronarëve të fermave, të cilët ngadalësojnë procesin e ndryshimit dhe zvogëlojnë hapësirën për investime; v) ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve (shërbimi veterinar, shërbimi i ekstensionit, çiftëzimi natyror dhe/ose raca); dhe vi) mungesa e organizimit të fermerëve dhe koordinimi i pamjaftueshëm i zinxhirit të vlerës. Rendimenti i ulët i qumështit të lopës vjen si rezultat i disa faktorëve, siç janë: (i) shumica e lopëve nuk janë të racës së pastër; (ii) ushqyerja dhe ushqyerja e pamjaftueshme, (iii) përgatitja e ushqimit me cilësi të dobët dhe, si rezultat, mungesa e lëndëve ushqyese në racionin e ushqimit të lopëve, (iv) mungesa e njohurive të fermerëve rreth mbarështimit të duhur të lopëve, gjë që ka çuar në pjellori të dobët, çrregullime metabolike dhe probleme shëndetësore dhe mirëqenieje. [...] Lopët e qumështit zakonisht mbahen në stalla të thjeshta, ushqehen kryesisht me foragjere të freskëta dhe kullusin në kullota dhe livadhe gjatë periudhës së pranverës dhe verës, ndërsa në dimër ushqehen me sanë dhe plotësohen me ushqim të koncentruar dhe minerale. Vetëm fermerët e mëdhenj kanë investuar në stalla moderne dhe kanë filluar të zbatojnë kryesisht regjimin e prodhimit në stalla. Fermat e qumështit me një numër të vogël lopësh zakonisht i mjelin lopët e tyre me dorë dhe nuk përdorin rezervuarë ftohjeje, ndërsa ato më të mëdha kanë pajisje moderne mjeljeje dhe sistem ftohjeje.*

22.14. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se faktorët e cituar më sipër, të cilët evidentojnë një strukturë/sisteme të ndryshme prodhimi, bëjnë shumë të vështirë krahasimin e rendimentit të prodhimit të qumështit në vendet evropiane me atë në vendin tonë. Sa më sipër, si dhe në vijim të analizës së bërë më sipër në këtë vendim, trupi gjykues nuk bindet mbi vërtetësinë e të dhënave të referuara në aktvlerësimin e hartuar më datë 26.07.2021, nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qarku Shkodër e për rrjedhojë, edhe referimi i auditueses ligjore të këto të dhëna, duke i krahasuar ato me të dhënat e rendimentit të prodhimit të qumështit nga lopët në vendet e Bashkimit Evropian, nuk është aspak bindës. Trupi gjykues vëren gjithashtu se audituesja ligjore, edhe pse ka pasur në dispozicion të dhëna mbi rendimentin vjetor të qumështit të prodhuar në nivel qarku për qarkun Shkodër¹⁹, për krerë lopë, për secilin vit të periudhës 1993-2009, të përcjella nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komision,

¹⁸ Faqe 9, 22, 25.

¹⁹ Të dhënat e përcjella në Komision nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.09.2021, analizuar në mënyrë të detajuar në paragrafin 22.9, më sipër, në këtë vendim.

të cilat përfaqësojnë të dhënat zyrtare të besueshme, të lëvruara nga organi kompetent për mbikëqyrjen dhe kontrollin në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, por edhe të dhënat specifike për rastin konkret, duket se qëllimisht nuk i ka përdorur ato, pasi të dhënat e rendimentit të qumështit në vendin tonë/qarkun Shkodër, janë më të ulëta sesa ato në nivel evropian e, për pasojë, të pafavorshme për të justifikuar situatën financiare të z. N. L..

Të njëjtin qëndrim, trupi gjykues mban edhe sa i përket një varianti të dytë të përllogaritjes së të ardhurave të z. N. L. nga aktiviteti blegtoral, në të cilin audituesja ligjore u është referuar të dhënave të INSTAT-it për rendimentin e prodhimit të qumështit ndër vite, në shkallë vendi. Trupi gjykues e gjen të panevojshëm referimin në këto të dhëna, në kushtet kur audituesja ligjore kishte në dispozicion të dhënat zyrtare specifike për rendimentin e prodhimit të qumështit në qarkun e Shkodrës, për periudhën e marrë në analizë, të ofruara nga ministria përkatëse.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se të dhënat dhe përllogaritjet në këtë raport auditimi nuk provojnë vlerën e të ardhurave të pretenduara të realizuara nga z. N. L., në cilësinë e të qenit fermer, në fushën e blegtorisë.

22.15. Sa i përket përllogaritjes së shpenzimeve të kryera nga z. N. L., në kuadër të aktivitetit blegtoral, audituesja ligjore i është referuar metodologjisë dhe të dhënave të pasqyruara në një dokument të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me titull “Manuali mbi menaxhimin e biznesit në fermë” (në vijim “manuali”), orientuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ. Në një nga rubrikat e këtij manuali, me titull “Fitimi bruto”, përshkruhen dhe përllogariten, në formë tabelare, të ardhurat dhe zërat e kostove variabël për një lopë qumështi në vit, në një fermë, nga rezulton se fitimi bruto është në masën 32,3% të të ardhurave të realizuara. Sipas auditueses ligjore, fitimi bruto në fermën e z. N. L., është në masën 53,1% të të ardhurave, duke argumentuar se ka arritur në përllogaritjen e kësaj mase fitimi duke ulur shpenzimet e nevojshme për një lopë, pasi, sipas saj, në strukturën e kostos, në tabelën e paraqitur në manual, tre zëra të saj, konkretisht: “ushqime të njoma”, “ushqime të thata”, “koncentratë”, duhet të përllogariten në vlerë zero, për arsye se të gjitha këto lëndë ushqyese, z. N. L. i ka prodhuar në tokën me sipërfaqe 40 dynmë që ka në përdorim. Në këto kushte, audituesja ligjore ka përllogaritur kostot nga cilësia e të qenit fermer për periudhën 1993-2009, për z. Lelçi, në masën prej 46,9% të të ardhurave ose 6.143.384 lekë në variantin e përllogaritjes së të ardhurave bazuar në të dhënat e rendimentit të qumështit/lopë sipas Eurostat-it, dhe 5.685.177 lekë në variantin e përllogaritjes së të ardhurave bazuar në të dhënat e rendimentit të qumështit/lopë sipas INSTAT-it.

Në vlerësim të auditueses ligjore, nëse këto produkte do të ishin blerë, atëherë qëndron struktura e kostos e pasqyruar në manual, por z. Lelçi, referuar edhe relacionit shpjegues nr. {***}, datë 21.10.2021, të specialistit të bujqësisë në Njësinë Administrative Dajç, ka strukturë kostoje pa përfaqësimin e kostove për ushqimin e blegtorisë.

22.16. Trupi gjykues, në ndryshim nga audituesja ligjore, vëren se: a) në manual, në tabelën nr. 2 “Fitimi bruto/një lopë qumështi” objekt reference²⁰, në zërat e kostos variabël dedikuar

²⁰ <https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/Manuali-mbi-Menaxhimin-e-Biznesit-ne-Ferme.pdf>, faqja 13.

shpenzimeve që kryen fermeri për ushqimin e një lope, është pasqyruar qartë se këto produkte prodhohen në fermë, pasi në krah të përshkrimit të secilës prej kostove, është vendosur shënimi “prodhuar në fermë”; b) në relacionin shpjegues nr. {***}, datë 21.10.2021, specialisti i AMTP-së dhe Bujqësisë në Njësinë Administrative Dajç ka përllogaritur kosto për prodhimin e bazës ushqimore për blegtorinë në fermën e z. Lelçi, konkretisht: shumë 32.000 lekë/vit për një hektar²¹ për prodhimin e misrit dhe 14.400 lekë/vit për një hektar²² për prodhimin e jonxhës, referuar sipërfaqes së mbjellë. Këto vlera, sipas specialistit përkatës, janë të reduktuara vetëm në shpenzime karburanti, pasi z. Lelçi ka mjete bujqësore të vetat.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se niveli i fitimit i përllogaritur nga audituesja ligjore, jo vetëm është i pambështetur në aktet që ajo vetë referon se kanë shërbyer si bazë të dhënash, por përkundrazi është një përpjekje për të minimizuar shpenzimet e fermës së z. Lelçi, me qëllim rritjen në mënyrë fiktive të fitimit bruto të pretenduar si të realizuar prej tij.

22.17. Audituesja ligjore ka përllogaritur edhe të ardhura të tjera shtesë të z. N. L., të cilat ajo i ka kualifikuar si “të ardhura të familjes bujqësore”, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, në një vrojtim statistikor të vitit 2007, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes. Lidhur me këto të ardhura, trupi gjykues vëren se: *së pari*, tipologjia e tyre, referuar të dhënave statistikore të INSTAT-it, është “Të ardhurat mujore sipas madhësisë së familjes-zona rurale”, që do të thotë se përfshijnë të ardhurat e familjeve që banojnë në zonat rurale, pavarësisht aktivitetit që ato ushtrojnë: bujqësor ose blegtoral. Në këtë kontekst, përllogaritja e të ardhurave të tjera shtesë për familjen e z. N. L., mbi ato të përfituara nga aktiviteti blegtoral, jo vetëm që nuk shkon në të njëjtën linjë me të dhënat e publikuara nga INSTAT-i, por nuk u përgjigjet as të dhënave të rezultuara nga aktet e vlerësimit të hartuara me kërkesë të subjektit të rivlerësimit nga specialistët përkatës vendorë e rajonalë, sipas të cilëve z. N. L. ka kryer aktivitet blegtoral, ndërsa aktiviteti bujqësor në tokën prej 40 dynmësh që ka në përdorim, është ushtruar në funksion të prodhimit të ushqimit për gjedhët dhe të imtat; *së dyti*, të ardhurat vjetore për një familje me tre persona janë përllogaritur nga audituesja ligjore në shumë 396.468 lekë, ndërsa referuar INSTAT-it²³, të ardhurat vjetore për një familje me tre persona që jeton në zonë rurale, përllogariten në shumë 374.208 lekë²⁴. Në kushtet kur të dhënat e vitit 2007 janë përdorur nga audituesja si bazë për përllogaritjen e të gjithë viteve të tjera të periudhës (duke zbritur ose shtuar normën e inflacionit), pasaktësia në përllogaritjen e tyre ka afektuar shumë e të ardhurave të përllogaritura për secilin vit të periudhës së marrë në analizë. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përllogaritura nga audituesja ligjore, në zërin “Të ardhurat si familje bujqësore të z. N. L.”, përveç se nuk reflektojnë korrektësisht bazën e të

²¹ Z. N. L. ka në përdorim një sipërfaqe toke prej 40 dynmësh ose 4 ha, për rrjedhojë kostoja e karburantit e përllogaritur sipas specialistit përkatës, do të ishte: 32.000 lekë/ha x 4 ha = 128.000 lekë/vit, në rast se e gjithë sipërfaqja do të mbillej vetëm me misër.

²² Kostoja e karburantit e përllogaritur sipas specialistit përkatës, do të ishte: 14.400 lekë/ha x 4 ha = 57.600 lekë/vit, në rast se e gjithë sipërfaqja do të mbillej vetëm me jonxhë. Sipas specialistit, jonxha është një kulturë që mbillet vetëm një herë në 4 vjet.

²³ https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_HBS_IN/IN0012/table/tableViewLayout1/

²⁴ Referuar të dhënave të INSTAT-it, të ardhurat mujore për një familje me tre persona në zonat rurale, janë në shumë 31.184 lekë. Për pasojë, të ardhurat vjetore janë në shumë 31.184 lekë x 12 muaj = 374.208 lekë.

dhënave të INSTAT-it, janë edhe të ardhura të përlllogaritura një herë, si pjesë e fitimit bruto të pretenduar se është realizuar nga aktiviteti blegtoral në fermën e familjes së z. N. L..

22.18. Sa u takon shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues vëren se audituesja ligjore i ka përlllogaritur ato për periudhën 1993-2009, duke marrë për bazë të ardhurat për frymë në një familje, sipas kategorive të INSTAT-it, me emërtimin “Zonë qendrore”, sipas përbërjes së familjes së z. N. L., në secilin vit të periudhës së analizuar, në vlerë totale prej 6.770.333 lekësh.

Trupi gjykues vëren se inputet e përdorura si më sipër nga audituesja ligjore, nuk respektojnë qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij se, në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë, përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, familjet e tyre dhe personat e tjerë të lidhur me ta, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste²⁵. Shpenzimet e jetesës të përlllogaritura sipas standardit të mësipërm, kanë për qëllim të standardizojnë dhe unifikojnë këto shpenzime për të gjithë shtetasit shqiptarë. Këto shpenzime janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, çka do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, apo personat e tjerë të lidhur. Në rastin konkret, audituesja ligjore, edhe pse i janë vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit të dhënat e shpenzimeve të jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së bazuar në INSTAT, nuk ka paraqitur asnjë argument se pse nuk i ka përdorur këto të dhëna për periudhën 2000-2009. Për sa i përket periudhës 1993-1999, audituesja ligjore duhet të kishte konsideruar shpenzimet e jetesës së familjes së z. N. L. në nivelin 66% të të ardhurave të realizuara, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit²⁶. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se në raportin e auditimit edhe llogaritja e shpenzimeve të jetesës për familjen e z. N. L., nuk plotëson standardin e një përlllogaritjeje të drejtë dhe objektive.

Në përmbledhje, trupi gjykues vlerësoi se Raporti i Auditimit nuk ka vlerë provuese për pretendimet e subjektit të rivlerësimit, duke qenë se më shumë sesa një herë në këtë akt, konstatohet pasqyrim jo i vërtetë i fakteve e rrethanave, krahasuar me të dhënat që burojnë nga dokumentet zyrtare, si burime të njohura në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

22.19. Në përfundim të analizës si më sipër, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, çmon se të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga z. N. L. nga aktiviteti blegtoral për periudhën 1993-2009, nuk u provuan me dokumente ligjore nga ato të parashikuara nga neni 49 i ligjit nr. 86/2016, duke mbetur në nivel deklarativ, pasi subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë as me dokumentacion provues dhe as me metodat alternative të zgjedhura prej tij, sasinë dhe pagesat e pretenduara të përfituara nga shitja e produkteve blegtorale, ndër vite, nga babai i tij. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se babai i tij kishte të ardhura të ligjshme për të

²⁵ Vendimet i Kolegjit nr. 9/2023 (JR); nr. 15/2023 (JR); 31/2023 (JR) etj.

²⁶ Vendimi nr. 15/2021 (JR) i Kolegjit.

justifikuar krijimin e pjesës takuese prej 2/3 të pasurisë “apartament”, në shumën 4.100.000 lekë, si dhe për t’i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 2.110.000 lekësh për të shlyer kredinë e marrë në Tirana Bank për blerjen e 1/3 pjesë takuese në këtë pasuri.

22.20. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në raportin e audituesit ligjor nuk janë përfshirë të ardhurat e motrës së tij A. L. (S.) për shkak se dokumenti që provon të ardhurat e saj është dorëzuar në Komision pas dorëzimit të raportit të auditimit dhe se këto të ardhura, të përlllogaritura në vlerë neto prej 948.777 lekësh, rrisin balancën pozitive të babait të tij, trupi gjykues vëren se bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur certifikatën familjare nr. {***}, të lëshuar nga Njësia Administrative Dajç, në të cilën znj. A. L. figuron në të njëjtën përbërje familjare me z. N. dhe znj. L. L.. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu edhe “Vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare” nr. {***} prot., datë 21.10.2021, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Shkodër, në të cilin pasqyrohen të ardhurat bruto të përfituara nga znj. A. L. (S.), për periudhën shkurt 2007 - dhjetor 2011. Pavarësisht paraqitjes së akteve të sipërcituara, trupi gjykues vëren se pretendimi për përfshirjen e të ardhurave të motrës A. L. në të ardhurat e familjes së babait të tij, është një pretendim i prezantuar për herë të parë në ankim dhe nuk është paraqitur para Komisionit me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si një fakt për t’u verifikuar prej tij, për pasojë konsiderohet si një pretendim i rënë në dekadencë, sipas parashikimit të nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile²⁷. Por edhe në një qasje garantiste, trupi gjykues vlerëson se shuma e pretenduar prej 948.777 lekësh, nga të ardhurat bruto të motrës së subjektit të rivlerësimit, do të përbënte të ardhurën e vetme të ligjshme të familjes së z. N. L., e provuar me dokumentacion justifikues ligjor, e për pasojë kjo e ardhur nuk do të ishte e mjaftueshme për të përballuar pagesat e kryera për blerjen e pasurisë “apartament” në shumën 4.100.000 lekë nga z. N. L., si dhe për të përballuar dhurimin e shumës prej 2.110.000 lekësh subjektit të rivlerësimit, për shlyerjen e kredisë bankare.

- 23.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *është tërësisht i pabazuar dhe jo i logjikshëm konkluzioni i Komisionit se është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pronësinë mbi këtë apartament në masën 33% dhe përdorimin e pjesës takuese prej 67% në pronësi të babait të tij, duke ngritur dyshime të arsyeshme për paraqitjen e rrethanave jo të vërteta, rrethana të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë me këtë pasuri dhe, për pasojë, edhe të burimit të krijimit të saj në shumën 4.100.000 lekë, që përbëhet nga këstet e paguara nga babai i subjektit, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

23.1. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke argumentuar se pjesët takuese të secilit bashkëpronar në pasurinë “apartament” janë pasqyruar në kontratën noteriale të shitblerjes së pasurisë, një akt ky me fuqi të plotë provuese, në përputhje jo vetëm me vullnetin e lirë të palëve, por edhe në raport me vlerën e paguar prej secilit prej tyre. Prindërit e subjektit kanë jetuar gjithë jetën në fshat, por ata nuk do të jenë gjithmonë të rinj dhe të aftë për të

²⁷ Neni 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, parashikon se: “Në ankim nuk mund të parashtrihen kërtime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë”.

mbajtur ekonominë e tyre bujqësore dhe blegtorale, prandaj është logjike që në rrethana të tilla të sigurojnë një banesë pranë fëmijës së tyre për momentet në të cilat do të kenë nevojë për përkujdesje. Është e vërtetë që në kontratën e kaparit figuron si blerës vetëm subjekti i rivlerësimit, por është provuar tej çdo dyshimi, se transfertat bankare për pagesat e kësteve për blerjen e pasurisë janë kryer në vitin 2006 nga babai i tij, nga llogaria personale. Llogaria bankare e babait të subjektit të rivlerësimit është çelur të paktën tri vite më parë nga momenti i lidhjes së kontratës së kaparit dhe nga fakti që dy shuma janë depozituar në ditën e kryerjes së një pagese apo të shlyerjes së kredisë, nuk mund të lindë asnjë dyshim. Subjekti i rivlerësimit është një nga bashkëpronarët që ka jetuar në pasurinë “apartament” dhe është krejt e logjikshme që kontratat e energjisë elektrike dhe ujësjellësit të jenë lidhur në emër të tij. Sigurisht që subjekti ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të pandërprerë me këtë apartament, pasi ajo është e vetmja banesë që ai ka në bashkëpronësi me babain e tij, në qytetin e Shkodrës, ku jeton dhe punon. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një banesë, ku pjesa takuese e babait është përdorur nga subjekti i rivlerësimit. Jurisprudenca e Kolegjit, sipas subjektit të rivlerësimit, është konsoliduar tashmë, duke përcaktuar limitin se deri ku duhet të shtrihet barra e provës për personat e tjerë të lidhur, sidomos në kushtet kur kemi të bëjmë me përdorimin e banesave të prindërve. Vetë Komisioni, në vendim, përcakton se babai i subjektit është person tjetër i lidhur për sa i përket dhurimit të shumës prej 2.110.000 lekësh për shlyerjen e parakohshme të kredisë, por në kundërshtim me këtë përcaktim, subjektit i është ngarkuar si barrë prove edhe ligjshmëria e burimit të krijimit të vlerës që përbën pjesën takuese të pasurisë “apartament”, në pronësi të babait të tij.

23.2. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim²⁸, trupi gjykues vëren si vijon.

23.2.1. Referuar kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2007, pronësia e pasurisë “apartament banimi me sip. 138 m² në Shkodër” i kalon në 2/3 pjesë z. N. L. dhe në 1/3 z. Ermir Lelçi. Subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij kanë një marrëdhënie bashkëpronësie në pasurinë “apartament”, për pasojë kjo marrëdhënie interesi pasuror mes tyre nuk përfshihet në gamën e marrëdhënieve të përcaktuara shprehimisht në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që do të justifikonte cilësimin e tij si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në vlerësim të vendimmarrjeve të mëparshme të Kolegjit, të cituara edhe nga subjekti i rivlerësimit në ankim, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë, nga hetimi administrativ, nuk rezulton asnjë gjetje mbi bazën e së cilës mund të ngrihen dyshime të arsyeshme në lidhje me përfshirjen reale të këtyre personave në investim, dyshime për fshehje nga ana e subjektit të rivlerësimit, të pasurisë së tij në emër të personave të tjerë të lidhur²⁹.

²⁸ Paragrafi 18, më sipër në këtë vendim.

²⁹ Jurisprudenca e Kolegjit në vendimet: nr. 15/2019 (JR); nr. 14/2021 (JR); nr. 7/2020 (JR); nr. 20/2021 (JR); nr. 31/2021 (JR), nr. 10/2022 (JR) etj.

23.2.2. Nga verifikimi i rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se Komisioni, në shpjegimin e gjetjeve mbi të cilat i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, është shprehur: *Komisioni vëren disa rrethana, konkretisht: (i) nga dokumentacioni i administruar dhe nga shpjegimet e subjektit, vërehet se babai i subjektit ka investuar në një pasuri të paluajtshme në Shkodër, ndërkohë që ka banuar dhe vazhdon të banojë në fshat, për shkak të ushtrimit të aktivitetit blegtoral; (ii) në kontratën e kaparit figuron si blerës vetëm subjekti dhe në përshkrimin e dy transfertave të kryera në vitin 2006 nga babai i subjektit, është specifikuar se pagesat janë për Ermir Lelçi (“Kësti I për blerje Ermir Lelçi” dhe “Kësti II për blerje apartamenti Ermir Lelçi”); (iii) kontratat e energjisë elektrike dhe ujësjellësit janë lidhur në emër të subjektit; (iv) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të pandërprerë me këtë apartament, duke qenë se subjekti bashkë me familjen kanë jetuar në këtë apartament. Këto rrethana tregojnë se subjekti, pavarësisht se zotëron vetëm 33% pjesë takuese, pa kontribut financiar, është poseduesi i vetëm i këtij apartamenti, në mënyrë të pandërprerë që nga blerja e tij e në vijim. Për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi se është e nevojshme që të analizohet jo vetëm legjitimiteti i burimeve financiare të babait, në vlerën 2.110.000 lekë, që kanë shërbyer për mbylljen e parakohshme të kredisë, por edhe për shumën 4.100.000 lekë që ka shërbyer për pagesën e kësteve të apartamentit. Në analizën e pasurisë objekt kontrolli, Komisioni, në vendim³⁰, ka ngritur dyshime për paraqitjen e rrethanave jo të vërteta, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë me këtë pasuri dhe, për pasojë, edhe të burimit të krijimit të saj në vlerën 4.100.000 lekë, që përbëhet nga këstet e paguara nga babai i subjektit dhe më tej, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

23.3. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk do të ketë detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pjesës takuese prej 2/3 të pasurisë “apartament” në pronësi të babait të tij, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por ky konkluzion nuk kufizon Komisionin të bëjë hetimet e duhura për të verifikuar dyshimet e ngritura se kjo pjesë e pasurisë është pasuri e fshehur e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, në vlerësimin e trupit gjykues, veprimtaria hetimore e Komisionit është e legjitimuar, për pasojë, pretendimi se Komisioni nuk duhet të kishte hetuar dhe verifikuar mbi burimet e krijimit të pjesës takuese të z. N. L. në pasurinë objekt kontrolli, nuk gjendet i bazuar në jurisprudencën e Kolegjit.

23.4. Në referencë të të dhënave të rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, në vijim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi, si vijon.

(a) Kontrata e kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2006, e lidhur ndërmjet z. A. Ç. dhe z. Ermir Lelçi, pavarësisht titullit të saj, “Kontratë kapari”, përmban të gjitha elementet e një kontrate porosie, pasi përcakton çmimin e shitjes së pasurisë, këstet dhe datat e pagesës së tyre, përshkrimin e specifikimeve teknike të pasurisë që do të shitet, kohën e përfundimit të

³⁰ Në paragrafët 1.48; 1.82 dhe 1.83 të vendimit të Komisionit.

apartamentit, penalitet që do të paguhen nga *sipërmarrësi ndaj porositësit*³¹ në rast të mosmbarimit në afat të punimeve të ndërtimit, si dhe penalitetet që do të paguante porositësi në rast të mospagimit të kësteve në afatet e parashikuara në këtë kontratë. Shpjegimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, se në kontratën e kaparit figuron si blerës vetëm ai, pasi ka qenë një pakujdesi e noterit, i cili pavarësisht se kishte në dispozicion dokumentacionin e pagesës së shumës 1.000.000 lekë nga z. N. L., nuk e ka përfshirë atë si palë në këtë kontratë kapari, nuk arrin të bindë trupin gjykues për vërtetësinë e tij. Nëse qëllimi i subjektit të rivlerësimit, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, do të kishte qenë përfshirja e babait të tij si palë, atëherë pakujdesia e pretenduar nga noteri publik do të duhet të ishte evidentuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, pasi ai jo vetëm ka nënshkruar i vetëm, por në përmbajtjen e kontratës qartësisht referohet se përpara noterit janë paraqitur personalisht vetëm z. A. Ç. e z. Ermir Lelçi, të cilët janë njohur e kanë pranuar përmbajtjen e kontratës, duke e nënshkruar rregullisht atë.

(b) Transfertat bankare të kryera nga llogaria e z. N. L. në llogarinë e z. A. Ç., në vitin 2006, kanë përshkrimin “Kësti I për blerje apartamenti Ermir Lelçi” dhe “Kësti II për blerje apartamenti Ermir Lelçi”, fakte këto që provojnë se pagesat e kryera nga z. N. L. janë bërë për llogari të subjektit të rivlerësimit, një rrjedhojë logjike kjo, referuar përmbajtjes së kontratës së kaparit, në të cilën subjekti i rivlerësimit figuronte i vetëm në cilësinë e palës blerëse të pasurisë “apartament”. Këto pagesa janë kryer nga z. N. L. për llogari të subjektit të rivlerësimit, edhe pse ky i fundit, ashtu siç ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të drejtuar nga Komisioni, i ka bërë të qartë babait të tij se pronësia e apartamentit do të regjistrohej në emrin e të dyve dhe se ai do të merrte kredi, e cila do t’i korrespondonte pjesës së tij takuese. Pra, logjikisht, nën dritën e këtyre rrethanave, z. N. L. nuk kishte pse të paguante kështu e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur pretendohet se z. N. do të ishte pronari me pjesën takuese në 2/3 e kësaj pasurie.

(c) Kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij me kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, pranë Tirana Bank, me qëllim pagesën e pjesës takuese prej 1/3 të subjektit të rivlerësimit, është shlyer tërësisht, para afatit, nga z. N. L. dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë detyrim ndaj babait të tij, lidhur me këtë veprim juridiko-financiar, duke rezultuar kështu se apartamenti, *de facto*, është paguar tërësisht nga babai i subjektit të rivlerësimit.

(ç) Subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar asnjë arsye bindëse, se pse kredia bankare e marrë në vitin 2007, me qëllim financimin e blerjes prej tij të pjesës takuese në pasurinë “apartament”, u shlye tërësisht nga babai i tij.

(d) Babai i subjektit të rivlerësimit, z. N. L., ka investuar në blerjen e një apartamenti me sip. 138 m² në Shkodër, në shumën 6.200.000 lekë, ndërkohë që ka banuar dhe vazhdon të banojë në fshatin {***}, Dajç, Shkodër, për shkak të ushtrimit të aktivitetit blegtoral.

³¹ *Terma të përdorur në tekstin e kontratës së kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2006, e lidhur ndërmjet shtetasve A. Ç. dhe Ermir Lelçi.*

(dh) Babai i subjektit të rivlerësimit ka investuar në blerjen e një apartamenti me sip. 138 m² në Shkodër, ndërkohë që kishte në pronësi një apartament në Shkodër me sip. 25 m², të blerë në shumën 350.000 lekë në vitin 1998 dhe të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër në vitin 2006, në të cilin duket se nuk ka jetuar për të njëjtën arsye – të ushtrimit të aktivitetit blegtoral në fshat.

(e) Edhe pse nuk ka pasur asnjëherë qëllim të jetojë në qytet, z. N. L. ka investuar në blerjen e një apartamenti të dytë në Shkodër, me një çmim të konsiderueshëm prej 6.200.000 lekësh, duke shpenzuar pothuajse gjithë kursimet e pretenduara se janë realizuar gjatë një periudhe të gjatë kohe, rreth 16-vjeçare, në periudhën 1993-2009, dhe kjo në funksion të nevojave të vetëm njërit prej fëmijëve të tij.

(ë) Pasuria “apartament” është përdorur në mënyrë ekskluzive dhe të pandërprerë nga subjekti i rivlerësimit, që nga momenti i blerjes së pasurisë në vitin 2007 e në vijim, edhe pse ai kishte vetëm 1/3 pjesë të saj në pronësi. Referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision³², z. N. L. dhe znj. L. L., të paktën deri në vitin 2021 (në momentin e dhënies së këtyre shpjegimeve nga subjekti), kanë jetuar në fshatin {***}, Njësia Administrative Dajç, Shkodër, dhe në ndonjë periudhë të shkurtër në pasurinë “apartament me sipërfaqe 138 m²” të ndodhur në Shkodër, edhe pse tashmë aktivitetin blegtoral e ushtrojnë në mënyrë të reduktuar dhe banesa në të cilën ata jetojnë në fshat e ndërtuar që prej vitit 1967, *është shumë e amortizuar, çka e bën të pamundur shfrytëzimin e plotë* dhe z. N. L. ka bërë disa investime të pjesshme për të krijuar pak a shumë kushte banimi.

(f) Kontratat e energjisë elektrike dhe ujësjellësit janë lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit dhe mobilimi i apartamentit është kryer nga subjekti i rivlerësimit, një fakt ky që tregon se subjekti i rivlerësimit, edhe pse dispononte vetëm 1/3 pjesë të pasurisë, është sjellë si pronari *de facto* i tërësisë së saj.

(g) Nga hetimi dhe verifikimi i Komisionit, ka rezultuar se babai i subjektit të rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues burimet financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, konkluzion ky që u konfirmua edhe nga trupi gjykues, më sipër në këtë vendim.

23.5. Nga analiza logjike e të gjitha fakteve që kanë rezultuar nga procesi, të analizuara më lart, krahas faktit se babai i tij nuk justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, çmohet se është i drejtë dhe i mbështetur në situatën faktike konkluzioni i Komisionit, se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se zotëron vetëm 33% të pasurisë “apartament” nuk bind për vërtetësinë e tij, pasi të gjitha rrethanat e analizuara në një vlerësim objektiv dhe harmonik, janë në favor të përfundimit se subjekti i rivlerësimit është pronari *de facto* i kësaj pasurie dhe deklarimi i babait të tij si pronar i 2/3 pjesë të pasurisë “apartament” është një përpjekje e tij për të fshehur nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë e të vërtetë të pronësisë me këtë pasuri të paluajtshme dhe, për pasojë, edhe të burimit të krijimit të saj. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit

³² Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, të depozituara në Komision më datë 28.07.2021.

gjendet në situatën faktike që kualifikohet sipas parashikimit të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

23.6. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se për pasurinë “apartament banimi, me sipërfaqe 138 m², në Shkodër”, deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në pronësi në 2/3 pjesë të z. N. L. dhe në 1/3 pjesë të z. Ermir Lelçi, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.

○ ***Për pasurinë “tokë bujqësore në përdorim të familjes së z. N. L.” dhe pasurinë “tokë bujqësore në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit”***

24. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, në ankim, se *konkluzioni i Komisionit për pasurinë “tokë bujqësore në përdorim të familjes së z. N. L.” është i gabuar, se vetëm pasi babai i tij të pajiset me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, familja e tij bujqësore (një nga anëtarët e së cilës është dhe subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”) do të bëhet pronare e kësaj pasurie. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk mund të deklaronte një pasuri të paluajtshme, e cila nuk përdoret prej tij dhe nuk i ka kaluar ende në pronësi.*

24.1. Në analizë të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstaton se në vendim³³, Komisioni, pas kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë “tokë bujqësore në përdorim të familjes së z. N. L.”, ka konkluduar: *Në përfundim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën “vetting”, i pjesës takuese në tokën bujqësore të përfutur në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.*

Në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, Komisioni, konkluzionin e sipërcituar, nuk e ka renditur në përfundimet që kanë shërbyer për vlerësimin tërësor të këtij kriteri dhe, për rrjedhojë, nuk e ka renditur në shkaqet që kanë ndikuar në marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për këtë pasuri, nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes.

24.2. E njëjta situatë konstatohet nga trupi gjykues edhe për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, lidhur me pasurinë “tokë bujqësore” në pronësi të bashkëshortes së tij, për të cilën Komisioni, në vendim³⁴, ka arritur në konkluzionin se: *Në përfundim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën “vetting”, i pjesës takuese në tokën bujqësore të përfutur në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.* Për pasojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes.

³³ Paragrafi 6.14 i vendimit të Komisionit.

³⁴ Paragrafi 7.9 i vendimit të Komisionit.

○ ***Për analizën financiare për periudhën 2003-2016***

25. Trupi gjykues mori në shqyrtim, gjithashtu, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me anë të të cilave ai ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003 - 2016. Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, nga analiza ekonomike e kryer, është konkluduar që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe pagimin e detyrimeve në shumën totale (-) 4.723.948 lekë, pasi ka rezultuar me balancë negative të fondeve për vitin 2006 në shumën (-) 2.087.556 lekë; për vitin 2007 në shumën (-) 1.218.722 lekë dhe për vitin 2009 në shumën (-) 1.417.670 lekë.

26.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se *kjo analizë është e gabuar për shkak se pagesat e kryera nga babai i tij për blerjen e pasurisë “apartament” në vitet 2006 dhe 2007 janë konsideruar si të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Në të njëjtën mënyrë, Komisioni ka konsideruar edhe shpenzimin e kryer në vitin 2009 nga babai i tij për shlyerjen totale të kredisë në vlerën 2.110.000 lekë, si një shumë të paguar nga subjekti i rivlerësimit.*

Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se babai i tij ka kryer pagesat e sipërcituara për të përfituar pjesën e tij takuese në masën 67% të pasurisë “apartament”, në vitin 2006 dhe vitin 2007 në shumën 4.100.000 lekë, dhe në vitin 2009 ai ka shlyer dhe vlerën e kredisë bankare për llogari të subjektit të rivlerësimit. Babai i tij, z. N. L., ka pasur të ardhura të ligjshme jo vetëm për të përballuar shumën prej 2.110.000 lekësh, dhuruar subjektit të rivlerësimit, por për të gjitha pagesat e kryera, edhe pse për sa u takon këtyre pagesave për blerjen e pjesës së vet takuese në pasurinë apartament, ai nuk mund të cilësohet si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

26.2. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se pretendimet e tij lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i tij, z. N. L., nga aktiviteti blegtoral, në periudhën 1993-2009, janë trajtuar me detaje më sipër në këtë vendim, nga ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se babai i tij kishte të ardhura të ligjshme për të justifikuar krijimin e pjesës takuese prej 67% të pasurisë “apartament” në shumën 4.100.000 lekë, si dhe për t’i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën prej 2.110.000 lekësh për të shlyer kredinë e marrë në Tirana Bank për blerjen e pjesës takuese prej 33% në këtë pasuri.

Gjithashtu, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të së drejtës së plotë të pronësisë së pasurisë “apartament”, në përpjekje për të shmangur nga kontrolli apo verifikimi burimin e krijimit të saj në shumën 4.100.000 lekë, që përbëhet nga këstet e paguara nga babai i tij.

Në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit pagesat e kryera nga babai i subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë “apartament”, në vitin 2006 në shumën 2.400.000 lekë dhe në vitin 2007 në shumën 1.700.000 lekë, si dhe shlyerja e parakohshme e kredisë bankare në shumën 2.110.000 lekë, i janë ngarkuar si shpenzime subjektit të rivlerësimit.

26.3. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision për periudhën 2003-2016, u konfirmuan mungesat e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar plotësisht shpenzimet, kursimet në *cash* dhe investimet e kryera prej tij për vitin 2006 në shumën (-) 2.087.566 lekë; për vitin 2007 në shumën (-) 1.218.772 lekë dhe në vitin 2009 në shumën (-) 1.417.670 lekë, me një total pamjaftueshmërie të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 4.723.947 lekë. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

27. Në vlerësim të qëndrimeve të konkluduara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, për pasojë gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

28. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, në parashtrimin e konsideratave të përgjithshme, ka pretenduar se në procesin e rivlerësimit, vlerësimi i aftësive profesionale është veçanërisht i ndjeshëm, në dritën e nevojës për të shmangur dëmtimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në ushtrimin e pavarur të diskrecionit gjyqësor. Sipas subjektit të rivlerësimit, modalitetet dhe kufijtë e vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni i Venecias, ndërsa treguesit kryesorë për vlerësim, po ashtu edhe vlerësimi në mënyrë të detajuar, sigurohet nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ku ligji nr. 84/2016 referon. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në kundërshtim me rezultatet e arritura nga KLP-ja, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, provat e administruara, ngarkesën e punës së përballuar prej tij, prej rreth 722 çështjesh penale, gjatë tri viteve të fundit të ushtrimit të detyrës, si dhe me jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni ka arritur në konkluzion tërësisht të gabuar se ai gjendet në kushtet që duhet vlerësuar si i papërshtatshëm, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund t’i rikuperojë ato, duke u gjendur në kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
29. Në vijim të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqet për të cilat kundërshton mangësitë e konstatuara dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendim, lidhur me nëntë çështje penale, të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë analizuar nga trupi gjykues në vijim.

30. Lidhur me *procedimin penal nr. {***} të vitit 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*³⁵, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konkluduar, në vendim³⁶, se: “Komisioni vlerëson se vendimi i subjektit për rrëzimin e kërkesës për kryerjen e ekspertimit psikiatrik të të pandehurit vjen në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 178 të Kodit të Procedurës Penale, që përcakton se nuk lejohet ekspertimi për cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike. Në rastin konkret, raporti i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor ka vërtetuar se i pandehuri vuante nga sëmundje të shëndetit mendor dhe trajtohej me antidepresivë, trankuizilantë dhe psikoterapi intensive, duke provuar shkaqet patologjike të çrregullimeve psikike të pandehurit. Mosverifikimi i gjendjes psikike të të pandehurit, kur vërtetohen shkaqet patologjike, ndikon drejtpërdrejt në përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij sipas nenit 17 të Kodit Penal, që parashikon rastet e papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore. Në përfundim, Komisioni vëren mangësi profesionale të subjektit për sa i përket aspektit të njohurive ligjore, bazuar në aftësinë për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”.

30.1. Në kundërshtim të konkluzionit si më sipër, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar qëndrim të njëjtë si në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, duke argumentuar se konkluzioni i Komisionit bazohet në arsyetimin e vendimit të drejtuesit të Prokurorisë, i cili ka analizuar se nuk janë kryer të gjitha veprimet e domosdoshme hetimore që do të identifikonin saktësisht të vërtetën objektive. Subjekti i rivlerësimit, edhe pse nuk ka qenë dakord me këtë vendim, në zbatim korrekt të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ka kryer të gjitha detyrat e urdhëruara prej tij. Veprimet e urdhëruara nga drejtuesi i Prokurorisë nuk kanë sjellë rrethana të reja si në drejtim të faktit penal të ndodhur, ashtu edhe në drejtim të elementeve të tjera të veprës penale, ku përfshihet edhe përgjegjshmëria ose jo e të pandehurit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjatë hetimit të çështjes, ka administruar raportin e Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor, nga i cili është vërtetuar se i pandehuri vuante nga sëmundje të shëndetit mendor, duke provuar disa çrregullime psikike të tij. Trajtimi kryhej në kushte ambulatorie dhe duke vlerësuar sjelljen e të pandehurit, si dhe të dhëna të tjera të rezultuara gjatë hetimit, subjekti e ka vlerësuar të mjaftueshëm raportin e administruar, duke arritur në përfundimin se nuk krijohen dyshime për shkaqe papërgjegjshmërie sipas nenit 17 të Kodit Penal dhe nga ana tjetër, ky dokument mjekësor është konsideruar i mjaftueshëm për t’u përdorur si një nga rrethanat për individualizimin e dënimit për të pandehurin. Rezultatet e aktit të ekspertimit të kryer, bazuar në vendimin e drejtuesit të Prokurorisë, janë të ngjashme me të dhënat e pasqyruara në raportin e Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor dhe në fakt, vërtetuan bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit se ekspertimi nuk ishte i nevojshëm të kryhej. Vendimi mbi memorien e paraqitur nga i pandehuri, ka qenë një vendim i ndërmjetëm, i bazuar në bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit, si dhe në provat e administruara, duke arsyetuar të gjitha shkaqet pse nuk është vendosur kryerja e aktit të ekspertimit psikiatrik. Për këtë arsye, pretendon subjekti, Komisioni duhet të kishte mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës gjykimi apo

³⁵ Dosja nr. 3, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

³⁶ Paragrafët 22 dhe 23 të vendimit të Komisionit.

vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje, për sa kohë lidhet me vlerësimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit, del jashtë kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit.

30.2. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si vijon.

30.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, më datë 07.11.2013, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, mbi bazën e kallëzimit penal të depozituar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, për veprat penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 76-22 e 278/4 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit R. T..

30.2.2. Gjatë hetimeve janë kryer një sërë aktesh ekspertimi, si: ekspertimi balistik i gëzhgojave të sekuestruara; ekspertimi mjeko-ligjor për shtetasin L. M. (viktima), si pasojë e të cilit është hartuar aktekspertimi mjeko-ligjor nr. {***}; ekspertimi teknik-kimik i rrobave të sekuestruara; ekspertimi daktiloskopik vlerësues; ekspertim biologjik i bishtave të cigareve etj.

30.2.3. Avokati mbrojtës i të pandehurit, më datë 27.01.2014, ka paraqitur përpara Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kërkesën për kryerjen e ekspertimit neuro-psikiatrik për të dyshuarin R. T., me qëllim konstatimin e gjendjes së tij psikike para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Kësaj kërkesë i është bashkëlidhur raporti mjekësor i datës 25.01.2014, i mjekut Gj. P., pranë Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor të Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Shkodër, në të cilin pasqyrohet se pacienti R. T., me diagnozë çrregullim anksozo-depresiv dhe abuzim me substanca psiko-aktive, është vizituar në kushte ambulatorie, në shtëpi, për problemet e shëndetit mendor që nga muaji maj 2011, për shkak se nuk dëshironte të identifikohet.

30.2.4. Me vendimin e datës 29.01.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mospranimin e kërkesës së sipërcituar, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur se, *nga përmbajtja e raportit mjekësor, nuk rezulton që i dyshuari të ketë qenë i shtruar në spitalin psikiatrik në Shkodër dhe të ketë qenë hapur një kartelë për diagnozën dhe historikun e saj. Në këto kushte, gjendja e pacientit nuk ka qenë aq e rëndë, pasi në të kundërt ai do të ishte shtruar në pavijonin psikiatrik, ku dhe do t'i nënshtrohej një terapie intensive për diagnozën e pretenduar. I pandehuri ka pasur një komunikim normal me të dëmtuarin para se të kryente veprën penale, si dhe nuk ka shfaqur shenja agresiviteti me personat e pranishëm në lokal në natën e ngjarjes. Në seancën gjyqësore (të vleftësimit të masës së sigurimit), i dyshuari ka pretenduar se ngjarja nuk ka ndodhur ashtu siç pretendonte organi i akuzës, që do të thotë se i dyshuari ka qenë koshient dhe ka kuptuar veprimet e tij kriminale në momentin e kryerjes së veprës penale, por për shkak të kualifikimit ligjor për të cilën është regjistruar procedimi penal kundër tij, ai shpreson se duke dhënë një alibi tjetër, mund të merret parasysh nga ana e Prokurorisë. Për sa më sipër, nuk ka të dhëna për të dyshuar se i pandehuri R. T. vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë mendore, si pasojë e së cilës ai nuk ka qenë në gjendje për të kuptuar veprimet e tij kriminale në çastin e kryerjes së veprës penale dhe, si rrjedhojë, të mos përgjigjet penalisht për veprat penale që ka kryer.*

30.2.5. Me kërkesën e datës 04.02.2014, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të të pandehurit R. T., i akuzuar për veprat penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 278/4, 76 dhe 22 të Kodit Penal. Në marrjen e njoftimit për këtë kërkesë, i pandehuri ka vendosur shënimin “Nuk jam dakord për dërgimin e çështjes për gjykim, pa u kryer veprimet hetimore të kërkuara nga unë”.

30.2.6. Drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin “Për shfuqizimin e akteve”, datë 24.02.2014, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të dërgimit në gjykatë dhe kërkesës për gjykim të procedimit penal nr. {***} për të pandehurin R. T., duke arsyetuar se vendimi i dërgimit për gjykim i çështjes është marrë pa u kryer të gjitha veprimet e domosdoshme hetimore, të cilat do ta sqaronin në mënyrë të shteruar ngjarjen dhe do të identifikonin saktësisht të vërtetën objektive. Drejtuesi i Prokurorisë ka argumentuar, ndër të tjera, se: “[...] në të njëjtën kohë i pandehuri ka pretenduar se vuan nga sëmundje mendore të përcaktuara nga vizitat e mjekut Gj. P. dhe, për këtë, ka kërkuar ekzaminim psikiatriko-ligjor. Prokurori i çështjes ka rrëzuar kërkesën për ekspertim, me argumentin se gjatë seancës së masës së sigurimit, i pandehuri ishte kohshient. Çmojmë se organi procedues nuk mund të anashkalojë një kërkesë të tillë, aq më tepër kur shoqërohet me dokument që provon kurimin e të pandehurit, kjo sepse një ndër kriteret e përgjegjësisë penale është edhe “përgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore”, neni 17 i Kodit Penal. Mosverifikimi i këtij kriteri, aq më tepër për vepra penale të rënda dhe kur pretendohet nga i pandehuri, mund të passjellë në gjykim pasoja që mund të cenojnë rëndë në tërësi përgjegjësinë penale”. Në përfundim, drejtuesi i Prokurorisë ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore, ndër të cilat edhe kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor për të pandehurin, me grup ekspertësh.

30.2.7. Në zbatim të detyrës së lënë nga drejtuesi i Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit, më datë 04.03.2014, ka vendosur kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor për të pandehurin R. T.. Në aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. {***}, datë 16.04.2014, dy ekspertët psikiatër ligjorë kanë arritur në konkluzionin se i pandehuri R. T. vuan nga një çrregullim mendor i personalitetit kufitar, i cili i ka filluar në adolehencën e vonë, por ky çrregullim nuk ka ndikuar në aftësinë e tij për të qenë i përgjegjshëm para ligjit.

30.2.8. Në përfundim të veprimeve hetimore, me kërkesën e datës 05.05.2014, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të të pandehurit R. T., i akuzuar për veprat penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 278/4, 76 dhe 22 të Kodit Penal.

30.2.9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 23.09.2014, ka vendosur deklaram fajtor të të pandehurit R. T. për veprën penale “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim; deklaramin fajtor për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” duke e dënuar me 7 vjet burgim dhe, në zbatim të nenit 55/2 të Kodit Penal, e ka dënuar me 17 vjet burgim; në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit me 11 vite e 4 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi

nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 18.05.2015. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 08.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi pjesërisht të vendimit nr. {***}, datë 18.05.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, për sa i përket fajësisë dhe masës së dënimit të të pandehurit për veprën penale “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë dhe ndryshimin e vendimit duke e deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal dënimin e tij me 12 vite burgim dhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të gjykuarit me 8 vite burgim.

30.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në këtë shkak ankimi, në raport me situatën faktike si më sipër dhe konkluzionet e Komisionit, lidhur me elemente të përmbajtjes së vendimit të datës 29.01.2014, me të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur mospranimin e kërkesës së paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit për kryerjen e aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se *nuk ka të dhëna për të dyshuar se i pandehuri R. T. vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë mendore, si pasojë e së cilës ai nuk ka qenë në gjendje për të kuptuar veprimet e tij kriminale në çastin e kryerjes së veprës penale dhe, si rrjedhojë, të mos përgjigjet penalisht për veprat penale që ka kryer*, në një kohë kur i pandehuri, për të provuar se ka pretenduar se vuan nga sëmundje të shëndetit mendor, ka paraqitur raportin e mjekut neuropsikiatër pranë Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor të Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Shkodër, në të cilin pasqyrohet se pacienti vuante nga problemet e shëndetit mendor që nga muaji maj 2011. Në këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit ka anashkaluar tërësisht të dhënat e raportit mjekësor, lidhur me diagnozën e të pandehurit, duke i dhënë peshë vendimtare bindjes së tij të brendshme, se gjendja e pacientit nuk ka qenë aq e rëndë, pasi në të kundërt ai do të ishte shtruar në pavijonin psikiatrik, ku dhe do t’i nënshtrohej një terapie intensive për diagnozën e pretenduar, si dhe mosshfaqjes prej të pandehurit të shenjave të agresivitetit gjatë momenteve të caktuara të zhvillimit të procedimit penal. Për më tepër, ashtu siç ka parashtruar edhe vetë në ankim, të dhënat e raportit mjekësor të paraqitur nga i pandehuri, subjekti i rivlerësimit i ka konsideruar në të kundërt, si të dhëna të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se nuk krijohen dyshime për shkaqe papërgjegjshmërie. Trupi gjykues çmon se ky vlerësim nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk mund të arrihej pa një ekzaminim psikik të mjekëve psikiatër³⁷. Edhe në elementet e tjera të renditura në argumentimin e vendimit të datës 29.01.2014, të cilët marrin në analizë sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, si dhe atyre që referojnë momentet e sjelljes së të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit merr përsipër ta vlerësojë në mungesë të një raporti psikiatriko-ligjor papërgjegjshmërinë në momentin e kryerjes së veprës penale të personit të dyshuar.

³⁷ Neni 17 i Kodit Penal, në fuqi në vitin 2014, parashikonte se:

“Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe, për pasojë, nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale.

Personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.”

Papërgjegjshmëria për shkak të një turbullimi psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin mendor të të pandehurit, rrethanë e cila e bën personin tërësisht të papërgjegjshëm penalisht, ndryshon nga papërgjegjshmëria për shkak të turbullimit psikik ose neuropsikik që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, rrethanë që nuk e bën të papërgjegjshëm të dyshuarin, por që mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.

Madje, duke verifikuar qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në optikën e parimit të rëndësishëm penal *in dubio pro reo*, trupi gjykues vëren se subjekti, në vendimin objekt kontrolli, ka arsyetuar deri në kufijtë e paragjykimit të kërkesës së paraqitur nga i pandehuri, duke vlerësuar se i pandehuri *ka kuptuar veprimet e tij kriminale në momentin e kryerjes së veprës penale, por për shkak të kualifikimit ligjor për të cilin është regjistruar procedimi penal kundër tij, ai shpreson se duke dhënë një alibi tjetër, mund të merret parasysh nga ana e Prokurorisë.*

30.4. Trupi gjykues vlerëson se në respektim të parimit të objektivitetit, me qëllim hetimin e gjithanshëm dhe objektiv të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit duhej të pranonte kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit për kryerjen e aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor, në mbështetje të nenit 43, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale³⁸, sidomos në kushtet kur kërkesa ishte e mbështetur në një raport mjekësor, i cili referonte në një diagnozë të përcaktuar, e që vlerësimi mbi vërtetësinë e saj e, për pasojë, edhe vlerësimi mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit, kërkonte ekspertizën psikiatrike, duke mos u lënë shteg vlerësimeve subjektive nga ana e organit të akuzës³⁹ mbi gjendjen e të pandehurit. Në këto kushte, verifikimi i kriterit të papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore, sipas nenit 17 të Kodit Penal, për të pandehurin për vepra penale të rënda dhe kur është pretenduar prej tij, merr rëndësi të veçantë, pasi mund të passjellë në gjykim pasoja që mund të cenojnë rëndë në tërësi përgjegjësinë penale, ashtu si edhe me të drejtë ka vlerësuar drejtuesi i Prokurorisë në vendimin “Për shfuqizimin e akteve”, datë 24.02.2014, me të cilin ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit për dërgimin në gjykatë dhe kërkesës për gjykim të procedimit penal nr. {***} për të pandehurin R. T., duke i lënë detyrë, ndër të tjera, edhe kryerjen e aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor për të pandehurin.

³⁸ Neni 43 i Kodit të Procedurës Penale, me titull “Verifikimet për përgjegjshmërinë e të pandehurit”, në pikën 3 parashikon: “3. Kur nevoja e përcaktimit të përgjegjshmërisë del gjatë hetimeve paraprake, ekspertimi urdhërohet nga prokurori kryesisht ose me kërkesën e të pandehurit apo të mbrojtësit të tij. Ndërkohë prokurori kryen vetëm veprimet që nuk kërkojnë pjesëmarrjen e vetëdijshme të të pandehurit. Kur vonesa paraqet rrezik, mund të merren prova vetëm në rastet e parashikuara për sigurimin e provës.”

³⁹ Ashtu siç ka arsyetuar dhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj: “Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor, në kuptimin kushtetues. [...] Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij”. (Shih vendimet nr. 23, datë 13.10.2005; nr. 24, datë 26.10.2005; nr. 16, datë 08.06.2006; nr. 13, datë 21.07.2008; nr. 19, datë 18.09.2008; nr. 10, datë 02.04.2009; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 57, datë 21.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

30.5. Rezultati i aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. {***}, datë 16.04.2014, sipas të cilit i pandehuri R. T. vuan nga një çrregullim mendor i personalitetit kufitar, i cili i ka filluar në adoleshencën e vonë, por ky çrregullim nuk ka ndikuar në aftësinë e tij për të qenë i përgjegjshëm para ligjit, ka kundërshtuar qëndrimin e subjektit në vendimin e mospranimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit R. T., se në kushtet kur i pandehuri nuk kishte shfaqur sjellje agresive e, në prani edhe të mbrojtësit, nuk kishte dhënë asnjë deklaram, në cilësinë e të arrestuarit, mbi gjendjen e tij mendore, kërkesa e paraqitur ishte një alibi tjetër. Trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, se veprimet e urdhëruara nga drejtuesi i Prokurorisë nuk kanë sjellë rrethana të reja në drejtim të përgjegjshmërisë ose jo të të pandehurit, bien në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vendimin nr. {***}, datë 23.09.2014, e cila i ka dhënë rëndësi aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor në individualizimin e dënimit për të pandehurin R. T., duke arsyetuar: “[...] Po ashtu, në caktimin e dënimit, gjykata mban në konsideratë dhe faktin se vepra penale ka mbetur në tentativë, si dhe gjendjen psikike të të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale (ai vuan nga çrregullimi i personalitetit kufitar, i cili e ka ulur ekuilibrin e tij mendor). Mbështetur në këto të dhëna, gjykata vlerëson se masa e dënimit të kërkuar nga prokuroria është e rëndë, pasi nuk respekton parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 1/c (i cili parashikon parimin e humanizmit të legjislacionit tonë penal dhe të drejtësisë në caktimin e dënimit penal) dhe nenin 47 të Kodit Penal, parime të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo vepër penale”.

30.6. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues e gjen të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në rastin konkret, duhet të kishte mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje, për sa kohë lidhet me vlerësimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit, del jashtë kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, gjendet i pabazuar, pasi ashtu siç e ka pranuar edhe vetë subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka marrë në analizë një vendim të ndërmjetëm të tij në kuadër të veprimeve hetimore për procedimin penal nr. {***} dhe nuk ka gjykuar mbi zgjidhjen e çështjes prej tij, për pasojë Komisioni nuk gjendej në kushtet e parashikuara nga neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

30.7. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, se veprimet hetimore të kryera prej tij në bazë të detyrave të tjera të lëna nga vendimi i drejtuesit të Prokurorisë, nuk i kanë sjellë asgjë të re hetimit të çështjes, trupi gjykues vëren se ky pretendim është përsëritje e shpjegimeve të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit administrativ dhe, për rrjedhojë, u referohen gjetjeve fillestare të Komisionit, gjetje këto për të cilat Komisioni nuk ka arritur në ndonjë konkluzion në vendim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me çështjen objekt kontrolli.

30.8. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlerësimi i aftësive të tij profesionale në këtë çështje penale, është vlerësuar edhe nga KLP-ja dhe 11 anëtarë të këtij Këshilli nuk kanë gjetur asnjë mangësi në hetimin apo përfaqësimin në gjykim saj. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues vlerësoi se është i pabazuar në ligj, pasi sipas neneve 45 e 50 të ligjit nr. 84/2016,

institucionet e rivlerësimit kanë detyrimin të kryejnë hetim të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes, në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, raportet që hartohen nga institucionet e drejtësisë, si organe ndihmëse në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk kushtëzojnë vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit brenda fushës së tyre të veprimit. Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, përfshirë edhe KLP-në, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Në lidhje me pretendimin si më sipër të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet se procesi i rivlerësimit është parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës, si një proces i jashtëzakonshëm dhe kalimtar kontrolli për subjektet e rivlerësimit. Parashikimet kushtetuese e ligjore nuk kushtëzojnë ushtrimin e kontrollit prej organeve të rivlerësimit, nga raportet apo rezultatet e kontrollit të ushtruar më parë prej strukturave përkatëse brenda organeve të sistemit të drejtësisë. Për rrjedhojë, raporti i KLP-së për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nuk pengon, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, të drejtën e organeve të rivlerësimit për të kryer kontrollin dhe vlerësimin e tyre në mënyrë të pavarur e objektive për verifikimin e nivelit të aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 44 të po këtij ligji.

31. Në përfundim të kontrollit të procedimit penal nr. {***}, trupi gjykues vlerësoi se gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit duhej të kishte kryer veprimtari hetimore për të verifikuar papërgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore të të pandehurit, në kushtet e ekzistencës së një raporti mjekësor që referonte të dhëna për gjendjen psikike të tij, dhe jo të refuzonte kërkesën e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit për këtë qëllim, duke shfaqur mangësi për sa i përket aspektit të njohurive ligjore, bazuar në aftësinë për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriteret të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
32. Lidhur me *procedimin penal nr. {***} të vitit 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁴⁰, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konkluduar në vendim, se: “42. Subjekti ka shfaqur mangësi profesionale, për sa i përket aspektit të njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kriteret të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Komisioni e ka mbështetur konkluzionin e sipërcituar në arsyetimin se: “Në vendimin e datës 24.05.2016, për mosfillimin e procedimit penal, subjekti i rivlerësimit i referohet institutit të “Parashkrimit të ndjekjes penale” (neni 66 i Kodit Penal) dhe arsyeton se të gjitha shkeljet ligjore të zyrtarëve gjatë ushtrimit të detyrës apo të shtetasve që përbëjnë vepra penale, u nënshtrohen

⁴⁰ Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së, referuar në rubrikën përkatëse të raportit të KLP-së për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, nr. {***} prot., datë 23.07.2021.

këtyre rregullave, por në vendim nuk shprehet dhe në dosjen penale nuk pasqyrohen veprimet hetimore që provojnë faktin nëse i akuzuari e ka përdorur ose jo dokumentin, dhe nëse e ka përdorur kur është momenti i fundit i përdorimit dhe më pas të vijonte me arsyetimin nëse janë plotësuar ose jo afatet e parashkrimit të ndjekjes penale. Vetëm pas hetimit të këtyre rrethanave mund të konkludohet se veprimet hetimore lidhur me këtë vepër penale, janë plotësisht të ezauruara. Lidhur me arsyetimin e subjektit se ka një proces gjyqësor lidhur me këtë sipërfaqe trualli, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër që do të analizojë dhe vendosë nëse duhej apo jo privatizuar sipërfaqja e tokës për të cilën është lëshuar leja e ndërtimit dhe a duhej apo jo Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të vendoste lidhur me kthimin e sipërfaqes së truallit mbi të cilin është dhënë leja e ndërtimit, konfirmon se subjekti nuk arrin të bëjë dallimin e përgjegjësisë civile nga ajo penale.

32.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit si të pabazuar, duke pretenduar se ai ka vepruar mbi bazën e akteve që ndodheshin në kallëzimin penal dhe, nga tërësia e këtyre akteve, nuk kishte të dhëna se dokumentacioni ishte i falsifikuar. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu, se është bazuar në bindjen e tij të brendshme, duke arsyetuar me detaje vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka referuar në ankim se ende nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që të provojë pretendimet e kallëzueses se dokumentacioni është i falsifikuar, pavarësisht se kanë kaluar disa vite nga data e regjistrimit të procedimit penal, pasi çështja është kthyer disa herë nga gjykata, edhe pas kërkesave të paraqitura nga prokurorë të tjerë të caktuar në këtë çështje penale, pas zëvendësimit të subjektit të rivlerësimit nga drejtuesi i Prokurorisë për shkak të kallëzimit të paraqitur ndaj tij.

32.2. Në analizë të këtij shkak ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi si vijon.

32.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***}, datë 17.05.2016, mbi bazën e kallëzimit të shtetases Z. M. (Ç.), ndaj shtetasit I. M., procedim i ndjekur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit.

32.2.2. Referuar kallëzimit, kallëzuesja pretendonte se shtetasi I. M. kishte zënë një pjesë të pronës së saj në kundërshtim me ligjin, në të cilën ai kishte ndërtuar një ndërtesë trekatëshe. Sipas kallëzueses, z. M. ka pasur të regjistruar në regjistrat publikë vetëm ndërtesën, pasi trualli ka qenë pronë e trashëgimtarëve, ndër të cilët edhe kallëzuesja. Kallëzuesja referon se shtetasi I. M. ka paraqitur si provë për të vërtetuar se ai ka blerë truallin, një mandat arkëtimi me të cilin pretendon se ka blerë truallin nga Bashkia Shkodër, nga përmbajtja e të cilit nuk vërtetohet fakti i blerjes. Nga ana tjetër, ky shtetas nuk ka paraqitur asnjë kontratë shitblerjeje të lidhur mes tij dhe Bashkisë Shkodër. Njëkohësisht, shtetasi I. M. ka paraqitur një fletë leje të datës 17.09.1991, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Shkodër, sipas së cilës i jepet leja për kryerjen e ndërtimit të një objekti një kat. Sipas kallëzueses, leja e ndërtimit nuk është lëshuar nga organet kompetente të kohës, pasi leja është nënshkruar nga kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Shkodër, i cili në datën e nënshkrimit të saj, ka qenë i dalë në pension. Për sa më sipër, kallëzuesja ka kallëzuar shtetasin I.

M. për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme të falsifikimit dhe mashtrimit me dokumente. Kallëzuesja, bashkë me kallëzimin, ka paraqitur edhe aktet e pretenduara si të falsifikuara.

32.2.3. Me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 24.05.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 17.05.2016, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: “[...] Nga ana e kallëzueses kërkohet që prokuroria të hetojë ligjshmërinë e këtyre veprimeve, që do të thotë se duhet të verifikohen nëse veprimet e zyrtarëve të Komitetit Ekzekutiv të qytetit, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kanë qenë ose jo të ligjshme. [...] Nga sa parashtrova më sipër, para se të analizojmë pretendimet e kallëzueses, është e rëndësishme të analizojmë institutin e parashkrimit të ndjekjes penale, konkretisht nenin 66 të Kodit Penal. [...] Nga përmbajtja e kësaj leje ndërtimi, përcaktohet qartë se perioda e fillimit të punimeve do të jetë data 20.07.1991 dhe data e përfundimit 30.12.1991. Në këto kushte, është logjike që një organ shtetëror nuk mund të lëshojë një leje të tillë pa e verifikuar paraprakisht dhe konfirmuar se vendi ku do të bëhej ky ndërtim është blerë nga ana e shtetasit që kishte bërë kërkesë për ndërtimin e një objekti. Kjo logjikë e analizimit me kujdes të kësaj lejeje, përforcohet më tepër, nisur edhe nga fakti i përcaktimit të datës së fillimit të punimeve dhe mbarimit të tyre. Meqenëse ka një proces gjyqësor lidhur me këtë sipërfaqe trualli, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër që do të vendosë nëse duhej privatizuar apo jo sipërfaqja e tokës për të cilën është lëshuar leja e ndërtimit dhe a duhej që KKKP-ja të kthente një sipërfaqe trualli mbi të cilin ishte bërë një objekt shtëpi, mbi bazën e një leje ndërtimi. Vetëm gjykata mund të vendosë lidhur me efektet juridike që kanë prodhuar këto akte nga lëshimi i tyre dhe a duhet të kenë apo jo fuqi juridike në të ardhmen.” Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 17.05.2016, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

32.2.4. Më datë 09.06.2016, shtetasja Z. M. (Ç.) ka kallëzuar penalisht prokurorin Ermir Lelçi për kryerje të veprës penale “Shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka vendosur të mosfillojë procedimin penal nr. {***}, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasës Z. M. (Ç.), ka regjistruar procedimin penal nr. {***} dhe më datë 22.07.2016 është vendosur mosfillimi i procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasës Z. M. (Ç.) ndaj prokurorit Ermir Lelçi, bazuar në nenet 290/1/ç e 291 të Kodit të Procedurës Penale.

32.2.5. Në përgjigje të barrës së provës⁴¹, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka mbrojtur qëndrimin në vendimin e marrë prej tij, duke pretenduar se gjykata ka gabuar tërësisht, pasi nuk mund të urdhëronte të kryhen hetime për një mosmarrëveshje juridike-civile që po shqyrtohet në gjykatë. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe sikur sipërfaqja e

⁴¹ Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime mbi gjetjen: “Sa më sipër, duket se: Subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore me qëllim analizimin dhe vlerësimin e pretendimeve të kallëzueses, lidhur me veprën penale të “Falsifikimit i dokumenteve” në formën e përdorimit”.

truallit të jetë shitur në kundërshtim me ligjin, përsëri nuk mund të pretendohet se duhet të kryhen hetime, pasi është parashkruar ndjekja penale dhe nga viti 1991 kanë kaluar shumë vite. Edhe për punonjësit që e kanë regjistruar fillimisht këtë pronë dhe kanë lëshuar vërtetimin hipotekor nuk mund të ketë ndjekje penale, pasi kanë kaluar shumë vite.

32.2.6. Komisioni ka referuar në vendim, se: 38. [...] nga verifikimi i faqes elektronike gjykata.gov.al, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 06.09.2016, ka vendosur: “Pranimin e ankimit. Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Për mosfillimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2016”, të datës 24.5.2016, si të pabazuar në ligj dhe prova. Detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e hetimeve”. Kjo çështje është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër.

32.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në ankim, se ai ka vepruar mbi bazën e akteve që ndodheshin në kallëzimin penal dhe, nga tërësia e këtyre akteve, nuk kishte të dhëna se dokumentacioni ishte i falsifikuar dhe se ai është bazuar në bindjen e tij të brendshme, duke arsyetuar me detaje vendimin e mosfillimit të procedimit penal, trupi gjykues analizoi si vijon.

32.3.1. Në arsyetimin e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, të datës 24.05.2016, subjekti i rivlerësimit ka analizuar vetëm lejen e ndërtimit të pretenduar se ishte marrë nga z. I. M., duke argumentuar se blerja e truallit prej shtetasit I. M. nga Bashkia Shkodër duhet të kishte ndodhur, pasi është logjike që një organ shtetëror nuk mund të lëshojë një leje të tillë pa e verifikuar paraprakisht dhe konfirmuar se vendi ku do të bëhej ky ndërtim është blerë nga ana e shtetasit që kishte bërë kërkesë për ndërtimin e një objekti dhe se kjo logjikë e analizimit me kujdes të kësaj lejeje, përforcohet më tepër, nisur edhe nga fakti i përcaktimit të datës së fillimit të punimeve dhe mbarimit të tyre. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka krijuar bindjen e tij të brendshme, duke u bazuar në prezumime dhe jo në fakte të bazuara në prova. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë analizë lidhur me mandatin e arkëtimit të datës 27.09.1991, të pretenduar nga z. I. M., si akti që vërteton blerjen e truallit prej tij nga Bashkia Shkodër, për të cilin kishte marrë lejen e ndërtimit, dokument i cili ishte theksuar nga kallëzuesja në mënyrë të veçantë në ankim, si i falsifikuar. Në vlerësim të trupit gjykues, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, nuk shkon në një linjë me qëndrimin e tij në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, se procedimi nuk duhej filluar, bazuar në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

32.3.2. Sa i përket arsyetimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit i referohet institutit të “Parashkrimit të ndjekjes penale” (parashikuar nga neni 66 i Kodit Penal) dhe arsyeton se të gjitha shkeljet ligjore të zyrtarëve gjatë ushtrimit të detyrës apo të shtetasve, që përbëjnë vepra penale, u nënshtrohen këtyre rregullave, por nuk ka konkluduar më tej, lidhur me bazën ligjore të analizuar, se si ndërlikohet ajo me rrethanat në çështjen konkrete. Për më tepër, ky arsyetim vjen në kundërshtim me konkluzionin e arritur nga subjekti i rivlerësimit në vendimin për mosfillimin e procedimit penal se fakti nuk parashikohej si vepër penale, pasi në vlerësim të trupit gjykues, nëse nuk provohet me prova ekzistenca e faktit penal, nuk mund të vihet në diskutim instituti i parashkrimit të ndjekjes penale.

32.3.3. Në arsyetimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk referon në veprime verifikuese të kryera për të verifikuar kallëzimin, në drejtim të vërtetësisë dhe autenticitetit të dokumentacionit të pretenduar nga kallëzuesja si i falsifikuar, nëse dokumenti ishte falsifikuar nga i kallëzuari apo nga ndonjë person tjetër, apo nëse shtetasi i kallëzuar ka qenë në dijeni të faktit që dokumenti ka qenë i falsifikuar dhe, nëse me dashje, është përdorur ky dokument në favor të pretendimeve të tij, dhe nëse e ka përdorur kur ishte momenti i fundit i përdorimit, sidomos në kushtet kur vetë subjekti i rivlerësimit referon në vendim për ekzistencën e një procesi gjyqësor në zhvillim, lidhur me sipërfaqen e truallit të pretenduar nga kallëzuesja në pronësi të saj. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të organit që realizon ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjykim, ka qenë i detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova lidhur me elementet e referuara nga kallëzuesja.

33. Në konkluzion të sa më sipër, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit. Në këto kushte, gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit se kjo situatë faktike afekton indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

34. Lidhur me *procedimin penal nr. {***} të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁴², trupi gjykues vëren se Komisioni ka arsyetuar, në vendim: “Komisioni vlerëson se kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. {***}, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, është në kundërshtim me nenin 71 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”, i ndryshuar. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi profesionale në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë për të interpretuar ligjin, kriter që parashikohet nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”.

34.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit si të pabazuar, duke pretenduar se, *së pari*, nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është evidentuar ndonjë e metë e organit të Prokurorisë lidhur me kualifikimin ligjor të bërë gjatë hetimit paraprak, si dhe nuk është konstatuar kryerja e ndonjë veprë tjetër penale, pasi nëse do të ishte konstatuar edhe vepra penale e parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, prokuroria sipas nenit 374 apo nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale, mund të kishte tërhequr dosjen për të vazhduar hetimet paraprake; *së dyti*, subjekti i rivlerësimit ka vepruar mbi bazën e bindjes së tij të brendshme, duke konkluduar vetëm kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Procedimi penal ka pasur vështirësi në aspektin provues, pasi nga hetimi nuk janë siguruar të dhëna për të përcaktuar saktë nëse ishin

⁴² Evidentuar si çështje nga Komisioni, në kuadër të hetimit lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit dhe referuar në vendim në paragrafin e titulluar “Konstatime të tjera”.

kryer punime të tjera në objektin tjetër, cilët persona po i kryenin këto punime dhe nga kush ishin autorizuar për t'i kryer. Vetë policia, kur ka kryer veprimet përkatëse, nuk ka arritur të dokumentojë provat lidhur me faktin penal të referuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” dhe mosadministrimi në kohë i këtyre të dhënave ka bërë të pamundur të provohet vepra penale e sipërcituar. Ndodhur edhe në kushtet e miratimit të ligjit të amnistisë, subjekti i rivlerësimit ka çmuar të dërgojë të pandehurit për gjykim për një vepër të rëndë penale. Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit të vlerësojë se konstatimi i Komisionit është i gabuar dhe vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje është diktuar nga niveli i provave të administruara gjatë hetimit, si dhe nga bindja e tij e brendshme.

34.2. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, konkretisht dosjes së procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, trupi gjykues konstatoi si vijon.

34.2.1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 20.10.2014, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në ngarkim të subjektit “{***}” ShPK. Në datën 13.01.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, pasi në objektin që po ndërtonte shoqëria “{***}” ShPK ka ndodhur një aksident në punë, ku ka humbur jetën shtetasi D. K.. Në të njëjtin objekt, në datën 05.06.2015, ka ndodhur një aksident tjetër në punë me pasojë vdekjen, nga i cili ka humbur jetën shtetasi M. K. dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprat penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, “Punësim i paligjshëm” dhe “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga nenet 289/1, 170/a, 199/a të Kodit Penal. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur bashkimin e procedimeve penale të sipërcituara në një procedim të vetëm me nr. {***} të vitit 2014, duke ngarkuar subjektin e rivlerësimit Ermir Lelçi, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

34.2.2. Inspektorati i Ndërtimit Urbanistik Vendor Velipojë, me vendimin nr. {***}, datë 01.02.2013, ka vendosur pezullimin e punimeve të subjektit ndërtimor “{***}” ShPK.

34.2.3. Komisariati i Policisë Shkodër, me shkresat nr. {***} prot., datë 17.11.2014 dhe nr. {***} prot., datë 16.01.2015, i ka dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Informacionin për referimin e veprës penale”, për kryerje ndërtimi pa leje në vendin e quajtur Plazhi Velipojë, me tabelë punimesh “{***}” ShPK.

34.2.4. Me kërkesën e datës 30.12.2015, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor gjykimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2014, kundër të pandehurve N. Ç. dhe F. A., të akuzuar për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Në kërkesën për gjykim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: (i) lidhur me procedimin penal nr. {***}, të regjistruar në datën 20.10.2014, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, ndaj subjektit “{***}” ShPK, bazuar në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, i ndryshuar, kjo çështje penale duhet pushuar, pasi vepra

penale “Ndërtimi i paligjshëm” është amnistuar; (ii) lidhur me procedimin penal nr. {***}, shkaku i ndodhjes së aksidentit, me pasojë vdekjen e shtetasit D. K., nuk ka ndodhur gjatë kohës kur po punohej në këtë objekt, por në periudhën kur ishin pezulluar punimet dhe ai kishte vajtur në objekt për të marrë disa vegla pune të cilat i kishte lënë rreth 1 muaj më parë; (iii) lidhur me procedimin penal nr. {***}, të pandehurit N. Ç. dhe F. A. kanë konsumuar veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, pasi është provuar se shtetasi M. K. ka qenë duke punuar në datën 05.06.2015 te kompleksi me investitor “{***}” ShPK, ku ka pësuar aksidentin me pasojë vdekjen.

34.2.5. Më datë 03.11.2014, shoqëria “{***}” ShPK në cilësinë e investitorit dhe shoqëria “{***}” ShPK në cilësinë e ndërtuesit kanë lidhur kontratë sipërmarrjeje ndërtimi me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2014, me objekt realizimin e rifiniturës për objektin Kompleksi Turistik “{***}”, Shkodër.

34.2.6. Komuna Velipojë, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.12.2014, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e ka informuar këtë të fundit se shoqëria “{***}” ShPK është paraqitur disa herë pranë komunës për të aplikuar për leje ndërtimi, por nuk dihej nëse kompetenca i përkiste komunës Velipojë apo Ministrisë së Turizmit, pasi leja zhvillimore i përkiste Ministrisë së Turizmit. Më tej, komuna ka informuar se me shkresën nr. {***} prot., datë 21.11.2014, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për qartësimin e kompetencës për dhënien e lejes së ndërtimit.

34.2.7. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.07.2015, ka informuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër se, mbi bazën e kërkesës nr. {***} prot., datë 09.06.2015, të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe kërkesës, datë 30.04.2015, të shoqërisë “{***}” ShPK, Këshilli Kombëtar i Territorit (në vijim “KKT”), në mbledhjen e datës 05.05.2015, kishte marrë vendimin nr. {***}, datë 05.05.2015, “Për rishikimin e studimit urbanistik të zhvillimit turistik të zonës bregdetare {***}”, miratuar me vendim të KKT-së nr. {***}, datë 01.06.2012 dhe miratimin e lejes së ndërtimit për 6 rezidencat dhe objektet e shërbimit në zonën bregdetare {***}, ish-komuna Velipojë, qarku Shkodër. Ky vendim, sipas KKT-së ishte ende në proces zbardhjeje.

34.2.8. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime lidhur me konstatimin: “Subjekti ka pushuar veprën penale të ndërtimit të paligjshëm për shoqërinë “{***}” ShPK (me administrator B. Ç., bashkëshortja e A. Ç.), në kundërshtim me nenin 71 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”, të ndryshuar”.

34.2.9. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime mbi barrën e provës së kaluar nga Komisioni, si më sipër.

34.3. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në ankim, se nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është evidentuar ndonjë e metë e organit të Prokurorisë lidhur me kualifikimin ligjor të bërë gjatë hetimit paraprak, si dhe nuk është konstatuar kryerja e ndonjë

vepre tjetër penale, pasi nëse do të ishte konstatuar edhe vepra penale e parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, prokuroria sipas nenit 374 apo 377 të Kodit të Procedurës Penale mund të kishte tërhequr dosjen për të vazhduar hetimet paraprake, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i referohet në këtë pretendim vendimit të marrë nga gjykata lidhur me të pandehurit N. Ç. dhe F. A., të dërguar prej tij për gjykim me kërkesën e datës 30.12.2015, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, të cilët ishin përfaqësues të shoqërisë “{***}” ShPK dhe jo përfaqësues të shoqërisë “{***}” ShPK. Në rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në vendimin e Komisionit, nuk gjendet ndonjë konkluzion për këtë çështje, për pasojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet nga trupi gjykues jorelevant për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit.

34.4. Lidhur me pretendimin e dytë të subjektit të rivlerësimit, se procedimi penal ka pasur vështirësi në aspektin provues, pasi nga hetimi nuk janë siguruar të dhëna për të përcaktuar saktë nëse ishin kryer punime të tjera në objektin tjetër, cilët persona po i kryenin këto punime dhe nga kush ishin autorizuar për t’i kryer dhe se ndodhur edhe në kushtet e miratimit të ligjit të amnistisë, subjekti i rivlerësimit ka çmuar të dërgojë të pandehurit për gjykim për një vepër të rëndë penale, vërehet se edhe në këtë rast, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhen me të pandehurit N. Ç. dhe F. A., përfaqësues të shoqërisë “{***}” ShPK, të dërguar prej tij për gjykim me kërkesën e datës 30.12.2015, për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Në kërkesën për gjykim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: *Gjithashtu, ky shtetas (N. Ç. përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK) nuk mund të akuzohet as për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, pasi pavarësisht se nuk ka pasur në dispozicion lejen e ndërtimit në kohën që ka kryer punimet, rezulton se punimet e kryera nga ana e subjektit “{***}” ShPK, kanë konsistuar në punime suvatimi të brendshme, suvatime të jashtme, punime hidraulike dhe elektrike dhe në kuptimin penal, nuk përbëjnë ndërtim të paligjshëm.* Trupi gjykues vëren se ky arsyetim i subjektit të rivlerësimit nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.11.2014, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e investitorit dhe shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e ndërtuesit, sipas së cilës ishte detyrim i investitorit t’i vinte në dispozicion ndërtuesit para fillimit të punimeve dokumentacionin ligjor e teknik, si: lejen e ndërtimit, lejet për prishjet në sheshin e ndërtimit, projektin e plotë etj.

34.5. Nga verifikimi i akteve të dosjes së procedimit penal, trupi gjykues konstatoi se procedimi fillimisht është trajtuar nga prokurori L. Ç., i cili me vendimin e datës 23.04.2015, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të subjektit “{***}” ShPK për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2014 “Për amnistinë”. Me vendimin e datës 03.07.2015, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të sipërcituar, duke arsyetuar se pushimi i veprës penale është bërë pa u kryer të gjitha veprimet hetimore, pasi nga shqyrtimi i procesverbaleve të këqyrjes së objekteve pjesë përbërëse e kompleksit dhe e tabelave fotografike që i shoqërojnë, rezulton se nuk del e qartë se prej sa objektivsh përbëhet kompleksi, sa prej tyre janë ndërtuar dhe sa jo, si dhe në cilën fazë është ndërtimi i secilit prej tyre. Trupi gjykues vëren se i vetmi veprim hetimor i

ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të caktuar për të vazhduar hetimet, ishte urdhri i datës 01.09.2015, me të cilin ka ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore për këqyrjen e kompleksit “{***}”, me investitor shoqërinë “{***}” ShPK, veprim hetimor i kryer edhe nga prokurori pararendës. Subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, ka arsyetuar se, *referuar kohës së ndërtimit të objektit, rezulton se është realizuar brenda vitit 2013, gjë që provohet me certifikatën e pronësisë për sipërfaqen 44.000 m² në emër të subjektit “{***}” ShPK, si dhe procesverbalet e këqyrjes së vendit, shoqëruar me tabela fotografike*, ndërsa nga përmbajtja e procesverbalit të këqyrjes, datë 08.10.2015, si dhe pamjet fotografike të objektit, trupi gjykues vëren se rezulton e kundërta – disa nga ndërtesat që përbënin kompleksin ishin ende në fazën e ndërtimit.

Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar gjithashtu, në vendim, se nga e subjektit “{***}” ShPK janë kryer të gjitha veprimet procedurale në përputhje me ligjin nr. 10119/2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, dhe se në referim të nenit 70/10, 70/17, 70/18 e vijues, kur kryetari i komunës/bashkisë, pas përmbushjes së afatit 45 ditë, nuk shprehet për kërkesën, kërkesa e lejes quhet e miratuar në heshtje. Trupi gjykues vlerëson se arsyetimi dhe përdorimi i kësaj baze ligjore nga subjekti i rivlerësimit, bie ndesh logjikisht me përfundimin e arritur po prej tij në vendim, se vepra penale është amnistuar për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2014 “Për amnistinë”, i ndryshuar me ligjin nr. 92/2015, pasi nëse leja e ndërtimit ishte miratuar në heshtje, atëherë subjekti “{***}” ShPK nuk ndodhej në kushtet e kryerjes së veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm” dhe, për pasojë, as në kushtet e zbatimit të ligjit për amnistinë. Trupi gjykues vëren se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet as me provat e mbledhura gjatë hetimit, pasi referuar shkresës nr. {***} prot., datë 15.07.2015, të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, organi përgjegjës për dhënien e lejes së ndërtimit në rastin konkret ishte Këshilli Kombëtar i Territorit dhe jo kryetari i komunës apo bashkisë, siç ka arsyetuar subjekti i rivlerësimit për pushimin e procedimit penal.

34.6. Në arsyetimin për pushimin e procedimit penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 22/2014 “Për amnistinë”, i ndryshuar, i cili parashikonte se: “Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014” – si dhe bazuar në aktet e hetimit nga të cilat rezulton qartë se ndërtimi i kompleksit është kryer para datës 10 prill 2014, procedimi penal duhet pushuar, pasi vepra penale është amnistuar. Në referim të situatës faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se punimet për ndërtimin e objektit me investitor shoqërinë “{***}” ShPK kanë vazhduar edhe pas datës 10 prill 2014, vërtetuar nga të dhënat e referuara nga Komisariati i Policisë Shkodër në “Informacionin për referimin e veprës penale, për ndërtim pa leje në vendin e quajtur Plazhi Velipojë, me tabelë punimesh “{***}” ShPK”, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër në datat 17.11.2014 dhe 16.01.2015, si dhe në mbështetje të vetë arsyetimit të subjektit të rivlerësimit, në kërkesën për gjykim të procedimit penal, se është provuar që viktima M. K., në datën 05.06.2015, ka qenë duke punuar në objektin kompleksi turistik “{***}”.

Gjithashtu, në kuptim të nenit 71 të Kodit Penal, i cili parashikon se: “Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe”, trupi gjykues vlerëson se amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë përpara shpalljes së saj dhe nuk zbatohet për veprat penale të cilat vijnë në kryhen edhe pas datës së caktuar në ligjin përkatës për dhënien e amnistisë.

Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se procedimi penal nr. {***} nuk duhej pushuar.

34.7. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i arritur prej tij në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. {***}, është një çështje e bindjes së brendshme, vlerësohet nga trupi gjykues si i pabazuar, pasi në çdo rast analiza dhe arsyetimi që duhet të bënte subjekti i rivlerësimit, madje edhe bindja e brendshme e tij, detyrimisht duhet të mbështeten në faktet e rezultuara prej hetimit dhe në interpretimin e drejtë të ligjit.

35. Në konkluzion të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se gjendet i drejtë vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi profesionale në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë për të interpretuar ligjin, kriter që parashikohet nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

36. Lidhur me *procedimin penal nr. {***}, datë 28.06.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁴³, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e interpretimit të ligjit dhe në aspektin e arsyetimit të vendimit, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”.

36.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit si të pabazuar, duke pretenduar se Gjykata e Apelit ka arsyetuar se në bazë të neneve 329 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund të shprehet vetëm për bazueshmërinë e pretendimeve të ankuesit, të cilat i referohen moskryerjes së veprimeve të caktuara nga prokurori, të cilat kanë çuar në vlerësim të pasaktë të kriterëve ligjore të përcaktuara nga ligji, për të vendosur mosfillimin apo pushimin e një procedimi penal. Sipas subjektit të rivlerësimit, në asnjë rast gjykata nuk e zgjidh çështjen në themel, duke i hyrë analizës së fakteve, përndryshe ajo do të zëvendësonte prokurorinë në detyrën kushtetuese dhe ligjore. Në këto kushte, analiza e fakteve, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nuk është objekt vlerësimi nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016.

36.2. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi faktet si vijojnë.

36.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***}, datë 28.06.2016 dhe kallëzimin penal nr. {***}, datë 30.06.2016, të shtetases A. M., kundër

⁴³ *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimit nr. {***} prot., datë 22.11.2017, të znj. A. B. (M.).*

shtetasit D. M.. Ajo ka deklaruar se ka një kontratë të rregullt qiraje me shtetasen B. Sh., për një dyqan që i ka dhënë kësaj të fundit në përdorim. Në datën 25.06.2016, rreth orës 20:00, është njoftuar nga qiramarrësja se shtetasi D. M. i kishte kërkuar që deri në orën 09:00 të ditës së nesërme duhej të nxirrte mallrat që kishte në dyqan dhe po atë natë kishte ndërruar bravat dhe drynat e dyqanit dhe kishte vendosur polici private për të mos lejuar qiramarrësen të futej në dyqan. Kallëzuesja ka sqaruar gjithashtu se shtetasi D. M. është kushëri i bashkëshortit të saj (djali i djalit të xhaxhait) dhe se dyqani i dhënë me qira ishte objekt shqyrtimi gjyqësor prej rreth një viti, në një proces gjyqësor që po zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi shtetasi D. M. kërkonte pjesëtimin e kësaj pasurie.

36.2.2. Në vendimin e datës 30.07.2016, “Për mosfillimin e procedimit penal”, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se ka një proces gjyqësor civil për pjesëtimin e kësaj prone të dhënë me qira dhe ky fakt përbën mosmarrëveshje juridiko-civile, e cila do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Sipas arsyetimit të subjektit të rivlerësimit, është kjo gjykatë që do të vendosë nëse ky dyqan do t’i nënshtrohet pjesëtimin (ndarjes së pasurisë) dhe nëse po, në sa pjesë do të ndahet dhe kush do të jenë përfituesit e saj. Në këto kushte, kjo mosmarrëveshje juridiko-civile nuk është zgjidhur akoma me një vendim përfundimtar dhe të formës së prerë dhe vetëm atëherë secila nga palët do të jetë e qartë sa u përket pretendimeve që kanë pasur për pjesëtimin apo jo të kësaj pasurie dhe nuk mund të pretendojnë të kryejnë veprime në kundërshtim me vendimin gjyqësor përfundimtar të formës së prerë. Subjekti i rivlerësimit, si pasojë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

36.2.3. Me vendimin nr. {***}, datë 21.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit për mosfillimin e hetimeve lidhur me kallëzimin penal nr. {***} dhe detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e hetimeve, ku të pyetet shtetasi i kallëzuar D. M. dhe të merren provat shkresore të depozituara nga ankuesja Ariana Muja. Në vendim, gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: “Kallëzuesja ka pretenduar për kryerjen e veprimeve nga ana e të kallëzuarit, të cilat mund të përbëjnë elemente të veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. [...] Prokurori është mjaftuar me faktin se kallëzuesja dhe i kallëzuari janë pjesë e një procesi gjyqësor civil për pjesëtimin e pasurisë dhe nuk ka hetuar fare në lidhje me faktin nëse qëndrojnë pretendimet e kallëzueses se i kallëzuari i ka telefonuar shtetasen B. Sh., që ka ndërruar bravat e dyerve të dyqanit të poseduar prej saj. Shtetasi D. M. nuk është pyetur asnjëherë nga ana e prokurorit për të sqaruara faktet e pretenduara nga ana e kallëzueses. Nuk janë pyetur as persona të tjerë që mund të kenë qenë të pranishëm kur ka ndodhur fakti i pretenduar nga kallëzuesja. Sipas gjykatës, hetimet e kryera nga ana e prokurorisë janë të pavarura nga hetimi gjyqësor që kryen gjykata gjatë procesit gjyqësor civil.

36.2.4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 30.11.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 21.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e ankimit të kërkuarës A. M. kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 30.07.2016, për kallëzimin penal nr. {***}. Gjykata e Apelit ka arsyetuar, ndër të tjera, se: “Në ankimin e saj, ankuesja A. M. ka pretenduar se i kallëzuari

prej saj, D. M., ka konsumuar elementet e veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, por trupi gjykues çmon se edhe nëse do të ishim para konsumimit të kësaj vepre penale, përsëri ajo është amnistuar me ligjin nr. 141/2016, datë 22.12.2016, “Për dhënie amnistie””.

36.3. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në asnjë rast gjykata nuk e zgjidh çështjen në themel, duke i hyrë analizës së fakteve, përndryshe ajo do të zëvendësonte prokurorinë në detyrën kushtetuese dhe ligjore dhe, për këtë arsye, analiza e fakteve nuk është objekt vlerësimi nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, nga shqyrtimi i vendimit, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka mbështetur konkluzionin e tij në arsyetimin se: *Komisioni konstaton se subjekti, në rastin konkret, në vendimet e tij është mjaftuar me faktin se kallëzuesja dhe i kallëzuari janë pjesë e një procesi civil për pjesëtimin e pasurisë dhe nuk ka analizuar, në kuptim të nenit 277 të Kodit Penal, faktin nëse veprimet e të akuzuarit për njoftimin që i ka bërë qiramarrëses për të nxjerrë mallin dhe ndërrimi i drynave të dyqanit përbëjnë ose jo veprime të vetëgjyqësisë, në kushtet kur shtetasja B. Sh. kishte të lidhur paraprakisht një kontratë qiraje dhe i akuzuari nuk ishte në zotërim të sendit. Nga analizimi i vendimeve të subjektit dhe nga shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se subjekti nuk arrin të dallojë përgjegjësinë civile nga ajo penale. Procedimi penal ka karakter subjektiv, pasi ka si qëllim të individualizojë përgjegjësinë penale të personit të dyshuar, ndërkohë që gjykimi civil ka karakter objektiv, pasi ka si qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.*

37. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme hetimore për kallëzimin e shtetasës A. M., apo se nuk arrin të bëjë dallimin midis koncepteve të caktuara të së drejtës, vlerësohet se nuk përbëjnë tejkalim të tagrave të Komisionit, nën dritën e përcaktimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, apo zëvendësim të interpretimit apo logjikës së prokurorit, çka do të përbënin cenim të pavarësisë së tij në vendimmarrje. Për rrjedhojë, është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e interpretimit të ligjit dhe në aspektin e arsyetimit të vendimit, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
38. Lidhur me *procedimin penal nr. {***}, datë 06.02.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁴⁴, Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se: “Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”.

⁴⁴ *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimit nr. {***} prot., datë 10.12.2019, të z. E. M..*

38.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar fillimisht, në ankim, se Komisioni nuk ka pasur juridiksion në shqyrtimin e këtij denoncimi, pasi kallëzimi i kryer nga shtetasi E. M. është kryer jashtë periudhës së rivlerësimit, e përcaktuar nga neni 41, pika 3 e ligjit nr. 86/2014. Sipas subjektit ë rivlerësimit, bazuar në këtë parashikim ligjor, është përcaktuar nga organet e rivlerësimit se periudhë rivlerësimi është periudha tetor 2013 - tetor 2016. Disa nga çështjet të cilat janë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, janë regjistruar në prokurori pas muajit tetor 2016. Në këto kushte, pretendon subjekti i rivlerësimit, Kolegji nuk duhet të marrë në shqyrtim konkluzionet e arritura nga Komisioni lidhur me këtë çështje.

38.2. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ligji nr. 84/2016, në pikën 3 të nenit 41 ka përcaktuar periudhën e rivlerësimit për aftësitë profesionale, e cila do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit. Në pikën 4 të po këtij neni, parashikohet se *vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit të subjektit përkatës të rivlerësimit*. Në verifikimin e zbatimit të kuadrit ligjor të sipërcituar në rastin konkret, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka marrë në shqyrtim procedimin penal nr. {***}, datë 06.02.2018, në bazë të informacionit që ka disponuar për etikën dhe aftësitë profesionale, të përcjellë nga denoncimi i z. E. M., regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 10.12.2019, duke plotësuar kushtet e nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shtrirjen e periudhës së vlerësimit për aftësitë profesionale, për një periudhë më të gjatë kohore sesa tri vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Sipas jurisprudencës së Kolegjit⁴⁵, në kuadër të procesit të rivlerësimit, legjislacioni i zbatueshëm nuk kufizon në kohë faktet apo rrethanat objekt denoncimi, të cilat mund të kenë ndodhur edhe tej periudhës së rivlerësimit, por që përbëjnë shkak për hetim të mëtejshëm kur adresojnë shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në prova e në ligj.

38.3. Trupi gjykues, për të shmangur përsëritjen, nënvizon se arsyetimi i mësipërm shërben edhe për zgjidhjen e pretendimeve të njëjta të subjektit të rivlerësimit për disa nga çështjet e tjera në kuadër të kundërshtimit të konkluzioneve të arritura nga Komisioni, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të përcjella nga denoncimet e publikut.

38.4. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Kolegji nuk duhet të konstatojë mungesë të aftësive profesionale, jo vetëm për shkak se në rastin konkret subjekti i rivlerësimit ka vendosur bazuar në bindjen e tij të brendshme, por edhe për shkak të faktit se Komisioni ka gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, në kundërshtim me parashikimet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim⁴⁶, ka arsyetuar: “Lidhur me kërkesën e kallëzuesve për ndjekjen penale të shtetasve F. dhe B. M. për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” në formën e përdorimit, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e kërkesës për pushimin e çështjes, ka arsyetuar

⁴⁵ Vendimet e Kolegjit nr. 7/2023 (JR), datë 23.02.2023; nr. 31/2023 (JR), datë 18.07.2023 etj.

⁴⁶ Faqe 54 e vendimit të Komisionit.

lidhur me kohën kur janë plotësuar dokumentet e falsifikuara dhe me personat që e kanë bërë falsifikimin, por nuk ka hetuar nëse të kallëzuarit kanë pasur dijeni për falsifikimin, si dhe për kohën se kur i kanë përdorur për herë të fundit dokumentet e falsifikuara. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka konstatuar një sërë parregullsish të punonjësve të institucioneve shtetërore, në dëm dhe me pasoja në interesat e ligjshëm të kallëzuesve, nuk i ka analizuar në kuptim të përgjegjësisë individuale penale dhe nuk ka përcaktuar kohën e kryerjes së tyre, në mënyrë që të vlerësonte drejt dhe në përputhje me ligjin nëse në rastin konkret ishin konsumuar elementet e veprës penale “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

38.5. Nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si vijon.

38.5.1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 06.02.2018, mbi bazën e kallëzimit të datës 08.01.2018, nga shtetasit E. e B. M., vëllezër me njëritjetrin, të cilët kanë kallëzuar shtetasit F. e B. M. për veprat penale “Pushtimi i tokës“, “Ndërtimi i paligjshëm“ e “Falsifikimi i dokumenteve”. Sipas kallëzuesve, babai i tyre i ndjerë është pajisur nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit {***}, Shkodër, me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) nr. {***}, pa datë, me 3300 m² tokë, nga të cilat 300 m² truall, në fshatin {***}, Njësia Administrative Rrethina, Bashkia Shkodër. Në këtë pronë, të kallëzuarit kanë ndërtuar pa leje shtëpi, garazh e mure rrethuese dhe, për pasojë, kanë bllokuar dhe rrugën që shkon për në banesën e kallëzuesve. Kallëzuesit kanë pretenduar se kanë biseduar me të kallëzuarit, por këta pretendojnë se kanë ndërtuar në tokën e tyre, pasi edhe ata janë pajisur me AMTP. Kallëzuesit kanë referuar se AMTP-ja e pretenduar nga të kallëzuarit është një akt i jashtëligjshëm, i falsifikuar në bashkëpunim me kryetarin e fshatit, z. S. M.. Kallëzuesit kanë pretenduar se për këtë çështje u janë drejtuar edhe organeve shtetërore për ndërtimet pa leje dhe pushtimin e pronës së tyre nga të kallëzuarit dhe nga hetimet që do të bëjë prokuroria, mund të dalin edhe persona me detyra shtetërore që në kryerjen ose moskryerjen e funksioneve të tyre publike, kanë konsumuar veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, duke lëshuar dokumente zyrtare jashtë kompetencave ligjore. Së bashku me kallëzimin, ata kanë dorëzuar dhe akte e prova, ndër të cilat dhe vendime gjyqësore, si dhe korrespondencën e ndjekur me organet shtetërore, që, sipas tyre, provojnë faktet e kallëzuara. Në përfundim, kallëzuesit kanë kërkuar që të ndiqen penalisht të kallëzuarit F. dhe B. M., për veprat penale “Pushtim toke”, “Ndërtim pa leje” dhe “Falsifikim i dokumenteve”.

38.5.2. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, pasi ka hetuar faktet e kallëzuara, më datë 24.09.2018, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesën për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, datë 06.02.2018, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: “Lidhur me veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” (në formën e përdorimit), parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, rezulton se dokumentacioni i këtyre akteve është dorëzuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP), Shkodër, më datë 12.12.2005, konkretisht njëra nga këto praktika lidhet me AMTP-në me nr. {***} që i përket shtetasit B. M., dërguar me shkresën me nr. {***} prot., datë 12.12.2005, të Këshillit të Qarkut Shkodër, si dhe praktika tjetër që lidhet me AMTP-në me nr. {***}, dërguar me shkresën me nr. {***} prot., datë 15.12.2005, të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe në këto kushte, edhe sikur përmbajtja e këtyre dokumenteve të ishte e falsifikuar, ajo që paraqet rëndësi është ana subjektive

e subjektit të kësaj vepre penale, që do të thotë se shtetasit F. dhe B. M. janë pajisur me AMTP nga shtetasi S. M. që mbante vulën e kryetarit të fshatit {***}, dhe këto AMTP kanë pasur edhe vulën e Komunës Rrethina, si dhe firmën e përfaqësuesit të Kadastrës, dhe dokumenti nga ana formale nuk ka pasur mangësi dhe nuk kishte arsye të mendohej nga ana e këtyre shtetasve, se ishte dokument me përmbajtje të falsifikuar. Nga ana tjetër, edhe sikur ky dokument të ishte i falsifikuar dhe lidhur me përmbajtjen e falsifikimit, të ishin në dijeni këta shtetas, ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale, pra ka kaluar afati pesëvjeçar që parashikohet nga neni 66, shkronja “c” e Kodit Penal. [...] nga ana tjetër, nga kallëzuesit kërkohet të hetohet lidhur me mënyrën se si janë plotësuar aktet e marrjes së tokës nga ana e të ndjerit S. M., i cili ka pasur mandatin deri më datë 07.04.2004, por ka plotësuar AMTP-në edhe pas mbarimit të mandatit, konkretisht më datë 15.12.2005. Lidhur me këtë, nga ana e kallëzuesve është paraqitur si provë vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 25.11.2009, i Gjykatës së Apelit Shkodër, ku rezulton se i pandehuri S. M. është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal [...]. Sipas arsyetimit të gjykatës, rezulton se “[...] i pandehuri nuk është subjekt i veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sepse nuk ka qenë i emëruar apo i zgjedhur ligjërisht asnjëherë si kryetar i KNT-së në fshatin {***}. Gjykata shprehet se përpilimi i AMTP-ve nga i pandehuri, [...] përbën elemente të veprës penale të “Përvetësimit të titullit apo detyrës shtetërore”, të parashikuar nga neni 246/1 i Kodit Penal, por meqë kanë kaluar më shumë se 6 vjet nga kryerja e këtyre veprimeve [...] konform nenit 66/ç të Kodit Penal, jemi para parashkrimit të ndjekjes penale. [...] në këto kushte, është e qartë se lidhur me pretendimet e kallëzuesve, ka vendime gjyqësore të formës së prerë dhe prokuroria nuk mund të fillojë hetimin ndaj shtetasit S. M., për faktin se ky shtetas ka vdekur”.

38.5.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2018, ka vendosur: *1. Mospranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, regjistruar në datën 06.02.2018, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal. 2. Kthimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e hetimeve për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*

38.5.4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 27.09.2019, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në të cilin, ndërmjet të tjerave, arsyeton se: *Së pari: lidhur me veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, në formën e përdorimit, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal [...] me të drejtë gjykata e shkallës së parë i ka ngarkuar organit të prokurorisë si detyrë të hetojë faktin nëse shtetasit F. e B. M. i kanë përdorur këto dokumente të falsifikuara dhe se kur është momenti i fundit që këto dokumente të falsifikuara janë përdorur prej tyre. Gjithashtu, ajo çka është thelbësore për t’u përcaktuar dhe hetuar nga organi i akuzës, është nëse të kallëzuarve iu takonte tokë në bazë të ligjit nr. 7501 apo jo, nëse ishin trajtuar më parë, ku e kishin marrë etj. Vetëm përcaktimi i këtyre momenteve do të ishte deciziv jo vetëm në lidhje me anën subjektive, por edhe lidhur me parashkrimin e kësaj vepre penale, dhe jo llogaritja e afateve apriori nga momenti i hartimit të këtyre akteve [...]. Së dyti, lidhur me veprën penale “Shpërdorim*

detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, organi i akuzës, megjithëse ka konstatuar një sërë parregullsish të punonjësve të institucioneve shtetërore, me dëm dhe pasoja në interesat e ligjshëm të kallëzuesve, nuk i ka identifikuar ato, nuk i ka analizuar në kuptim të përgjegjësisë individuale penale, nuk ka përcaktuar kohën e kryerjes së tyre, në mënyrë që të konkludonte drejt dhe në përputhje me ligjin [...].

38.6. Në mbështetje të pretendimit të tij, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se në rastin në fjalë, ai ka zbatuar me korrektësi një vendim të mëparshëm të Gjykatës së Apelit Shkodër me nr. {***}, datë 25.11.2009, i cili në disponimin e tij, nuk i ka cilësuar AMTP-të si të falsifikuara dhe nuk ka urdhëruar asgjësimin e tyre. Kjo gjykatë shprehet se përpilimi i AMTP-ve nga i pandehuri S. M., përbën elemente të figurës së veprës penale të përvetësimit të titullit apo detyrës shtetërore, parashikuar nga neni 246/1 i Kodit Penal. Por meqë kanë kaluar më shumë se 6 vjet nga kryerja e këtyre veprimeve derisa ai është marrë si i pandehur në datën 29.09.2008, edhe sikur të provohej kryerja e kësaj veprë penale, në bazë të nenit 66/ç të Kodit Penal, jemi para parashkrimit të ndjekjes penale që sjell pushimin e çështjes penale. Në këto kushte, duke pasur një vendim gjyqësor të formës së prerë, ka qenë i detyruar t’i referohej këtij vendimi dhe nuk mund të anashkalonte atë, duke e injoruar zbatimin e tij. Pavarësisht këtij fakti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër, megjithëse kishte një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili nuk i kishte cilësuar AMTP-të si të falsifikuara, kanë vlerësuar se duhet të hetohet për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” në formën e përdorimit, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, dhe “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në verifikim të këtyre argumenteve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vëren se ato janë një përsëritje e argumenteve të përdorura prej tij në arsyetimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale nr. {***}, datë 06.02.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

38.7. Trupi gjykues konstaton se argumenteve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit u ka dhënë përgjigje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila në vendimin nr. {***}, datë 19.12.2018, ka arsyetuar, ndër të tjera: “[...] shtetasit E. e B. M. nuk kanë kallëzuar të ndjerin S. M., si personin që ka hartuar e pajisur shtetasit F. e B. M. me AMTP në kundërshtim me ligjin. Ata kanë kallëzuar shtetasit F. e B. M. se posedojnë e përdorin dokumente të falsifikuara, konkretisht AMTP-të [...], lëshuar nga z. S. M. më datë 15.12.2005. Provohet se këto dy AMTP janë deklaruar të pavlefshme me vendim të organit kompetent shtetëror që në vitin 2005, provohet se të kallëzuarit janë në dijeni të këtij fakti dhe se për këtë shkak, pasuria e përfutur prej këtyre dy AMTP-ve nuk është regjistruar në emër të tyre në ZVRPP. Por nga ana tjetër, provohet se dhe tani prona e kallëzuesve mbahet nga të kallëzuarit në saje të dy AMTP-ve të pavlefshme. Nga ana e prokurorit, është arsyetuar fakti se dy AMTP-të janë të falsifikuara, por nuk është hetuar fakti nëse shtetasit F. e B. M. i kanë përdorur këto dokumente të falsifikuara dhe se kur është momenti i fundit që këto dokumente janë përdorur prej tyre”.

Edhe Gjykata e Apelit, në vendimin nr. {***}, datë 27.09.2019, ka arsyetuar se: “Prokuroria për dhënien e çdo përgjigjeje lidhur me pretendimet për shkelje dhe kryerje të mundshme të veprave penale, u është referuar vendimeve gjyqësore përkatëse (vendime civile në të shumtën e rasteve), si dhe vendimeve të organeve administrative mbi konfliktin në fjalë, duke mos analizuar në mënyrë

të detajuar kallëzimin për veprën penale, dispozitën konkrete, veprimet e kryera nga punonjësit shtetërorë dhe faktin nëse ato përbëjnë vepër penale”.

39. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se në procedimin penal të analizuar, subjekti i rivlerësimit sërish ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë përcjelljen e çështjes në gjykim me kërkesën për pushimin e saj, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe një interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme dhe përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në të. Për pasojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, si dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
40. Lidhur me *procedimin penal nr. {***}, datë 07.06.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁴⁷, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, kriteret të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në konkluzionin e mësipërm, pasi ka analizuar disa vendime të marra nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të hetimit lidhur me procedimin penal objekt kontrolli.

40.1. Nga aktet e hetimit administrativ të zhvilluar në Komision, trupi gjykues konstaton si më poshtë.

40.1.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në bazë të kallëzimit penal të shtetasve M. dhe P. K. kundër shtetasit D. H., ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 02.03.2018, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Kallëzuesit kanë pretenduar se në procesin gjyqësor të zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me palë paditës i kundërpaditur D. H., të paditur kundërpaditës M. dhe P. K., me objekt padie: “Kthim sendi, pasuri e paluajtshme truall”, si dhe me objekt të kundërpadisë: “Detyrim për t’u njohur pronar me parashkrim fitues mbi një sipërfaqe 4150 m², të blerë me një deklaratë dore, datë 20.12.1990, nga i ndjeri P. K. dhe P. K., shitësit S. K.”, janë paraqitur prova shkresore për të cilat kanë dyshimin se janë të falsifikuara nga vetë paditësi D. H., konkretisht: vendimi nr. {***}, datë 05.11.1996, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Shkodër, si dhe dokumenti “Notë transkriptimi”, datë 04.09.1945.

40.1.2. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 15.03.2018, ka vendosur mosfillimin e çështjes penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

⁴⁷ *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni në kuadër të denoncimeve nr. {***} prot., datë 05.02.2020 dhe nr. {***} prot., datë 03.03.2020, të znj. N. K., si dhe denoncimit nr. {***} prot., datë 03.03.2020, të z. M. K..*

40.1.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi bazën e ankimit të kallëzuesve K., me vendimin nr. {***}, datë 25.04.2018, ka rrëzuar ankesën, duke e konsideruar vendimin e subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e çështjes penale si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në ligj.

40.1.4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 04.06.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, duke urdhëruar prokurorinë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallëzim, sipas detyrave të lëna në pjesën arsyetuese të vendimit. Gjykata e Apelit ka arsyetuar: “[...] Në rastin konkret, palët kallëzuese kanë pretenduar për ekzistencën e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, në formën e përdorimit të tyre në një gjykim civil, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Në këtë kallëzim, ata kanë argumentuar në mënyrë të detajuar dhe shkaqet apo të dhënat konkrete që ngrenë dyshime lidhur me falsitetin e dy akteve shkresore me rëndësi thelbësore, si: vendimi nr. {***}, datë 05.11.1996, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Shkodër, si dhe “Nota e transkriptimit” e vitit 1945. Mbi këto pretendime, organi i prokurorisë nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, por duke u bazuar në një vendim gjyqësor civil, ka argumentuar se këto akte të pretenduara si të falsifikuara, janë konsideruar dhe shqyrtuar si të sakta me një vendim gjyqësor të formës së prerë, përkatësisht vendimi nr. {***}, datë 11.12.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në fakt, ky vendim civil i formës së prerë, i cili citohet nga organi i prokurorisë si fakt ndalues për të kryer hetime të mëtejshme, nuk ka marrë në shqyrtim në asnjë moment pretendimet e kallëzuesve për falsitetet të provave shkresore, por thjesht ka zhvilluar një gjykim civil në praninë e palëve të tjera, duke u fokusuar në sipërfaqen e pronës së pretenduar në pronësi, dhe pa analizuar ndonjë pretendim apo kërkesë lidhur me falsitetin e akteve shkresore objekt i këtij kallëzimi penal. [...] Përkatësisht organi i prokurorisë duhet të drejtojë hetimet në kuptim të verifikimit të pretendimeve të kallëzuesve mbi falsitetin e akteve shkresore: të marrë dhe të administrojë deklaratimet e kallëzuesve M. dhe P. K., lidhur me faktin penal të pretenduar; të administrojë dhe të pyesë në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, shtetasin D. H.; të administrojë dosjen e vendimit nr. {***}, datë 05.11.1996, të KKKP-së, Bashkia Shkodër, me të gjitha aktet që ajo përmban; të kryejë një akt ekspertimi grafik nëse ka ose jo ndërhyrje grafike apo të llojeve të tjera në këto dy akte shkresore: vendimi nr. {***}, dt. 05.11.1996 dhe “Nota e transkriptimit” e vitit 1945, si dhe për fletët e regjistrit përkatës ku janë pasqyruar këto akte; të bëhet këqyrja e dosjes gjyqësore që i përket vendimit civil nr. {***}, dt. 11.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të parë dhe konkluduar nëse janë përdorur ose jo dokumentet objekt ekspertimi; të hetohet në drejtim të kronologjisë së vendimeve të marra nga ish-KKKP Bashkia Shkodër, në muajt shkurt dhe nëntor të vitit 1996, duke marrë informacion të numrit të vendimeve të marra në secilin muaj, nr. përkatës të protokollit që ata disponojnë dhe përputhjet apo mospërputhjet përkatëse lidhur me datat e vendimeve”.

40.1.5. Lidhur me sa më sipër, Komisioni ka arsyetuar në vendim, në mënyrë të përmbledhur, se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar pretendimet e kallëzuesve për falsifikimin e akteve shkresore, por ka vendosur mosfillimin e çështjes me argumentin se provat shkresore që pretendohen të jenë të falsifikuara, janë shqyrtuar një herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.

{***}, datë 11.12.2001. Në këtë vendim, gjykata nuk ka analizuar ndonjë pretendim apo kërkesë lidhur me falsitetin e notës së transkriptimit të vitit 1945 apo vendimit nr. {***}, datë 05.11.1996, të KKKP-së Bashkia Shkodër. Komisioni ka arsyetuar se referenca që bën subjekti në vendimin gjyqësor civil është jorelevante, pasi në zbatim të nenit 71 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit mund t'i referohej vendimit gjyqësor civil nëse gjatë gjykimit civil do të ishin ngritur pretendime për falsitetin e dokumenteve, sipas nenit 270 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe këto pretendime të ishin marrë në shqyrtim nga gjykata civile, në përputhje me rregullat procedurale civile.

40.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, në ndryshim nga shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka pretenduar se konstatimi i Komisionit është i gabuar, pasi vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 11.12.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kishte vlerë provuese vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, pasi subjekti i rivlerësimit, në vendimin e datës 15.03.2018, për mosfillimin e procedimit penal, ka analizuar se nuk konstatohen elemente të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

40.3. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në vendimin e datës 15.03.2018, për mosfillimin e çështjes penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: “[...] kallëzuesit kanë pretendime lidhur me disa pasaktësi dhe ngrenë dyshimin se kemi të bëjmë me një dokumentacion të falsifikuar [...]. Nga ana tjetër, nëse i referohemi vendimit nr. {***}, datë 11.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 05.11.1996, të KKKP-së Shkodër, rezulton se gjykata, përveç provave shkresore të shqyrtuara, ndër të cilat nota e transkriptimit nr. {***}, datë 26.09.1945, harta dhe prova të tjera shkresore, ka caktuar edhe një ekspert për të bërë matjet, në prezencë edhe të kufitarëve të kësaj sipërfaqeje. [...] Provat shkresore që pretendohen të jenë të falsifikuara janë shqyrtuar një herë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 11.12.2001, i ka vlerësuar të sakta dhe jo me përmbajtje të falsifikuar dhe vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Gjithashtu, këto prova po i nënshtrohen edhe një herë shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata do të vendosë për vlefshmërinë dhe provueshmërinë e tyre. Në këto kushte, nuk konstatojmë elemente të ndonjë vepre penale dhe procedimi penal nuk mund të fillojë”.

40.4. Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstaton se në arsyetimin e vendimit për mosfillimin e çështjes penale, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e veprës penale për të cilën është paraqitur kallëzimi penal, por argumenti i vetëm i përdorur prej tij për të mbështetur mosfillimin e procedimit penal, është vetëm fakti se aktet e pretenduara si të falsifikuara, janë shqyrtuar nga gjykata, e cila i ka vlerësuar jo të falsifikuara. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***}, datë 11.12.2001, i cili citohet nga subjekti i rivlerësimit në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, ka si objekt: “Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 05.11.1996, të KKKP Shkodër” dhe palë ndërgjyqëse: paditës – trashëgimtarët e Sh. H. dhe e paditur – KKKP Shkodër. Në këtë gjykim, pala paditëse ka pretenduar se KKKP Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 05.11.1996, sipas notës së transkriptimit të vitit 1945, ka vendosur kthimin në pronësi të gjithë sipërfaqes, ndërsa konkretisht u ka kthyer në pronësi vetëm 4.500 m². Në këtë

gjykim, siç rezulton nga përmbajtja e vendimit gjyqësor, kallëzuesit Kulla nuk kanë qenë palë, nuk është ngritur asnjë pretendim për falsifikim të akteve shkresore, objekti i gjykimit ka qenë sipërfaqja e pronës së pretenduar e që u është kthyer të kallëzuarve nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Shkodër. Duke qenë se gjykata civile, në vendimin e referuar nga subjekti i rivlerësimit, nuk ka marrë në shqyrtim për asnjë moment faktet penale të pretenduara nga kallëzuesit K. dhe subjekti i rivlerësimit nuk i ka hetuar me argumentin se janë vlerësuar si të sakta nga gjykimi civil, rezulton se pretendimet e kallëzuesve kanë mbetur pa përgjigje. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit se, referuar rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi, vendimi civil nr. {***}, datë 11.12.2001, mund të referohej nga subjekti i rivlerësimit si fakt ndalues për të kryer hetime të mëtejshme, vetëm nëse gjatë gjykimit civil do të ishin ngritur pretendime për falsitetin e dokumenteve, sipas nenit 270 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe këto pretendime të ishin marrë në shqyrtim nga gjykata civile në përputhje me rregullat procedurale civile.

40.5. Në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 04.06.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, të analizuar më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 07.06.2018. Trupi gjykues konstaton se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë procedim, kanë qenë si vijojnë.

40.5.1. Me vendimin e datës 24.10.2018, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. {***}, datë 07.06.2018 dhe nr. {***}, datë 24.10.2018 në një procedim të vetëm me nr. {***}, duke caktuar subjektin e rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes. Procedimi penal nr. {***}, datë 24.10.2018, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ishte regjistruar mbi kallëzimin e shtetases N. K., e cila ka kallëzuar se pas vitit 2014, i ka lënë në ruajtje pronën e saj shtëpi dhe tokë shtetasit G. K. dhe ky i fundit, pa pëlqimin e saj, ka lidhur një kontratë shitblerjeje të pronës me shtetasin D. H.. Kallëzuesja ka pretenduar se pronën ia kanë vjedhur me vendimin e gjykatës nr. {***}, datë 11.12.2001, pa pasur dijeni as ajo, as të afërmit e saj.

40.5.2. Pas kryerjes së veprimeve hetimore të lëna si detyrë në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 12.06.2019, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 07.06.2018, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

40.5.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vendimin nr. {***}, datë 25.07.2019, pasi ka referuar se procedimi penal nr. {***} është bashkuar me procedimin penal nr. {***}, datë 24.10.2018, të nisur mbi kallëzimin e shtetases N. K., ka arsyetuar se: “Pavarësisht se nga ana e Prokurorisë kërkohet pushimi kësaj edhe i procedimit penal të nisur mbi bazën e pretendimeve të shtetases N. K., në asnjë moment nuk arsyetohet në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve të kësaj të fundit. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Prokurorisë nuk u paraqit në gjykim për të sqaruar se përse pretendimet e kallëzueses K. nuk janë cekur fare nga ky i fundit në kërkesën e paraqitur. Në këto kushte, gjykata, duke vlerësuar se kërkesa e prokurorit është e paarsyetuar, vlerëson se ajo nuk duhet të pranohet, pasi organi i akuzës nuk ka marrë fare në shqyrtim pretendimet e kallëzueses

N. K.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 17.10.2019.

40.6. Në mbështetje të kësaj situate faktike, Komisioni ka arsyetuar në vendim se në kërkesën e datës 12.06.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 07.06.2018, subjekti i rivlerësimit *ka pasqyruar vetëm rrethanat e faktit dhe detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. {***}, datë 04.06.2018, lidhur me kallëzimin e shtetasve M. dhe P. K., pa u shprehur nëse vërtetohen ose jo pretendimet e kallëzueses N. K.. Mosparaqitja e shkaqeve të parashtruara nga kallëzuesja K., krijon dyshime mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe së drejtës për t’u dëgjuar.*

40.7. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, në kundërshtim të arsyetimit të mësipërm të Komisionit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna në përgjigje të barrës së provës së kaluar me rezultatet e hetimit administrativ, duke parashtruar se në asnjë rast, nuk ka pasur si qëllim që të krijohen dyshime mbi cenimin e së drejtës së ankimit dhe së drejtës për t’u dëgjuar, pasi siç rezulton edhe nga veprimet hetimore të kryera, shtetasja N. K. është thirrur dhe pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, ku ka konfirmuar se pretendonte se pasuria i ishte marrë me anë të vendimit nr. {***}, datë 11.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në kërkesën për pushimin e procedimit nr. {***}, ai ka cituar faktin se ishte bashkuar dhe një procedim tjetër penal me kallëzuese N. K., që kishte lidhje me të njëjtin fakt. Sipas subjektit të rivlerësimit, është e qartë se kërkesa për pushim është kthyer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për shkak të mosparaqitjes së tij në seancën gjyqësore për të sqaruar gjykatën për pretendimet e shtetasës N. K., pavarësisht se gjykata nuk kishte asnjë pengesë të verifikonte nëse kjo shtetase ishte pyetur apo jo dhe cilat ishin pretendimet e saj, por ka zgjedhur rrugën më të shkurtër, duke e kthyer çështjen për hetim.

40.8. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të analizuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se është e vërtetë që në kërkesën e datës 12.06.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 07.06.2018, subjekti i rivlerësimit, në paragrafin e parafundit të parashtrësës, ka referuar bashkimin e procedimeve në një të vetëm, edhe pse emri i kallëzueses nuk përmendet fare në të. Por ky fakt nuk është mohuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, përkundrazi është potencuar, se në kërkesë kërkohet edhe pushimi i procedimit penal, të bashkuar me atë me nr. {***}. Nga kontrolli i kërkesës së datës 12.06.2019, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në asnjë moment, nuk ka përmendur dhe as analizuar pretendimet e kallëzueses N. K., mbi bazën e të cilave është regjistruar procedimi nr. {***}, datë 24.10.2018, i bashkuar me atë me nr. {***}. Në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, gjykata nuk ka kërkuar praninë e tij në gjykim, për të parashtruar pretendimet e kallëzueses, por, siç shprehet vetë gjykata në vendim, prania e prokurorit ishte e nevojshme *për të sqaruar se përse pretendimet e kallëzueses K. nuk janë cekur fare nga prokurori në kërkesën e paraqitur.*

40.9. Trupi gjykues çmon se argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit se gjykata nuk kishte asnjë pengesë të verifikonte cilat ishin pretendimet e kallëzueses, nuk mund të shmangë

konstatimin se kërkesa e tij për pushimin e procedimit penal, lidhur me pretendimet e kallëzueses N. K., është tërësisht e paarsyetuar, fakt ky i potencuar edhe nga kontrolli gjyqësor. Në ushtrim të kompetencës për evidentimin e përgjegjësisë penale, kërkesat e Prokurorisë drejtuar gjykatës, duhet të jenë të arsyetuara, duke mbajtur në konsideratë se ky arsyetim shërben si një garanci për procesin e rregullt ligjor, i cili i garantohet individit nga neni 42 dhe 142/1 i Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në rastin konkret, mungesa e arsytimit për sa u përket pretendimeve të kallëzueses, i ka krijuar asaj bindjen se kallëzimi i saj nuk është marrë në konsideratë dhe kjo ka qenë dhe shkaku i paraqitjes së denoncimit ndaj subjektit të rivlerësimit, pranë organeve të rivlerësimit. Në konsideratë edhe të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila në jurisprudencën e saj, në mënyrë konstante ka vlerësuar rëndësinë e një vendimi të arsyetuar⁴⁸, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, kërkesave të ndryshme të palëve, ligjeve të zbatueshme dhe arsyeve të vendimmarrjes, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar dhe argumenti i dhënë prej tij se qëndrimi i gjykatës është ndikuar nga mungesa e tij në gjykimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal, vlerësohet si përpjekje për të justifikuar mosushtrimin e funksionit në përputhje me ligjin, me pasojë cenimin e të drejtave të palëve në proces.

40.10. Nga verifikimi i akteve të dosjes së procedimit penal nr. {***}, trupi gjykues konstaton se më datë 18.05.2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër është regjistruar kërkesa e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

40.10.1. Me vendimin nr. {***}, datë 21.09.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal dhe kthimin e akteve prokurorisë, duke lënë një afat 4-mujor për kryerjen e hetimeve. Gjykata ka arsyetuar se nga ana e organit të akuzës, nuk janë kryer të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 04.06.2018. Sipas Gjykatës së Apelit, *rezulton se nga ana e prokurorisë nuk është ekspertuar fleta e regjistrimit me nr. {***} prot., datë 19.04.2019 dhe po ashtu nota e transkriptimit nr. {***}, datë 26 shtator 1945. Po ashtu, nga ana e prokurorit, nuk i është dhënë përgjigje pretendimit se vendimi nr. {***}, datë 05.11.1996, i KKKP-së është regjistruar në radhorin e pronësisë me nr. {***} prot., datë 19.04.1996, shtatë muaj para se të jepej vendimi, dhe kjo nuk është sqaruar nga organi i akuzës.*

40.10.2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, më datë 04.06.2021, i ka dërguar për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka referuar se vendimi nr. {***}, datë 21.09.2020, i Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë

⁴⁸ Vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 55, datë 18.12.2015; nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

formë të prerë më datë 03.12.2020 dhe fashikujt e procedimit penal nr. {***} i janë dorëzuar atij më datë 11.12.2020.

40.10.3. Komisioni, në vendim, lidhur me zbatimin e vendimit nr. {***}, datë 21.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka arritur në konkluzionin se: “[...] shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se “afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është afat hetimor që u nënshtrohet parashikimeve të institutit të afatit të hetimeve paraprake të rregulluara nga nenet 323 e vijues të Kodit të Procedurës Penale”, është i pambështetur në dispozitat procedurale, pasi nenet 323-327 i referohen afatit të përfundimit të hetimeve paraprake që zhvillon prokurori. Në këto dispozita përcaktohet e drejta e prokurorit për zgjatjen e tyre, ndërsa vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake është parashikuar në kreun VIII, “Përfundimi i hetimeve”, të Kodit të Procedurës Penale, nenet 329, 329/a170 dhe 329/b171. Bazuar në këto dispozita, gjyqtari i seancës paraprake vendos kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve kur çmon se janë të paplota dhe cakton afatin brenda të cilit duhet të përfundojnë, moszbatimi i afatit të vendosur nga gjykata përbën shkelje procedurale nga organi i akuzës. Neni 324 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren”. Sa më sipër, shpjegimi i subjektit se afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është afat hetimor, është i pambështetur. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se hetimet kanë zgjatur më tepër se 4 muaj, duke tejkaluar afatin e vendosur nga gjykata”.

40.11. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar vlerësimin e mësipërm të Komisionit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pa mbaruar afati 4-mujor për kryerjen e veprimeve hetimore, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për të kërkuar zgjatjen e këtij afati, pasi nuk ishin kryer të gjitha veprimet që kishte caktuar kjo gjykatë. Në vendimin nr. {***}, datë 04.05.2021, gjykata ka argumentuar se: “Afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është afat hetimor që u nënshtrohet parashikimeve të institutit të afatit të hetimeve paraprake të rregulluara nga nenet 323 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Si rrjedhojë, në çështjen objekt gjykimi, afati i vendosur nga gjykata është një afat disiplinor për organin e akuzës, në mënyrë që kjo e fundit të mbyllë në një kohë të caktuar hetimet e kërkuara nga ana e gjykatës”. Referuar këtij vendimi, që rezulton të jetë i formës së prerë, është pranuar nga vetë gjykata se nuk mund të bëhet zgjatje e afatit të hetimeve në kuptimin procedural në rastin konkret.

40.12. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vendimin nr. {***}, datë 04.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kërkesë Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga prokurori Ermir Lelçi dhe objekt “Kërkesë për zgjatjen e afatit të hetimeve për procedimin penal nr. {***}”. Në këtë vendim, gjykata ka referuar se prokuroria ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimeve për një periudhë 2-mujore, pasi për shkak të dinamikës së veprimeve hetimore, nuk është mundur të përfundohen detyrat e lëna nga gjykata me vendimin nr. {***}, datë 21.09.2020. Gjykata, përpos sa është referuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në pretendimin e tij, ka arsyetuar se kërkesa e prokurorit

për zgjatje të afateve të hetimit të caktuar nga gjykata, lidhur me procedimin penal nr. {***}, është *pa bazë ligjore dhe, si e tillë, duhet rrëzuar*. Në arsyetimin e vendimit, gjykata ka qartësuar kërkesin (subjektin e rivlerësimit), duke vlerësuar se: “Nisur nga interpretimi i qëllimit të ligjit në parashikimin e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, mund të themi se kompetencat që ligji i ka dhënë atij janë kompetenca ekskluzive të cilat nuk mund të kufizohen apo suprimohen nga dispozita të cilat janë të detyrueshme vetëm për organin e akuzës. Nëse afati i hetimeve paraprake ka si synim nxitjen e diligjencës së prokurorisë në kryerjen e veprimeve hetimore, ai nuk mund të vlejë si kufizues kompetencash për organe të tjera për të cilat nuk adresohet ky detyrim. Pra, duke qenë se afati për kryerjen e hetimeve është një detyrim që ligji ia ngarkon organit të akuzës, pasojën e mosrespektimit të tij e sjell vetëm për akuzën. E thënë më ndryshe, prokurori nuk mund të shmanget nga optika e kontrollit gjyqësor vetëm duke lejuar kalimin e afateve të hetimit. Në këto kushte, do të ishte më afër logjikës së ligjit që të pranonim se përfundimi i afateve të hetimeve paraprake nuk e kufizon gjyqtarin e seancës paraprake në ushtrimin e kompetencës së tij për të disponuar kryerjen e veprimeve hetimore shtesë, duke caktuar më tej një afat procedural për kryerjen e tyre, afat ky i cili nuk duhet parë i lidhur me afatet e hetimeve paraprake sipas neneve 323 e vijues të K.Pr.P.”.

Nga sa më sipër, rezulton se edhe pse gjykata ka rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për zgjatjen e hetimeve, ai ka vazhduar me hetimet paraprake⁴⁹, duke administruar aktin e ekspertimit shtesë dhe disa shkresa me lëndë “Kthim përgjigje”, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Shkodër.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

40.13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim gjithashtu, se për procedimin penal nr. {***}, edhe pse janë kryer veprime të ndryshme procedurale lidhur me pretendimet e kallëzuesve, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 12.07.2021, si dhe Gjkata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 15.11.2021, kanë arritur në përfundimin e njëjtë me subjektin e rivlerësimit se nuk konstatohen elemente të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal, pasi nuk provohet kryerja e veprës penale, kjo zgjidhje ka ardhur pas kërkesave të vazhdueshme të gjykatës për kryerjen e një hetimi të thelluar dhe të gjithanshëm të çështjes, si dhe pas më shumë se tri vitesh nga regjistrimi fillestar i procedimit penal. Pra, pasja e një qëndrimi të njëjtë nga gjykata pas kryerjes nga subjekti të veprimeve hetimore të urdhëruara prej saj, nuk justifikon mosndërmarrjen logjike të hetimeve prej tij prej momentit të regjistrimit të procedimit penal, për të konkluduar më tej se nuk u provua vepra penale.

Për këtë arsye, ky pretendim vlerësohet si jorelevant për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në këtë çështje.

40.14. Sa i përket pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se është e pabazuar gjetja e Komisionit, se zgjatja e afateve të hetimit duhej bërë me vendim të prokurorit, trupi gjykues vëren

⁴⁹ Nga verifikimi i akteve të dosjes së procedimit penal nr. {***}, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, emrin e personit që i atribuohet vepra penale.

se ky pretendim është përsëritje e shpjegimeve të tij të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit dhe, për rrjedhojë, u referohen gjetjeve fillestare të hetimit administrativ të Komisionit, gjetje këto për të cilat Komisioni nuk ka arritur në ndonjë konkluzion në vendim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me çështjen objekt kontrolli.

40.15. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”) është vënë në lëvizje nga z. M. K. dhe znj. N. K., dhe ky institucion e ka njoftuar se ankesa e këtyre shtetasve është arkivuar, që do të thotë se nuk janë konsideruar shkelje të asaj mase që të fillojë procedimi disiplinor ndaj këtij magjistrati. Komisioni nuk e ka pasqyruar këtë fakt, megjithëse vendimi përkatës i është përcjellë nga ILD-ja.

Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, me shkresën “Informacion”, drejtuar Komisionit, ka paraqitur vendimin e ILD-së nr. {***} prot., datë 25.05.2021, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi M. K.”. Në këtë vendim, inspektori ka referuar se ankuesi M. K., lidhur me procedimin penal nr. {***}, ka ngritur pretendime për moskryerjen e hetimeve të plota nga ana e prokurorit Ermir Lelçi, sipas detyrave të lëna nga vendimi nr. {***}, datë 04.06.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër, si dhe ndaj vendimmarrjes së prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake. Në vendim, referohet gjithashtu, edhe ankesa e paraqitur nga znj. N. K. për të njëjtën çështje. Në përfundim, inspektori ka vlerësuar se nisur nga natyra e pretendimeve dhe fakti se çështja ka të bëjë me vlerësimin e provave, ILD-ja nuk mund të marrë atributet e një organi të pavarur kushtetues, sikurse është prokuroria, bazuar në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve ndaj vendimmarrjes së prokurorit, sipas inspektorit, është atribut i gjykatës dhe kjo kompetencë ekskluzive e saj nuk mund të zëvendësohet me hetimin disiplinor që mund të realizohet ndaj veprimtarisë së prokurorit, i cili është i një natyre krejt të ndryshme nga ajo e zgjidhjes së çështjes në themel.

Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë vendimmarrjen e ILD-së, ashtu siç është pasqyruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Pavarësisht konkluzionit të ILD-së, për arkivimin e ankesës së shtetasve M. K. dhe N. K. ndaj subjektit të rivlerësimit, procesi i rivlerësimit, i parashikuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, është nën kompetencën ekskluzive të organeve të rivlerësimit, Komisionit dhe Kolegjit, të cilët kanë të drejtën dhe detyrimin të hetojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të pavarur pasurinë, figurën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, si dhe çdo denoncim të paraqitur nga publiku lidhur me aspekte të vlerësimit të subjekteve. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

- 41.** Në përfundim të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në

tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

42. Lidhur me *procedimin penal nr. {***} të vitit 2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁵⁰, Komisioni ka konkluduar në vendim se: “Sikurse vërehet, gjykatat administrative nuk kanë shqyrtuar ligjshmërinë e akteve të kundërshtuara nga paditësja apo ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga institucionet dhe, si pasojë, referenca që bën subjekti në këto vendime për të arritur në përfundimin se fakti nuk parashikohet si vepër penale, është e pavend. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se në rastin e dërgimit të kërkesës për pushimin e çështjes së vitit 2020, subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe se kërkesat për pushimin e çështjes të viteve 2020 dhe 2021 janë të paarsyetuara. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”.

42.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit si të pabazuar, duke pretenduar se Komisioni, edhe në rastin konkret, ka gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, në kundërshtim me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016. Duke analizuar vendimin e Gjykatës Administrative, Komisioni është bazuar te veprimet hetimore që ka kryer subjekti i rivlerësimit dhe jo te vendimet gjyqësore që janë dorëzuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, të cilat janë cituar dhe janë bërë pjesë e fashikullit të procedimit penal, por nuk kanë shërbyer si referencë në kërkesën për pushim, siç pretendohet nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk duhet të vlerësohet si mangësi profesionale, fakti që gjykata nuk ka pranuar kërkesën për pushim, pasi gjykata nuk mund të jetë zyrë noteriale për t’i pranuar të gjitha kërkesat që dërgohen nga ana e organit procedues. Sipas subjektit të rivlerësimit, standardi i ri që po zbatohet pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017, kërkon kohën e mjaftueshme që edhe prokurorët të zbatojnë atë lloj standardi që kërkohet nga gjykata dhe fakti se pranohet kërkesa për pushim herën e parë apo të dytë, tregon se organi i prokurorisë është në rrugën e drejtë për ta perfeksionuar atë lloj standardi.

42.2. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si vijon.

42.2.1. Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 03.05.2019, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, bazuar në kallëzimin e shtetases L. D. ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit pranë ish-Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër.

⁵⁰ *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimeve të regjistruara me nr. {***} prot., datë 02.06.2020; nr. {***} prot., datë 29.12.2020 dhe nr. {***} prot., datë 10.03.2021, të znj. L. D..*

42.2.2. Me kërkesën “Për pushimin e çështjes”, së datës 18.05.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në mbështetje të nenit 329/a/4 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

42.2.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 22.06.2020, ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë dhe detyrimin e saj për vazhdimin e hetimeve sikurse përcaktohet në arsyetimin e vendimit, si dhe hetimet paraprake të zhvillohen për një afat 60-ditor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se: “[...] bazuar në aktet dhe provat e administruara në kuadër të këtij procedimi penal, organi i akuzës nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kallëzueses lidhur me emërimin e shtetasve A. S. dhe A. V.. Gjithashtu, kallëzuesja pretendoi se DAR Shkodër ka fshehur disa shkresa rreth procedurës së ndjekur, të cilat nuk i ka administruar organi i akuzës. Ndodhur para këtyre rrethanave të konstatuara, gjykata e çmon të nevojshme kthimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër për hetime të mëtejshme rreth veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke caktuar konkretisht këto detyra: të thirret sërish për të dhënë deklarime kallëzuesja L. D. dhe hetimet të shtrihen rreth pretendimeve për të cilat, sipas saj, organi i akuzës nuk ka hetuar dhe, konkretisht, të merret nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër ose Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS), praktika e konkurrimit për periudhën 2016-2017, në të cilën ka marrë pjesë kallëzuesja; të identifikohen se kush janë personat pjesëmarrës në këtë konkurs, pikët e tyre në të tria fazat, sipas pikës 4 të udhëzimit nr. 38, datë 6.10.2015, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar dhe pozicioni i tyre i punës”; të pyeten anëtarët e komisionit rreth mbledhjeve të zhvilluara dhe procedurave të ndjekura rreth këtij fakti; të verifikohet nëse nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër disponohen shkresa të tjera rreth këtij fakti, që nuk i janë vënë në dispozicion kallëzueses dhe organit të akuzës; të kryhet dhe çdo veprim tjetër hetimor që rrjedh nga dinamika e hetimeve dhe organi i akuzës e çmon të nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 04.09.2020.

42.2.4. Pas kryerjes së detyrave të lënë nga gjykata, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të nenit 329/a/4 të Kodit të Procedurës Penale, me kërkesën “Për pushimin e çështjes”, datë 25.02.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

42.2.5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 19.04.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e çështjes që lidhet me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky vendim ka shënimin: “Marrë formë të prerë në datë 25.05.2021”.

42.3. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se vendimet gjyqësore që janë dorëzuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, të cilat janë cituar dhe janë bërë pjesë e fashikullit të procedimit penal, por nuk kanë shërbyer si referencë në kërkesën për pushim, siç pretendohet nga Komisioni, nga verifikimi i kërkesës për pushimin e procedimit penal të datës 18.05.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: *Gjithashtu, shtetasja L. D. ka hapur një proces gjyqësor, ku palë e paditur është MAS dhe DAR Shkodër, me objekt: “Pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ publik me nr. {***}, datë 07.06.2017, të DAR dhe të MASH nr. {***}, datë 18.10.2017 [...] Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2018, ka vendosur “Mospranimin e kërkesëpadisë”. Çështja është apeluar nga paditësja dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 31.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Gjithashtu, paditësja ka ngritur të njëjtën kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2018, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësja L. D.. [...] Nga sa më sipër, konstatohet se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lënë në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, kanë rrëzuar pretendimet e shtetases L. D., që do të thotë se nuk janë konstatuar shkelje ligjore në rastin konkret. Gjithashtu, edhe vetë MASH ka verifikuar pretendimet e kësaj shtetaseje dhe ka arritur në përfundimin se DAR Shkodër dhe shkolla e mesme “{***}” kanë respektuar procedurat e përcaktuara në udhëzimin e MASH nr. 38, datë 06.05.2015 [...]. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimet gjyqësore nuk kanë shërbyer si referencë për kërkesën për pushim, nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e kërkesës së datës 18.05.2020, së hartuar prej tij dhe drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

42.4. Nga verifikimi i vendimeve gjyqësore të cituara dhe analizuara në kërkesën e sipërcituar, trupi gjykues vëren se në vendimin nr. {***}, datë 31.05.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, gjykata ka arsyetuar se: “Thënë ndryshe, padisë i mungon legjitimiteti pasiv [...]. Gjykata administrative nuk ka kompetencë të shqyrtojë këtë çështje, pasi ajo tashmë i përket juridiksionit civil dhe jo atij administrativ [...]. Gjykata vlerëson se në mungesë të ekzistencës së aktit apo veprimit tjetër administrativ nuk mund të shprehet për rrëzimin e padisë, siç përcaktohet në nenin 40, pika 3 e ligjit nr. 49/2012, por në zbatim të nenit 39, pika 2, vendos mospranimin e padisë, pa i hyrë shqyrtimit të provave”. Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr. {***}, datë 11.02.2019, ka arsyetuar se: “Duke qenë se shkresa nr. {***} prot., datë 09.06.2017, e DAR Shkodër, si dhe ajo me nr. {***} prot., datë 18.10.202017, e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk përbëjnë akte administrative, gjykata vlerëson të drejtë e të bazuar në ligj konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë se kërkesëpadia nuk duhet të pranohet”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2018, ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësja L. D., pasi kjo e fundit ka paraqitur një kërkesë formale për pushimin e gjykimit, duke hequr dorë nga zhvillimi i gjykimit.

Nga sa më sipër referuar, trupi gjykues konstaton se në asnjë prej vendimeve gjyqësore të cituara, nuk janë analizuar pretendimet e paditëses, në drejtim të ligjshmërisë së akteve të pretenduara prej saj, si dhe procedurave të ndjekura nga organet shtetërore, e aq më tepër t'i ketë rrëzuar ato. Për

rrjedhojë, arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në kërkesën për pushimin e çështjes se: “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë kanë rrëzuar pretendimet e shtetas L. D., që do të thotë se nuk janë konstatuar shkelje ligjore në rastin konkret”, nuk përputhet me përmbajtjen e provave të referuara prej vetë atij, në këtë kërkesë.

Të njëjtin arsyetim, subjekti i rivlerësimit e ka përsëritur edhe në kërkesën “Për pushimin e çështjes” së datës 25.02.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nisur nga situata faktike e pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet që subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim, nuk arrijnë të provojnë se ai ka kryer hetime të plota në këtë procedim penal. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

42.5. Edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se në rastin konkret, Komisioni ka gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, në kundërshtim me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, gjendet i pabazuar nga trupi gjykues, pasi Komisioni në asnjë moment nuk ka analizuar zgjidhjen e çështjes penale objekt kontrolli, por ka vlerësuar aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, sipas kërkesave të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

42.6. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson jobindës edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se standardi i ri që po zbatohet pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017, kërkon kohën e mjaftueshme që edhe prokurorët të zbatojnë atë lloj standardi që kërkohet nga gjykata dhe fakti se pranohet kërkesa për pushim herën e parë apo të dytë, tregon se organi i prokurorisë është në rrugën e drejtë për ta perfeksionuar atë lloj standardi. Edhe nëse do të ekzistonte nevoja e kohës së mjaftueshme, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për të zbatuar standardin e kërkuar nga gjykata, ndryshimet ligjore në legjislacionin procedural penal kanë ndodhur në vitin 2017, ndërsa kërkesat e subjektit të rivlerësimit drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes, datojnë në vitin 2020 dhe 2021, pra rreth tri-katër vjet më vonë, kohë më se e mjaftueshme kjo për të amortizuar përshtatjen me standardin e ri të pretenduar.

43. Në përfundim, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

44. Lidhur me *procedimin penal nr. {***} të vitit 2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁵¹, Komisioni ka konkluduar në vendim, se: “Komisioni konstaton se subjekti, në kërkesën drejtuar gjykatës, nuk ka analizuar nëse rrethanat e vërtetuara nga hetimi plotësojnë kushtet ligjore të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Si pasojë, Komisioni vlerëson se kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, i regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i mungon arsyetimi. Në

⁵¹ *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimit të regjistruar me nr. {***} prot., datë 23.03.2021, të z. Gj. Sh..*

përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

44.1. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të arsyetimit dhe konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka parashtruar se pavarësisht se ka dorëzuar një kopje të vendimit nr. {***}, datë 05.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, jo të arsyetuar, ku rezultonte pranimi i kërkesës për pushim të procedimit penal nr. {***}, përsëri Komisioni nuk e ka vlerësuar, duke u qëndruar gjetjeve të mëparshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, gjykata ka verifikuar të gjitha veprimet hetimore të kryera nga organi procedues dhe ka pranuar kërkesën për pushim dhe, është tërësisht jologjike që ai të vlerësohet përsëri me mangësi profesionale.

44.2. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si vijon.

44.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga z. Gj. Sh., ka regjistruar kallëzimin penal me nr. {***}, datë 19.02.2014, për veprat penale të “Mashtimit”, “Korrupsionit pasiv në sektorin privat”, “Përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike”, në ngarkim të shtetasit M. T., me detyrë përmbarues gjyqësor privat, si dhe për veprat penale “Kanosje”, “Korrupsion aktiv në sektorin privat”, “Falsifikim i dokumenteve”, “Pushtimi i tokës” dhe “Falsifikim i vulave dhe stampave ose i formularëve”, të parashikuara nga nenet 84, 164/a, 186/2 dhe 190/1/2 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve M. Th., R. K., K. P., Gj. M., P. V., S. V., P. P., N. T. dhe P. Rr.. Prokurorja M. Sh., me vendimin e datës 01.04.2014, ka vendosur “Mosfillimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. {***}, datë 19.02.2014”. Mbi ankimin e kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 09.7.2014, vendosi shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal dhe detyrimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e hetimeve. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 12.02.2015.

44.2.2. Për kallëzimin penal të z. Gj. Sh. ndaj përmbaruesit M. T., bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale “Vjedhje përmes mashtimit të kryer ndaj dy personave” dhe “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, i regjistruar me nr. {***}, prokurori K. B., me vendimin e datës 04.04.2014, vendosi shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën procedimi penal u regjistrua me nr. {***}. Prokurori S. H., me vendimin e datës 26.09.2014, ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Prokurori A. S. regjistroi procedimin penal nr. {***} për veprën penale të “Mashtimit”, të parashikuar nga nenin 143/2 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit M. T. dhe, me vendimin e datës 02.03.2015, vendosi bashkimin e procedimit penal nr. {***} dhe nr. {***}, datë 19.02.2014, në një procedim të vetëm. Kundër vendimit të datës 25.01.2017, “Për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2015”, të prokurorit A. S., ka bërë ankim z. Gj. Sh. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 28.06.2018, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vazhdimin e hetimeve vetëm për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. {***}, datë 08.11.2018.

44.2.3. Në vijim të vendimeve gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, i caktuar si prokuror i çështjes, me vendimin e datës 12.03.2019, në cilësinë e prokurorit të çështjes, vendosi rifillimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

44.2.4. Me kërkesën e datës 23.03.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, të regjistruar për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

44.2.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me: “Komisioni konstaton se subjekti nuk ka arsyetuar nëse rrethanat plotësojnë kushtet ligjore të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale për marrjen e këtij vendimi. Sa më sipër, duket se kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, regjistruar për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i mungon arsyetimi”. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna, ka parashtruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 05.10.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. {***}. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo do të thotë se prokuroria ka kryer të gjitha veprimet hetimore që janë kërkuar nga gjykata, pasi në rast se kërkesa nuk do të ishte arsyetuar, gjykata do ta kthente procedimin penal për hetime të mëtejshme.

44.3. Në analizë të pretendimeve të parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në kërkesën për pushimin e çështjes, subjekti i rivlerësimit, pasi ka përshkruar veprimet hetimore të kryera, të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vendimin nr. {***}, datë 28.06.2018, ka pasqyruar kërkesat për veprime të tjera procedurale të paraqitura nga kallëzuesi Gjon Shkambi, ka pasqyruar përmbajtjen e dispozitave ligjore, konkretisht të nenit 186, “Falsifikimi i dokumenteve”, të Kodit Penal, si dhe të nenit 328, “Pushimi i akuzës ose çështjes”, të Kodit të Procedurës Penale dhe, më pas, ka konkluduar se: “Për sa parashtrova më sipër, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe procedimi penal i filluar duhet të pushohet”.

44.4. Nga situata faktike e pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson ashtu si Komisioni, se kërkesa për pushimin e çështjes gjendet e paarsyetuar, pasi nuk ka një analizë të fakteve që kanë rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit dhe ndikimit që ato kanë në zgjidhjen e çështjes dhe as një analizë ligjore për elementet e veprës penale. Në kërkesën për pushimin e çështjes, evidentohet mungesë e një analize të të dhënave të rezultuara nga veprimet hetimore, në funksion të përcaktimit nëse rrethanat plotësojnë kushtet ligjore të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat e kanë bindur subjektin e rivlerësimit për të arritur në konkluzionin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

45. Në përfundim, shkeljet e konstatuara në procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, vlerësohen nga trupi gjykues se demonstrojnë mangësi të subjektit të rivlerësimit në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsyetimit ligjor, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, konkluzioni i arritur nga Komisioni gjendet i drejtë.

46. Lidhur me *procedimin penal nr. {***} të vitit 2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*⁵², Komisioni ka konkluduar në vendim, se: “Sa më sipër, Komisioni vlerëson se arsyetimi që përdor subjekti në kërkesën për pushim, se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar te procedimi penal nr. {***} dhe janë rrëzuar si të papranueshme te procesi civil, me vendimin nr. {***}, datë 18.12.2013, nuk është i mbështetur në këto akte. Gjithashtu, vlerëson se në kërkesën për pushimin e çështjes penale, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet përbërëse të veprës penale, të parashikuara nga neni 143 i Kodit Penal dhe nuk pasqyron arsyet se pse në rastin konkret, nuk janë konsumuar elementet e kësaj vepre penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016”.

46.1. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të arsyetimit dhe konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka parashtruar pretendime të cilat janë analizuar nga trupi gjykues si më poshtë.

46.2. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka cenuar parimin e kontradiktorialitetit, pasi në vendim është analizuar vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 19.07.2021, i cili nuk është administruar prej Komisionit deri në ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore dhe ky fakt është pranuar dhe nga vetë relatorja gjatë zhvillimit të kësaj seance. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se sapo është njohur me këtë fakt, i ka kërkuar sqarime Komisionit, nëpërmjet një *e-mail*-i të dërguar më datë 09.12.2021, për të cilin nuk ka marrë përgjigje.

46.3. Lidhur me këtë pretendim, pas shqyrtimit të akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se:

46.3.1. Në rezultatet e hetimit administrativ, dërguar subjektit të rivlerësimit me *e-mail*-in e datës 11.10.2021, me qëllim përshkrimin e rrethanave të hetuara për sa i përket denoncimit të depozituar nga z. M. P., N. Q., N. S. dhe P. Gj., Komisioni i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, se: *Më datë 30.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar kallëzuesit për përfundimin e hetimeve dhe më pas ka hartuar kërkesën për pushimin e çështjes, e cila i është dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 30.01.2020, të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Nga verifikimi i faqes elektronike www.gjykata.gov.al, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 19.07.2021, ka vendosur: “Mospranimin e kërkesës së prokurorit. 2. Kthimin e akteve të procedimit penal numër {***} të vitit 2018 të Prokurorisë së Rrethit Shkodër, regjistruar për veprat penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni*

⁵² *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimit të regjistruar me nr. {***} prot., datë 18.01.2021, të z. M. P., N. Q., N. S. dhe P. Gj..*

*143 i Kodit Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 348 i Kodit Penal, në Prokurorinë e Rrethit Shkodër për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore. Këto veprime duhet të kryhen brenda një periudhe prej 3 (tre) muajsh, afat që fillon nga dita që ky vendim merr formë të prerë”. Në kushtet kur vendimi i gjykatës nuk pasqyrohet në sistemin elektronik, Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.09.2021, ka kërkuar kopje të vendimit. Deri më sot ky vendim nuk ka ardhur.*

46.3.2. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe barrën e provës së kaluar⁵³, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, përcjellë në Komision më datë 22.10.2021, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur pretendime apo kërkesa lidhur me dokumentacionin e vënë në dispozicion prej Komisionit, si dhe nuk ka paraqitur asnjë pretendim të njëjtë me atë në ankim, lidhur me cenimin e parimit të kontradiktoritetit, për shkak se Komisioni i kishte bërë të ditur se nuk kishte administruar ende kopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të datës 19.07.2020.

46.3.3. Në seancën dëgjimore të datës 26.10.2021, referuar procesverbalit të kësaj seance, komisionerja relatore e çështjes, në prezantimin e rezultateve të hetimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, rrethanat dhe gjetjet e konstatuara nga Komisioni lidhur me denoncimin e z. M. P., N. Q., N. S. dhe P. Gj., i ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur dhe në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, nuk ka referuar, në asnjë moment, lidhur me administrimin e vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 19.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

46.3.4. Në vendim, Komisioni ka shpjeguar se vendimi nr. {***}, datë 19.07.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i është përcjellë nga kjo e fundit me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 15.10.2021.

46.4. Trupi gjykues e gjen të pambështetur në prova e fakte pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në dritën e situatës faktike të sipërpasqyruar, pasi në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, vendimi nr. {***}, datë 19.07.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është administruar nga Komisioni përpara zhvillimit të seancës dëgjimore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni për faktin e pretenduar që në rezultatet e hetimit administrativ dhe nuk ka parashtruar asnjë pretendim, në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, por i ka kërkuar sqarime Komisionit, ashtu siç pretendon, nëpërmjet një e-mail-i të dërguar më datë 09.12.2021, vetëm pak ditë përpara depozitimit të ankimit ndaj vendimit të Komisionit.

Vendimi nr. {***}, datë 19.07.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk duket se ka pasur peshën kryesore për gjetjet e Komisionit të pasqyruara në rezultatet e hetimit administrativ dhe as për konkluzionet e arritura në vendim, pasi Komisioni ka arritur në të njëjtat konkluzione në të

⁵³ Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës si më poshtë: “Jepni shpjegime lidhur me konstatimet e Komisionit: i. Subjekti nuk ka arsyetuar faktin nëse dokumentet e paraqitura nga familja K. në procesin gjyqësor civil ishin ose jo të falsifikuara, nëse ato janë përdorur dhe nëse ato ishin në dijeni të këtij fakti. ii. Subjekti në kërkesën për pushimin e çështjes penale nuk ka analizuar elementet përbërëse të veprës penale të nenit 143 të Kodit Penal dhe nuk pasqyrohen arsyet se pse në rastin konkret, nuk janë konsumuar elementet e kësaj vepre penale. iii. Në dosjen e procedimit penal nr. {***}, viti 2018, mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e hetimeve”.

dyja fazat e procesit të rivlerësimit. Megjithatë, ky nuk është argumenti i vetëm në favor të mungesës së cenimit të parimit të kontradiktoritetit, pasi Komisioni në rezultatet e hetimit ka përmendur të dhëna të rezultuara nga një vendim gjyqësor, me përmbajtjen e të cilit subjekti i rivlerësimit ishte njohur për shkak të përfaqësimit prej tij të organit të prokurorisë, në çështjen penale përkatëse. Në rastin konkret, balanca e njohjes së dokumentacionit, në momentin e hartimit të rezultateve të hetimit administrativ, anonte nga subjekti i rivlerësimit, balancë e ekuilibruar më pas, në momentin kur edhe Komisioni është njohur me përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur asnjë e dhënë në aktet e administruara dhe as në parashtrimet e subjektit nuk tregojnë qoftë edhe gjurmë të cenimit të parimit të kontradiktoritetit, pretendimet e subjektit të rivlerësimit gjenden të pambështetura në fakte.

46.5. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i arritur nga Komisioni është i pabazuar, pasi ka qenë e qartë se fakti është hetuar edhe dy herë të tjera, për më tepër Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër e kanë vlerësuar si të plotë hetimin dhe nuk kanë konstatuar kryerjen e ndonjë veprë penale nga personat e kallëzuar.

46.6. Lidhur me këtë pretendim, pas shqyrtimit të akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues vëren se:

46.6.1. Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi bazën e kallëzimit të z. M. P., N. Q., N. S., P. Gj., kundër shtetasve U. M., L. Ll., A. N., N. K., J. K., M. K., C. K., ka regjistruar procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, për veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Mashttrim”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 143 të Kodit Penal. Kallëzuesit kanë pretenduar se dokumentet mbi bazën e të cilave është dhënë vendimi i KKK-Pronave dhe është bazuar procedura e privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjes Gjeologjike Shkodër, janë të falsifikuara dhe, për këtë qëllim, kanë bërë kallëzim dhe ndaj ish-anëtarëve të Komisionit të Privatizimit, në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës.

46.6.2. Ndërmjet kallëzuesve dhe të kallëzuarve janë zhvilluar disa procese gjyqësore civile dhe kallëzuesit kanë paraqitur disa herë kallëzime penale për kryerjen e veprave penale “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikim i dokumenteve”. Me vendimin e datës 03.07.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2013, të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të z. Gj. P., P. Gj., M. P., N. S. dhe N. Q., pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale. Gjithashtu, me vendimin e datës 09.12.2016, ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. {***} të vitit 2016, të regjistruar në bazë të kallëzimit të shtetas L. K. (S.), e bija e N. S., e cila kishte kallëzuar falsifikimin e vendimit nr. {***}, datë 04.09.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

46.6.3. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën për pushimin e çështjes, datë 21.01.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër më datë 30.01.2020, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 13.12.2018. Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar veprimet hetimore të kryera, më pas ka pasqyruar përmbajtjen e vendimit civil nr.

{***}, datë 28.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe përmbajtjen e vendimit të datës 03.07.2014, “Për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2013”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Në vijim, pas pasqyrimin të përmbajtjes së neneve 143 dhe 248 të Kodit Penal dhe të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: “Nga sa më sipër, rezulton se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar te procedimi penal me nr. {***}, i cili është pushuar, si dhe janë shqyrtuar dhe rrëzuar si të papranueshme te procesi civil, me vendimin nr. {***}, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 14.05.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në këto kushte, nuk konstatohen elemente të veprës penale të “Mashtimit”, “Falsifikimit të dokumenteve”, “Shpërdorimit të detyrës” apo ndonjë vepër tjetër penale, parashikuar nga nenet 143, 186 dhe 248 të Kodit Penal”. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 13.12.2018, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

46.6.4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 19.07.2021, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. {***} në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, brenda një periodhe prej 3 muajsh. Gjykata ka arsyetuar: *[...] Prokurori nuk ka analizuar provat e grumbulluara dhe nuk ka argumentuar se përse faktet e kallëzuara nuk përbëjnë vepër penale. Në kërkesën për pushimin e hetimeve, prokurori shprehet se pretendimet e kallëzuesve janë shqyrtuar dhe rrëzuar si të papranueshme te procesi civil me nr. vendimi {***}, datë 18.12.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 14.05.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër [...]. Në këtë vendim civil, gjykata nuk ka trajtuar fare në aspektin penal nëse vendimi nr. {***}, datë 04.09.1995, i KKK-Pronave Shkodër është ose jo i falsifikuar. [...] Prokurori shprehet se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar te procedimi penal nr. {***}, i cili është pushuar [...]. Në hetimet e zhvilluara për procesin penal nr. {***}, nuk është hetuar për asnjë nga faktet e kallëzuara nga shtetasit M.P., N.Q., N.S. e P.Gj., por është referuar praktika e legalizimit të objekteve që shtetasit kishin ndërtuar e përshtatur në pronën objekt gjykimi.*

46.6.5. Procedimi penal nr. {***} është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të bërë nga kallëzuesit M. P., N. Q., N. S. e P. Gj., të cilët kanë pretenduar se anëtarët e KKK-Pronave Shkodër, kryetarja e Degës së Shoqërive Publike Shkodër dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme, falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, kanë sjellë përfitime materiale në favor të shtetasve N. K. dhe J. K.. Në vendimin “Për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2013”, të datës 03.07.2014, prokurori i çështjes (një tjetër subjekt rivlerësimit) ka arritur në përfundimin se nuk ka elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, nga përfaqësuesit e organeve shtetërore përkatëse dhe nuk ka hetuar lidhur me falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara nga pjesëtarët e familjes K..

46.6.6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vendimin civil nr. {***}, me palë paditëse N. K., J. K., M. K., Ç. . dhe palë të paditur M. P., N. Q., N. S., P. Gj. etj., me objekt lirimin dhe dorëzimin e objekteve dhe truallit të zënë nga të paditurit, si dhe detyrimin e tyre për pagimin e vlerës së përdorimit të sendit deri në dorëzimin e tij, ka arritur në përfundimin se të paditurit janë posedues

të paligjshëm për sipërfaqet ndërtimore të vjetra ekzistuese dhe për truallin që posedojnë, dhe në kushtet kur është provuar që janë në keqbesim, duhet të shpërblejnë palën paditëse për përdorimin e sendit. Gjykata nuk ka hetuar lidhur me falsitetin e dokumenteve që kanë përdorur paditësit (anëtarët e familjes K.) për fitimin e pronësisë, por ka hetuar dhe gjykuar objektin e padisë së rivendikimit.

46.7. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të analizuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se në kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë një analizë të plotë të fakteve e provave në raport me dispozitën ligjore të aplikuar në marrjen e vendimit. Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit në kërkesën për pushimin e procedimit penal, se pretendimet e kallëzuesve janë shqyrtuar dhe rrëzuar si të papranueshme me vendim gjyqësor të formës së prerë në një proces civil, nuk gjen referencë ligjore. Neni 71 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se: “Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit”. Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të gabuar, vlerëson kompetencën e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale krahasuar me kompetencën e gjykatës civile, pasi gjykata nuk ka hetuar lidhur me falsitetin e dokumenteve që kanë përdorur të kallëzuarit për fitimin e pronësisë së objekteve, por ka hetuar dhe gjykuar objektin e padisë së rivendikimit. Hetimin e pretenduar nga kallëzuesit, nuk mund ta kryente gjykata në një proces civil, por vetëm organi i prokurorisë. Subjekti i rivlerësimit nuk kishte pse të kushtëzonte kryerjen e hetimit penal për të provuar falsifikimin e dokumenteve të pronësisë, me përfundimet e arritura në procesin civil, të cilat nuk përputheshin me objektin e kallëzimit penal. Në rastin konkret, procesi gjyqësor i zhvilluar pranë gjykatave civile, nuk kishte pasur objekt padie goditjen e akteve për falsitet, por “rivendikimin e sendit”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet hetimore për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”.

Edhe argumenti tjetër që i ka shërbyer subjektit të rivlerësimit si shkak për të kërkuar pushimin e hetimeve, se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar te procedimi penal me nr. {***}, i cili është pushuar, nuk është i mbështetur në prova, pasi në vendimin “Për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2013”, të datës 03.07.2014, prokurori i çështjes nuk ka hetuar lidhur me falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara nga ana e të kallëzuarve.

47. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, lidhur me këtë procedim penal, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
48. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shkeljet dhe mangësitë e evidentuara, të cilat paraqiten në mënyrë të përsëritur si mangësi në kryerjen e hetimeve, në analizimin e veprës penale, si dhe në argumentimin e arsyetimit e vendimmarrjeve, janë situata që me të drejtë nga Komisioni janë konsideruar se e klasifikojnë subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, në zbatim të

nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 44, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, nën parashikimin e nenit 61, pika 4 e këtij ligji.

49. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e arritura për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1, 3 e 5 dhe neni E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 465, datë 28.10.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 465, datë 28.10.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.10.2024.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi